


Agim Musta

MANDELËT e SHQIPËRISË

BIBLIOTEKA

92

M.98



Rrathët e Ferrit

Shkatërrimi i trurit
Deklarata
Gjenerali i zi
Nevzat Haznedari

92
1798

AGIM MUSTA

MANDELËT E SHQIPËRISË



- Rrathët e ferrit
- Shkatërrimi i trurit
- Gjenerali i zi Nevzat Haznedari
- Deklarata

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

REVISTA

Redaktor

ILIRIAN ZHUPA

Reçensues

DHIMITËR XHUVANI

Kopertina

ALMA XHAFA

REVISTA
SHKËRIMET
DHE
KËMBËRËT

REVISTA
SHKËRIMET
DHE
KËMBËRËT

REVISTA
SHKËRIMET
DHE
KËMBËRËT

**Këtë libër ua kushtoj:
të gjithë bashkëvuajtësve të mi,
të vdekur dhe të gjallë,
që i ranë pash më pash
ferrit të diktaturës komuniste.**

AGIM MUSTA

PARATHËNIE

Rrota e historisë së njerëzimit, në ecjen e saj shekullore, krahas dritës e përparimit shoqëror që ka sjellë, ka pasur dhe nga një faqe të zezë pis e të mbushur me aq dhimbje, sa kanë mbërritur deri në ditët tona e rrëfihen si përralla. Por ja që erdhi një kohë, që një zot e di si erdhi, dhe gjithë ato përralla të zeza, të dhimbshme, të turpshme, mesjetare, gati në të harruar, u ringjallën sërish, më të hidhura, më të mistershme, e më makabre, sikur, për dreq, ligësia njerëzore e fyer që bëmat e saj që plakeshin, i ringjalli për gjysmë shekulli te ne, në Shqipëri, me një fuqi makabre, si një koncentrat helmi që vetëm po të ndodhesh pranë helmohesh. Jam i bindur që autori i këtij libri, në tryezën e tij të punës, nëse ka tryezë, e ka gjyter penën jo me bojë shkrimi po në koncentratin e atij helmi të madh e të fuqishëm dhe na rrëfen gjëra që zor se mund t'i kuptojë e të besojë një njeri që nuk është shqiptar. Si ka mundësi që një vend kaq i varfër, si Shqipëria, të harxhojë para për një gjeneral, që ta dërgojë atë deri në fund të botës, në Kinë, për të studiuar, për të marrë përvojë e për të zotëruar teknikën e torturave të Dinastisë Parandorake Min? A nuk është kjo një përrallë e hidhur, që solli në Shqipëri helmin e koncentruar, që e përpunoi me gjenialitet diabolik dhe e ripërtëriu njëqindfish, ferrin me llucën e kënetave në galeritë e minierave të piriteve dhe në dhomat e gjumit, ku burri kishte frikë të zhvishej para gruas e të hapte zemrën? Sa gjëra të çuditshme e të pabesueshme më rrëfen ky libër i thjeshtë, i cili pas çdo faqeje të detyron të pyesësh! Pse? Zot! Si ka mundësi, që klerikë të nderuar, barinj të tufave njerëzore, të kulteve myslymane e katolike, të torturohen nëpër birucat e hetuesisë, të kalben burgjeve e kampeve të përqendrimit. Mos vallë duhej të shembej Zoti, që të bëhej Zot Xhelati? Mos vallë duhej të vdisnin nëpër kënetë dhe të varroseshin për së gjalli në themele fabrikatesh, të tre-

teshin nga veremi nëpër galerat e nëndheshme intelektualet, që të shuhej bashkë me ta dhe mendimi i lirë, dëshira për drejtësi?

Kush është autori i këtij libri? Z. Agim Musta.

Një mësues, që veç detyrës së tij të shenjtë të mësuesisë, u foli nxënësve, miqve e gjithë atyre të eturve, se kjo botë e vogël shqiptare, ky komb i martirizuar historikisht, ka nevojë për liri e demokraci. U fut në burg aq i ri e doli i thinjur, i drobitur, i përbuzur e i detyruar tërë jetën të rropatej për një kafshatë bukë, por jo i thyer. Dora e tij, që ishte mësuar të korrigjonte diktime e hartime, ndonëse e plakur, nisi të shkruajë këto shkrime, skica e kujtime kaq të zymta, kaq të madhërishme e të mbushura plot me helm nga helmi i shpirtit të tij e i shumë shpirt-rave të bashkëvuajtësve.

DHIMITËR XHUVANI

6 Tetor 1992

BURGJET E SHTETIT-BURG¹⁾

Me vendosjen e diktaturës komuniste në nëntor 1944, në Shqipëri u arrestuan me mijëra njerëz dhe u hapën burgje jo vetëm në ish-prefekturat, por edhe në qytete të vogla. Para pushtimit fashist të 7 prillit 1939, në gjithë mbretërinë shqiptare kanë ekzistuar katër burgje kryesore: 1. burgu i përgjithshëm në Gjirokastrë, 2. burgu i Tiranës, 3. burgu i Korçës dhe burgu i Shkodrës. Në të gjitha këto burgje vuanin dënimin rreth 600 të dënuar për krime ordinere dhe një pakicë shumë e vogël për krime politike.

Gjatë pushtimit fashist u çelën burgje të reja në të 10 prefekturat dhe tri kampe përqendrimi: në Porto Palermo (Himare), në Porto Romano (Durrës) dhe në Shijak. Në Tiranë u ndërtua një burg i ri, mjaft i përforcuar, që shërbente krejtësisht për ish-ushtarakët shqipëtarë që shërbente nga radhët e ushtrisë italiane. Me shtimin e qëndresës së popullit shqiptar kundër pushtuesit, gjatë periudhës 1940-1943, në burgjet e Shqipërisë vuanin dënimin ose prisnin të dënoshin rreth 3000 veta, duke përfshirë në këtë numër dhe të internuarit në kampet e përqendrimit brenda vendit dhe në ishujt e Italisë, si në Ventotene, etj. Me t'u marrë pushteti nga ana e komunistëve, gjatë vitit 1945-1946 u arrestuan rreth 10.000 veta për motive politike si ish-pjesëmarrës në qeveritë kuislinge, anëtarë të organizatave të «Ballit Kombëtar», «Legalitetit», të forcave të bajraktarëve tatar, të pasur që u kërkohej me dhunë të dorëzonin arin dhe bizhuteritë e trashëguara, ish-partizanë dezertorë, nje-

1) Dy fjalë për burgjet dhe kampet me punë të detyruar për të burgosurit politikë në Shqipëri gjatë regjimit të diktaturës komuniste, 1944-1991.

rëz që shfaqnin mendime të kundërta ndaj regjimit të ri, etj. etj.

Meqenëse burgjet u mbushën plot, për të përballuar gjendjen u çelën dhe shumë të tjera, në të gjitha qendrat kryesore urbane. Në Shkodër u shndërruan në burgje shumë shkolla dhe kisha, në Peshkopi kazernat e ushtrisë, në Gjirokastrë fabrika e miellit, në Elbasan dhe Kukës shtëpitë private, etj.

Gjatë periudhës janar 1945—mars 1991, në Shqipëri kanë vuajtur nëpër burgje dhe kampe me punë të detyruar rreth 20.000 persona fizikë, duke përjashtuar nga ky numër rreth 2500 të pushkatuar, kurse si dënime janë dhënë qindra më tepër nga numri i sipërpërmendur, mbasi shumë persona janë dënuar më shumë se një herë, për «krime politike». Më 1949, mbas shkëputjes së Shqipërisë nga tutela e Jugosllavisë së Titos dhe mbas dënimit me vdekje të Koçi Xoxes, ish-zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Brendshme (gjatë periudhës 1945-1948), u bë një amnisti, nga e cila përfituan rreth 2000 të burgosur politikë, shumica e të cilëve, para se të liroheshin, u detyruan të lëshonin deklaratë se do të bëheshin bashkëpunëtorë të Sigurimit. Ata që s'e kryen këtë detyrë, u arrestuan dhe u ridënuan nga gjyqet e fshehta të Sigurimit të shtetit shqiptar. Gjatë vuajtjes së dënimit në burgje dhe kampe me punë të detyruar, rreth 2000 veta kanë gjetur vdekjen nga kushtet çnjerëzore në të cilat mbaheshin dhe nga puna e stërmundimshme prej skllavi. Shumë nga ata që u liruan dolën me sëmundje të pashërueshme dhe me trauma psikike. Përveç shtetasve shqiptarë, në këto burgje dhe kampe kanë vuajtur disa qindra qytetarë grekë, italianë, gjermanë, gra ruse, polake, hungareze, jugosllave. të martuara me burra shqiptarë, të dënuar si «agjentë» të imperializmit amerikan dhe socialimperializmit rus. Të gjithë këta fatkëqinj u janë nënshtruar torturave barbare të hetuesve përbindësh, që nuk nguronin të digjnin dhe sytë e të pandehurve me cigare, derisa këta të mjerë të pranonin «fajësinë» e tyre. Mund të themi me siguri se diktatura komuniste në Shqipëri ka qenë më e egra në gjithë Evropën Lindore, duke përfshirë këtu dhe Bashkimin Sovjetik. Këtë e kanë pohuar anëtarë të delegacionit të Helsinkit, deputetë dhe personalitete nga KSBE-ja dhe vende të ndryshme të botës, Nobelistja Nënë Tereza, poeti rus Jevtushenko e sa e sa të tjerë, që kanë vizituar Shqipërinë mbas shkatërrimit të diktaturës së kuqe.

RRATHËT E FERRIT

BURGU I GJIROKASTRËS

Burgu i Gjirokastrës u ndërtua mbi kështjellën e qytetit, në fillim të viteve tridhjetë. Ai kishte një pamje madhështore dhe të frikshme, që, së bashku me kështjellën, i ngjante një kryqëzori midis oqeanit. Përtej dritareve të tij shiheshin malet e Gllavës në veri dhe malet e Greqisë në jug. Në qendër të burgut ishte salla e madhe me 7 dritare ose 7 penxheret, siç i thoshte populli i Gjirokastrës. të cilat binin mbi pazarin e qytetit. Nga salla e madhe degëzoheshin dy degë: një nga e djathta e vogël, që ishte burgu i grave dhe një nga e majta me dhoma 2-4 vendëshe. Nga ana e jugperëndimit ndodhej «Babica», ku ishin 20 qelira. Gjatë regjimit të Zogut, burgu i Gjirokastrës ishte «Burgu i Përgjithshëm i Mbretërisë Shqiptare», kurse në kohën e diktaturës komuniste, sidomos gjatë viteve 1945-1950. ky ishte burgu më i madh i Republikës, i populluar me të burgosur nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Gjatë kësaj kohe u përshtatën dhe u çelën qeli dhe në katet përdhese të burgut, ku zotëronte errësira e përjetshme. Në këtë burg, në vitet e para të diktaturës, ka pasur mbi 100 të burgosur politikë. të cilët gjer më 1949 mbaheshin vetëm me 400 gr bukë misri. Gjatë kësaj periudhe në këtë burg kanë gjetur vdekjen mbi 100 të dënuar. Edhe nga ky burg ka pasur përpjekje për arratisje, disa prej të cilëve kanë përfunduar me sukses. Me çeljen e kampeve me punë të detyruar. ky burg u mbyll dhe u shndërrua në frigorifer.

BURGU I VJETËR I TIRANËS

Burgu i vjetër i Tiranës është ndërtuar më 1932 dhe ka formën e dy eleve të shtypit, që bashkoheshin me njëra-tjetrën. Është dykatësh dhe ka dy oborre në dy pjesët anësore. Në pjesën e mesit, në katin e sipërm dhe përdhes, ndodheshin zyrat e drejtorisë së burgut dhe zyrat e hetuesve. Kati i dytë përdorej për të burgosur ordinerë dhe një kaush ishte me të dënuar politikë me nënshtetësi të huaj. Në katin përdhes ishin 7 dhoma me të burgosur politikë dhe qelitë e izolimit. Në pjesën perëndimore të burgut ishte një ndërtesë e vogël dykatëshe, që në regjimin e Zogut dhe në kohën e pushtimit italian shërbente si burgu i grave. ndërsa regjimi komunist i Enver Hoxhës e shndërroi këtë ndërtesë në dhomë torturash dhe hetuesie. Këtu zhvilloheshin gjer më 1957 dhe gjyqet speciale të fshehta të sigurimit. Mbrapa burgut, më 1946. u ndërtuan 40 qeli, të ashtuquajtura të Kocit, të cilat ishin shumë të nxehta në verë dhe shumë të ftohta në dimër. Ato ishin pa ajrosje të mjaftueshme dhe shumica e të izoluarve prekeshin nga sëmundjet e mushkërive dhe të zemrës. Qelia nr. 18 quhej qelia e vdekjes. se ishte pa ajër dhe në errësirë të plotë. Në këto qeli kanë gjetur vdekjen disa qindra të burgosur politikë nga torturat dhe vetëvrasjet. Mbas hapjes së kampeve me punë të detyruar, burgu i vjetër i Tiranës u kthye në një burg tranzit dhe aty mbaheshin vetëm të kaluar nga mosha, të sëmurë dhe pak veta të izoluar.

BURGU I RI I TIRANËS

Ky burg u ndërtua më 1940, nga pushtuesit italianë. Gjysma e tij përbëhet nga qeli dhe dhoma hetuesie, kurse gjysma tjetër nga kaushë për të burgosur. Në vitet e para mbas vendosjes së regjimit komunist ky burg u përdor vetëm për ushtarakë të dënuar dhe si spital për të burgosur, po më vonë u shndërrua në hetuesi të përgjithshme për procese të rëndësishme politike, ku shumica e të pa-

ndehurve përfundonin para togës së ekzekutimit. Këtu është kryer hetuesia e byroistëve: Beqir Balluku, Kadri Hazbiu, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi, Petrit Dume, e të tjerë, të cilët shkuan në plumb ose u dogjën me *zjarrhedhëse* (Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako).

Për ironi të fatit, në qelitë e këtij burgu, gjatë viteve 1991-1992, u burgosën bashkëpunëtorët e ngushtë të Enver Hoxhës, që kishin lyer duart me gjak gjer në bërryla si, Manush Myftiu, Rita Marko, Hekuran Isai, Simon Stefani e të tjerë, me në krye të venë e Enverit, Nexhmije Hoxhën.

BURGU-FERR I BURRELIT

Ky burg filloi të ndërtohej qysh më 1938, në lindje të qytetit të Burrelit, nga regjimi i mbretit Zog, po mbeti i papërfunduar për shkak të pushtimit italian më 7 prill 1939. Pushtuesit fashistë e kthyen burgun e Burrelit në stalla kuajsh, kurse diktatura Enveriane e shndërroi në një burg shfarosës për inteligjencën e kombit shqiptar. Në hallkat e hekurta, të vendosura nëpër muret e kaushëve, pushuesit lidhnin kuajt dhe mushkat, kurse xhelatët e diktaturës lidhnin shqiptarët, për t'i torturuar. Burgu i Burrelit ka formën e një paralelopedi me gjatësi 100m dhe me gjerësi 5m mbi nivelin e tokës. Ai është i ndërtuar me beton arme dhe mbulohet me një tarracë 40cm trashësi. Ka 10 dhoma në të dyja skajet e tij dhe në mes 20 qilarë të rreshtuar nga të dyja anët e korridorit të ngushtë dhe të errët. Burgu u çel për herë të parë me urdhër të Enver Hoxhës, në fillim të vitit 1946, duke sjellë të burgosur nga të gjitha burgjet e Shqipërisë. Në përgjithësi të dënuarit ishin intelektualë, po kishte dhe të rinj të fuqishëm, të ashtuquajtur «të rrezikshëm» nga diktatura. Burgu rrethohet nga një mur betoni i lartë, që nuk lejon të shikosh asgjë nga jashtë dhe anasjelltas. Për këtë arsye në popull qarkullonte fjala se burgu i Burrelit është i nëndheshëm.

Gjatë periudhës 1946-1949 të burgosurit trajtoheshin vetëm me 400 gr bukë misri në ditë dhe asgjë tjetër. Gjatë kësaj kohe kanë gjetur vdekjen rreth 300 të burgosur, të cilët i varrosnin në gropa të përbashkëta mbrapa burgut.

Motoja në këtë burg, që gardianët dhe oficerët e sigurimit e përsëritnin orë e çast, ishte:

«Këtu i thonë Burrel, që hyn dhe s'del.»

Drejtori i burgut, togeri Vangjel Rëmbeci, i pajisur me «kartabianka» nga ministri i Punëve të Brendshme Koçi Xoxe, për sadizëm ua kalonte komandantëve të kampeve naziste. Me urdhër të tij u mbyllën në qeli, derisa vdiqën nga uria: Koço Kota, Spiro Grameno dhe Atif Golja. Kapaciteti i burgut ishte për 400 veta, po më të shumtën e kohës ai kishte mbi 600 të dënuar. Më 1953, një grup oficerësh të lartë sovjetikë vizituan këtë burg dhe u befasuan kur u panë sytë këtyre njerëz-kufoma, të veshur me zhele. Një i burgosur mori guximën dhe iu drejtua oficerëve rusë me këto fjalë:

«Zotërinj! Nënë këto lecka fshihen diplomat e universiteteve të Evropës.»

Në këtë burg-skëterrë gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së tij, 1946-1990, kanë gjetur vdekjen mbi 600 të burgosur, midis të cilëve intelektualë të shquar si Hetem Haxhiademi, Arqile Tase, Gjergj Kokoshi, Xhevat Korça, Xhavit Leskoviku, Aleksandër Kalivopulli e shumë e shumë të tjerë. Në çdo metër katror të tij ka kaluar vdekja, duke marrë ajkën e inteligjencës shqiptare.

S'mund të lëmë pa përmendur disa nga vargjet e poezisë së Arshi Pipës për këtë burg shfarosës:

Mbrëmje, flatrim bishtukësh burg, Burrel,
Dy radhë qelish, në mes një nevojtoje
Që qelbet. Ndër dy krahët korridore
Si ndër trena pa fund.
Lloze vigane e dryna, dyer me katrorë
Çimento qelash, mesëret njohin oborin
Pa një gjeth. Një pus pa grykë
Ku enë gavete llokoçiten për ujë
.....

Edhe ky burg i tmerrshëm i diktaturës u shpërthye më 2 gusht 1967 nga djelmshat trima dhe të guximshëm Sazan Hadëri nga Gjirokastra. Dhori Grinjoti nga Korça dhe Adem Allçi nga Tropoja. I pari u vra nga rojat e rrethimit, kurse Adem Allçi dhe Dhori Grinjoti u kapën të plagosur.

KAMPI SHFAROSËS I MALIQIT

Ky kamp ishte një nga kampet më të mëdha dhe më të stërmundueshme të diktaturës komuniste shqiptare gjatë sundimit të saj gjysmëshekullor.

Kampi u hap në prillin e 1947-s dhe shërbeu gjer më 1952. Kampi i Maliqit ndahej në 3 kampe. Në atë të Vloçishtit, të Orman Pojanit dhe të Nishavecit. Komandant i kampit ishte xhelati Tasi Marko, vëllai i anëtarit të Byrosë Politike, Rita Markos. Në Maliq kanë punuar 2000 të burgosur për pesë vjet, gjatë muajve prill-tetor gjer më 1952.

Mundimi i tyre nuk mund të krahasohet as me atë të sklevërve të antikitetit. Të dënuarit punonin për tharjen e kënetës së Maliqit, të zhytur në baltovinat e kënetës deri në kërthizë. Mbi kokë u qëndronin policët me bishta lopate gati për t'i goditur dhe dielli përvëlues. Si ushqim kishin një supë patatesh dhe 600 gr bukë misri. Këmbët ua çanin kallamat dhe gjakun ua thithnin ushunjëzat. Nuk mungonin dhe torturat më çnjerëzore. Si futja në gropën e fekaleve gjer në fyt, grososja e gjallë e të riut 23-vjeçar Virtyt Gjylbegaj dhe ndonjë i burgosur fatkeq, që gjatë rrugës për të shkuar në punë rrëmbente ndonjë panxhar të ndyrë me baltë, për të shuar urinë, e paguante me hunj kurrizit, gjersa binte pa ndjenja përtokë. Të tillë fat ka pësuar farmacisti Alfred Ashiku dhe shumë të tjerë, që janë rrahur në mënyrë shtazarake. Shumë të burgosur kanë bërë vetërvrasje duke u hedhur mbi telat me gjemba, me dhjetëra të tjerë kanë vdekur nga sëmundjet dhe nga puna e stërmundueshme. Numri i të vdekurve në këtë kamp është 62 veta.

Kufomat e tyre u zhdukën në baltovinat e kënetës së Maliqit.

GRATË SHQIPTARE NË BURGJET DHE NË KAMPET E DIKTATURËS KOMUNISTE

Terrori komunist në Shqipëri nuk kurseu as gratë shqiptare, të cilat u dënuan me internime, burgje dhe deri te dënimet kapitale. Qysh në kohën e luftës u pushkatua

në Ramicë të Vlorës, më 1944, Ramize Gjebrea, një nga luftëtaret e para antifashiste, që shquhej për zgjuarsin dhe guxim. Mbas vendosjes së diktaturës komuniste u arrestuan shumë gra, që regjimi i Enver Hoxhës i kishte vënë në shënjestër, si Drita Kosturi, e fejuara e Qemal Stafës, Musine Kokalari, Qefsere Begeja, Hava Golemi, Dhora Leka, Marije Medicina e shumë e shumë të tjera, që u dënuan me burgime të rënda. Me mijëra gra të tjera vuajtën në kampet shfarosëse të internimit, si në Tepelenë, Levan, Seman, Gradishtë, Plug, etj. Në shtator të vitit 1951 u pushkatua anëtarja e Institutit të Shkencave të Shqipërisë Sabahete Kasimati nga Libohova, e diplomuar në Francë për shkencat biologjike, e akuzuar për hedhjen e bombës në Ambasadën Sovjetike. Më 1956, u pushkatua Liri Gega, ish-anëtare e KQ të Partisë Komuniste Shqiptare gjatë kohës së luftës, megjithëse ishte shtatzënë. Gratë e burgosura mbaheshin në kushte çnjerëzore, nëpër qelitë e burrëlit. Më 1957 ato u grumbulluan në burgun e artizanatit, në periferi të Tiranës. Më 1961 për herë të parë u krijua në afërsi të Kuçovës kampi me punë të detyruar për gratë. Në një barakë shumë të keqe dhe mjaft të ngushtë vendosën 60 gra të dënuara politike. Ato punonin në bujqësi dhe shpyllëzime. Për thyerjen më të vogël të rregullores ose mosplotësimin e normës së punës, ato lidheshin me hekura dhe torturoheshin nga gardianet e pashpirt.

Më 1970 kampi u shpërngul në katundin Kosovë të Dumresë, 50 km në jugperëndim të Elbasanit.

Kampi ishte vendosur në një gropë që i ngjante kraterit të një vullkani, ku në verë temperaturat mbërrinin gjer në +45°C. Përçeç grave shqiptare, në këto kampe kishte dhe shumë gra të huaja, të martuara me burra shqiptarë, si italiane, jugosllave, ruse, hungareze, polake, të ngarkuara me dënime të rënda. Në kampin e Kosovës mbi 110 të dënuara detyroheshin të punonin në bujqësi dhe grumbullim gurësh.

«Jeta në këto kampe ishte një ferr i vërtetë». — pohon Fatbardha Deliu, ish-e dënuar politike. Më 1990 kampi u shpërngul në afërsi të katundit Sharrë, në jugperëndim të Tiranës.

KAMPET E BORSHIT DHE I PËRPARIMIT (i SHËN VASILIT)

Në këto kampe për një çerek shekulli, 1966-1991, kanë punuar me mijëra të burgosur politikë e ordinierë, për të bërë tarracimin e maleve të bregdetit, prej Borshit deri në Sarandë, me një gjatësi 50 km. Punohej në një terren malor gjithë gurë dhe shkurre, në temperatura shumë të larta gjatë verës, që të thahej buza për një pikë ujë. Brenda në kampe kushtet higjienike ishin përtokë dhe shumë të burgosur kanë vdekur nga mungesa e ndihmës mjekësore, si pianisti Riçard Riçi, mjeku Vojo Bilbija, etj. Nga mungesa e ujit, që ishte me racion, vetëm një gavatë në ditë, parazitët e sidomos morrat, u thithnin edhe atë pak gjak që u kishte mbetur atyre fatkëqinjve. Puna e tyre ishte më e stërmundimshme se ajo e sklevërve për ndërtimin e Murit të Madh Kinez. Me paturpësinë më të madhe Enver Hoxha krenohej me tarracat e bregdetit, paçka se ato ishin ndërtuar me djersën dhe gjakun e mijëra të burgosurve shqiptarë. Ndodhte shpesh që, kur ndonjë delegacion i huaj vizitonte Shqipërinë, në kohën e diktaturës Enveriane, autoritetet shqiptare i çonin për të vizituar tarracat e bregdetit dhe ndonjë naiv si Ministri i Bujqësisë i Greqisë, që vizitoi këto tarraca më 1985, u mahnit nga kjo mrekulli shqiptare. Kampet me punë të detyruar të bregdetit u hapën më 1966 dhe u mbyllën më 1991, kur filluan proceset demokratike. Në këto kampe, përveç etjes torturuese për ujë, kishte dhe një uri të madhe, që i detyronte të burgosurit të hanin breshka e gjarpërinj, që i gjenin gjatë punës, në qoftë se i futnin në kamp, duke i shpëtuar nga kontrolli i rreptë i policisë. Ata që nuk plotësonin normën i lidhnin në shtylla dhe i rrihnin derisa humbnin ndjenjat. Ka pasur raste që të dënuarit rriheshin derisa jepnin shpirt. Zonja Kristina Fon Kohl (daneze), anëtare e Helsinkit, mbasi vizitoi kampin e të burgosurve në Përparim të Sarandës, mars 1991 deklaroi: «Kampet naziste të Dekanit e të Mathauzenit kanë qenë shumë më të mira se ky kamp që pamë sot këtu.»

Komentet janë të tepërta.

KAMPI—SKËTERRË I SPAÇIT


Në këtë kamp skëterrë për afër një çerek shekulli (1968-1990) me mijëra të burgosur politikë kanë nxjerrë miliona vagonë bakër dhe pirit, duke punuar në galerat e Spaçit, nën kamxhikun e gardianëve shpirtkazmë. Kampi ishte i ndërtuar në një gropë të rrethuar nga malet, ku shikohej veçse një kupë qielli në ngjyrë plumbi. Ish-të dënuarit punonin me tri ndërresa, me mjete primitive, pa asnjë mjet sigurimi teknik. Temperatura në dimër zbriste deri në -15°C dhe për 6 muaj zotëronte bora dhe akulli. Në acarim e dimrit, të burgosurit që nuk realizonin normën lidheshin nëpër shtylla si Krishti, duke u mbuluar nga dëbora dhe akulli. Shumë prej tyre kanë pësuar trauma psikike ose hidheshin mbi telat me gjemba, për t'u vrarë nga rojat e rrethimit. Në maj 1973, nga trajtimi mizor, të burgosurit u hodhën në revoltë të përgjithshme, duke ngritur flamurin kombëtar pa yllin e komunizmit. Forca të shumta të policisë dhe të sigurimit sulmuan kampin nën komandën e zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, xhelatit Feçor Shehut, dhe, mbas një përlëshjeje disaditore, arritën të riarrestonin pothuajse të gjithë të burgosurit. Katër ish-të dënuar: Zef Palin, Dervish Bejkon, Skënder Dajën dhe Hajri Pashën (i sëmurë psikik), i pushkatuan mbas një gjyqi të inskenuar në komandën e kampit, kurse 130 të tjerë u ridënuar me dënime shumë të rënda. Mbas shtypjes së revoltës, të dënuarve u reduktuan ushqimi si sasi dhe cilësi dhe në kamp u vendos një terror i tmerrshëm policor. Në këto kushte terrori, intelektualë të dënuar dhe kurajozë, si Fadil Kokomani, Vangjel Lezho dhe Xhelal Koprencka u drejtuan me një memorandum KQ të Partisë-shtet, për heqjen e diktatorit Enver Hoxha, që po e çonte kombin drejt greminës. Zeusi u tërbua, xhelatët ishin gati të goditnin këdo që ngrinte zërin kundër diktatorit, kështu që të tre intelektualët, u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan. Shumë të tjerë u ridënuan përsëri dhe loja makabër vazhdoi. Në këtë kamp kanë gjetur vdekjen disa dhjetëra të burgosur, ndërsa shumë të tjerë dolën me sëmundje të pashërueshme.

Kampi i Spaçit u mbyll nga qeveria komuniste e Adil Çarçanit, në prag të vizitës në Shqipëri të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, zotit Peres De Kuejar, më 1990.

Kampi i Qafëbarit (1982-1990). Në këtë kamp, 21 km në lindje të Fushë-Arrëzit, kanë punuar 400-500 të burgosur politikë me tri ndërresa, për nxjerrjen e mineralit të bakrit e të piritit. Kushtet ishin shumë të rënda dhe të burgosurit që nuk plotësonin normën u nënshtroheshin torturave. Në punë nxirreshin edhe të sëmurët me temperatura të larta. Më 24 maj të 1984-ës, kur gardianët filluan të rrihnin Ndue Pishën, që s'kishte realizuar normën se ishte i sëmurë, bashkëvuajtësit u hodhën në mbrojtje të tij dhe filloi përlëshja midis tyre dhe policëve, të cilët u tërhoqën në truprojat e kampit dhe hapën zjarr kundër të burgosurve. Pati disa të plagosur dhe kampi u rrethua me trupa të shumta të armatosur gjer në dhëmbë. Nga Tirana mbërriti me helikopter drejtori i përgjithshëm i Sigurimit të Shtetit, Agron Tafa dhe një zëvendësministër i Punëve të Brendshme. Të burgosurve iu dha ultimatum i që brenda 1 ore të dorëzoheshin ose kundër tyre do të hapej zjarr me mitraloza të rëndë. Këshilli drejtues i revoltës, për t'iu shmangur një lumi me gjak, vendosi ta ndërpriste revoltën. U rriarrestuan 40 veta, prej të cilëve 3 u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan: Sokol Sokoli, Tom Ndoja dhe Sandër Sokoli, ndërsa 14 u ridënuan me dënime të rënda. Pas shtypjes së revoltës, rrahjet dhe torturat u bënë të përditshme dhe ushqimi u pakësua. Për të sflitur të burgosurit, përveç punës së rëndë në galeri, çdo ditë bëhej dhe dy orë vrapim i detyrueshëm brenda në kamp, nën kërcënimin e kamxhikëve të policëve, nga këto tortura shumë të burgosur binin në tokë pa ndjenja.

Kampi i Valiasit — Ky është kampi i parë që u hap me të burgosurit politikë qysh më 1945, 12 km në perëndim të Tiranës. Të burgosurit ishin vendosur në disa baraka të vjetra të ushtrisë italiane dhe mbaheshin në kushte shumë të vështira fjetjeje e higjienike. Ishin rreth 400 të burgosur, që punonin për hapjen e kanaleve dhe sistemimin e tokave për krijimin e fermës së Kamzës. Ata vuanin për ujë dhe ushqeheshin me 600 gr. bukë misri e supë patatesh. Ndaj atyre që s'plotësonin normat e punës dhe thyenin rregulloren përdoreshin tortura dhe rrahje shtazarake. Kampi u mbyll më 1946, duke u zëvendësuar me të inter-nuar politikë.

Kampi i stadiumit në Tiranë — Gjatë vitit 1945, disa qindra të burgosur nxirreshin nga burgjet e Tiranës dhe, të shoqëruar me roje të armatosur gjer në dhëmbë, puno-



nin nga 12 orë në ditë për të përfunduar stadiumin «Qemal Stafa», që italianët e kishin lënë përgjysmë.

Kampi i Jubës — U krijua në afërsi të katundit Jubë të Durrësit, më 1946, me 800 të burgosur, të dënuar politikë, që punonin për çeljen e një kanali mbi 5 km të gjatë, me thellësi 6 m dhe gjerësi 10 m, me dy bankina në të dyja anët e kanalit. Këtu punohej në kushte jashtëzakonisht të vështira, të zhytur në baltovina gjer në mes, pa çizme dhe vetëm me 600 gr bukë e supë patatesh. Torturat dhe lidhjet me pranga nëpër shtylla ishin të përditshme për këta fatkëqinj. Shumë të burgosur u sëmuronë dhe mbi 20 veta lanë kockat në këtë kamp të mallkuar.

Kampi i Kozarës — U çel më 1948, 30 km në perëndim të Beratit. Në këtë kamp kanë punuar 700 të burgosur për dy vjet rresht, duke hapur shumë kanale për bonifikimin e Fushës së Myzeqesë.

Përveç punës rraskapitëse, të burgosurit bënë dhe 3 orë udhëtim vajtje ardhje gjer në vendin e punës. Normat e punës ishin shumë të larta dhe, kur kishte ndodhur që ata nuk i kishin plotësuar, ishin groposur edhe të gjallë në dhe.

Kampi i Gosës së Kavajës — Ky kamp u çel më 1949, me 600 të burgosur politikë, 12 km në jug të Kavajës. Të dënuarit punonin për hapje kanalesh dhe sistemim tokash për ngritjen e fermës së Gosës. Ata punonin nën diellin përvëlues nga 10-12 orë në ditë, duke u dhënë vetëm nga një gavatë ujë për njeri. Kushtet e fjetjes ishin jashtëzakonisht të vështira. Në këtë kamp, ku puna ka vazhduar për dy vjet, kanë gjetur vdekjen 15 të burgosur nga puna e stërmundshme dhe nga sëmundjet.

Kampi i Bedenit — Ky kamp, i ndërtuar disa kilometra në jugperëndim të Kavajës, shërbeu për dy vjet, 1950-1952, me rreth 1000 të dënuar politikë. Punohej për hapjen e një kanali 15 km të gjatë, në terren kodrinor me gurë shtufi. Puna ishte shumë e vështirë dhe shpeshherë përdroreshin dhe minat. Ata që nuk realizonin normën e punës lidheshin me pranga nëpër shtylla dhe rriheshin nga gardianët gjersa humbisnin ndjenjat. Nga puna e rëndë, torturat dhe aksidentet në punë, kanë gjetur vdekjen mbi 20 të burgosur.

Kampi i Urës së Bonës — Ky kamp u çel më 1950, me 700 të burgosur, në afërsi të qytetit të Peqinit, për ndërtimin e trasesë së hekurudhës Peqin-Elbasan.

Kampi i Bishqemit — Ky kamp u çel në perëndim të Elbasanit, afër katundit Bishqem, me 900 të burgosur, për hapjen e tunelit të hekurudhës në Bishqem, 400 m të gjatë. Nga puna me mjete primitive dhe pa asnjë sigurim teknik, me dhjetëra të burgosur kanë gjetur vdekjen gjatë hapjes së tunelit. Puna vazhdoi për një vit.

Kampi për hapjen e kanalit Peqin-Kavajë — Gjatë viteve 1952-1955 rreth 2000 të burgosur kanë punuar për hapjen e kanalit më të madh të ndërtuar në Shqipëri gjatë viteve të regjimit komunist, 50 km i gjatë, i cili fillon në afërsi të qytetit të Peqinit gjer në qytetin e Kavajës. Kampi i ish-të dënuarve politikë u shpërngul tri herë gjer në mbarimin e veprës. Puna ishte e stërmundimshme, terreni ishte mjaft i vështirë dhe në pjesën më të madhe kanali u betonua. Nga përdorimi i dinamitit, gjatë hapjes së kanalit janë vrarë 3 të burgosur dhe kanë vdekur mbi 20 veta. Uji ishte i racionuar, madje gjatë stinës së verës mungonte edhe për ditë të tëra. Torturat dhe lidhjet nëpër shtylla si gjatë punës ashtu dhe brenda në kamp ishin të përditshme.

Kampi i Vlashukut — Ky kamp u ndërtua 10 km në veriperëndim të Kuçovës. Aty u punua për 2 vjet, (1952-1954), për hapjen e një kanali 2 km të gjatë. Këtu punuan 1500 të burgosur dhe puna e tyre ishte shumë më e lodhshme se ajo e skllëvërve të Egjiptit. Kanali u ndërtua për tërheqjen e ujërave nga lumi Devoll dhe kishte një thellësi 30 metra. Dheu hidhej në 10 bankina, 3 metra të larta njëra nga tjetra, gjersa dilte në argjinaturë. Në prag të përrurimit të veprës, nga shirat e rëna ato ditë, argjinatura u rrëzua së bashku me bankinat dhe kanali pjesërisht u mbush. Filloi një punë e dytë, shumë më e lodhshme se e para, nga këta skllëvër të shekullit XX. Nga mundimet, vetëvrasjet dhe sëmundjet në këtë kamp kanë humbur jetën rreth 40 veta. Në kampin e Vlashukut ndodhej një aneks me qytetarë grekë, shumica ishin ushtarakë të kapur nga forcat komuniste greke gjatë Luftës Civile 1945-1949 në Greqi dhe dorëzuar qeverisë komuniste shqiptare.

Kampi i Urës Vajgurore — Në këtë kamp kanë punuar 2000 të burgosur, për ndërtimin e aeroportit të Kuçovës, për një periudhë 4-vjeçare, 1948-1952. Një pjesë e të burgosurve punonin në gurore për nxjerrjen e gurëve për shtrimin e pistës, kurse të tjerët bënin nivelimin e fushës dhe hapjen e kanaleve anësore. Punimet drejtoheshin nga

oficerë rusë, se ky aeroport do të shërbente si bazë e tyre në Ballkan. Nga ky kamp pati një arratisje masive, po shumica u kapën dhe u dënuan me vdekje, kurse një pakicë shumë e vogël mundi të kalonte kufirin grek.

Kampi nr. 4 Tiranë — Në këtë kamp kanë punuar 600 të burgosur, gjatë periudhës 1953-1955, për ndërtimin e pallateve të bllokut «Agimi», buzë Lanës. Nga trajtimi mizor dhe puna e rëndë, një grup të burgosurish filluan të hapnin një tunel për t'u arratisur. Të denoncuar nga një provokator, riarrestohen dhe katër prej tyre dënohen me vdekje dhe ekzekutohen. Ata ishin: Abdulla Bajrami, Mark Zefi, Isuf Velçani dhe Zydi Mancaku. Shumë të tjerë u ridënuan me burgime të rënda. Mbas kësaj ndodhie, gjithë kampi iu nënshtrua një terrori masiv.

Kampi i Rinasit — Në këtë kamp, 17 km në veri-perëndim të Tiranës, kanë punuar rreth 1500 të burgosur politikë gjatë periudhës 1955-1957, për ndërtimin e aeroportit ndërkombëtar të Rinasit, më imadhi në vendin tonë. Të burgosurit bënë mbi 20 km rrugë në ditë, duke shtyrë vagonët e mbushur me materiale ndërtimi. Uji ishte i racionuar dhe të burgosurit nuk lejohej të futeshin në kabanone para pushimit të orës 20.⁰⁰ Edhe nga ky kamp ka pasur përpjekje për arratisje, por pak veta kanë pasur fatin e mirë ta kalonin kufirin.

Kampi i Varibobës — Në këtë kamp, të vendosur disa kilometra në lindje të Fierit, kanë punuar rreth 700 të burgosur, gjatë periudhës 1955-1956, për bonifikimin e fushës së Fierit. Kushtet e punës ishin tepër të rënda dhe gjithë kampi furnizohej me ujë nga një pus. pa asnjë kusht higjienik. Mjaft të burgosur u sëmurën dhe disa vdiqën nga sëmundje infektive.

Kampi i Tërbufit — Në këtë kamp, të ngritur në veri të Lushnjës, kanë punuar rreth 900 të burgosur, gjatë periudhës 1955-1957, për tharjen e kënetës së Tërbufit. Shpesh të burgosurit detyroheshin të punonin të zhytur në baltë gjer në mes dhe disa prej tyre janë mbytur në llumin e kënetës. Nga pickimet e ushunjëzave të infektuara, shumë të burgosur u sëmurën dhe mjaft prej tyre gjetën vdekjen.

Kampi i Zadrimes — Ky kamp u ndërtua në fushën e Zadrimes, midis Shkodrës dhe Lezhës, për bonifikimin e lumit Gjadër. Në këtë kamp kanë punuar 800 të burgosur, prej të cilëve 300 ishin ushtarakë grekë të dënuar në Shqi-

përi. Ky kamp shërbeu për një periudhë 2-vjeçare, (1955-1957), dhe puna ishte tepër e lodhshme. Shumë ish-të burgosur, sidomos grekë, i kanë dhënë fund jetës duke u hedhur në telat e rrethimit.

Kampi i stadiumit «Dinamo» në Tiranë — Në këtë kamp kanë punuar rreth 500 të burgosur, për ndërtimin e stadiumit «Dinamo». Punohej pa pushim, 10 orë në ditë.

Kampi i Thumanës — Në këtë kamp, në veriperëndim të Krujës, kanë punuar rreth 500 të burgosur, gjatë periudhës 1960-1963. Të burgosurit bënë mbi 10 km në ditë duke kaluar nëpër baltovina dhe kanale të mbushura me ujë. Gjatë punës 3-vjeçare në Thumanë të dënuarit hapën me dhjetëra kanale me një gjatësi të përgjithshme rreth 100 km.

Kampi i Bllokut Puna në Tiranë — Në këtë kamp kanë punuar 400 të burgosur, për ndërtimin e 500 apartamenteve, gjatë periudhës 3-vjeçare 1960-1963. Nga mungesa e sigurimit teknik ka pasur shumë aksidente gjatë punës.

Kampi i Sanatoriumit — Në këtë kamp, 2 km në lindje të Tiranës, kanë punuar 350 të burgosur, gjatë periudhës 1960-1963, për ndërtimin e Sanatoriumit.

Kampi i kombinatit ushqimor në Tiranë — Në këtë kamp, gjatë periudhës 1959-1961, kanë punuar 300 të burgosur, për ndërtimin e fabrikës së bukës dhe fabrikave të tjera të industrisë ushqimore.

Kampi i Laçit — Në këtë kamp kanë punuar rreth 700 të burgosur, për një periudhë 4-vjeçare, (1963-1967). Në fillim të burgosurit u morën me ndërtime apartamentesh në qytetin e Laçit dhe më 1964 u përqëndruan për ndërtimin e uzinës së plehrave fosfatike dhe të acidit sulfurik. Nga aksidentet në punë kanë gjetur vdekjen 9 të burgosur. I burgosuri Eqerem Zeka është vrarë nga rojat në prag të lirimt, kurse dy të tjerë janë vrarë për tentativë arratisjeje: Mark Cufi dhe Naun Kondakçiu. Punimet i drejtonin specialistë kinezë.

Kampi i Rubikut — Në këtë kamp, ndërtuar në afërsi të qytetit të Rubikut, buzë lumit Fan, kanë punuar për dy vjet, (1963-1965), 400 të burgosur, për ndërtimin e uzinës së shkrirjes së bakrit. Punimet i drejtonin kinezët. Puna ishte tepër e vështirë, punohej në ujë, pa masa mbrojtëse. Komandanti i kampit, Bajram Korvarfa, ishte një shtazë me fytyrë njeriu, që i torturonte me duart e tij të burgosurit fatkëqinj.

Kampi i Fushë-Krujës — Në këtë kamp, gjatë periudhës 2-vjeçare, (1965-1966), kanë punuar 600 të burgosur, për ndërtimin e fabrikës së çimentos, në kushte shumë të rënda higjienike. Ka pasur disa përpjekje për arratisje, por të pasuksesshme. Guximtarët si Ylli Tabaku e Maksut Xhuma u janë nënshtruar torturave nga më mizoret, para gjithë të dënuarve. Komisari i kampit, Besnik Çomoja, shquhej për metodat e tij diabolike që përdorte ndaj të dënuarve.

Kampi i Elbasanit — Ky kamp ishte vendosur 3 km në veriperëndim të Elbasanit, në vendin e quajtur «Gropa e Tezes». Këtu, për një periudhë 2-vjeçare, (1966-1968), punuan 1000 të burgosur, për ndërtimin e fabrikës së çimentos, në kushte tepër të vështira fjetjeje. Në një sipërfaqe 400m² flinin 1000 të burgosur. Nga dëshpërimi i rëndë disa të burgosur kryen vetëvrasje, duke u hedhur në telat e rrethimit. Në këtë kamp, më 1967, u vra në mënyrë barbare dhe misterioze një nga Mandelët e Shqipërisë, Ali Maliqi nga Dibra.

Kampi i Rëpsit, (Mirditë) — Në këtë kamp punuan për një periudhë 2-vjeçare, (1968-1970), 350 të burgosur, për ndërtimin e uzinës së pasurimit të bakrit. Puna ishte tepër e vështirë, mbasi terreni ishte shkëmbor dhe punohej vetëm me qysqi e vare. Temperatura në dimër binte nën -15°C. Nga të ftohtët, mungesa e ushqimit dhe kushtet higjienike gjetën vdekjen disa të burgosur me moshë të kaluar.

Kampi i Skrofotinës, Vlorë — Ky kamp ishte ngritur afër katundit Skrofotinë, 13 km në veri të Vlorës. Aty punuan 700 të burgosur, për 4 vjet rresht, (1967-1971), për tharjen e një pjese të kënetës së Nartës dhe për ndërtimin e kripores. Një pjesë e të burgosurve të këtij kampi ndërtepunuan stacionin e pompimit në Pishëpero. Punohej në kushte tepër të vështira dhe nën pickimin e vazhdueshëm të mushkonjave. Mungonin uji i pishëm dhe kushtet elementare të higjienës. Nga dëshpërimi i thellë, i burgosuri Lake Butka bëri harakirin.

Kampi i Ballshit — Ky kamp u ndërtua 2 km në lindje të qytetit të Ballshit dhe shërbeu për një periudhë shumë të gjatë, (1971-1984). Mbi 1000 të burgosur punuan për ndërtimin e uzinës së përpunimit të naftës dhe ndërtim apartamentesh në qytetin e Ballshit. Në këtë kamp ishin grumbulluar disa qindra të burgosur me sëmundje të pa-

shërueshme dhe trauma psikike, të lënë në mëshirën e fatit. Me dhjetëra të burgosur gjetën vdekjen, midis tyre dhe piktori i talentuar nga Korça Vangjel Tusha.

Kampi i Torovicës — Ky kamp u ngrit në verilindje të Lezhës dhe shërbeu për 23 vjet, (1968-1991). Ky kamp ka pasur rreth 400 të burgosur të moshave 14-20 vjeç. Të rinjtë punonin në bujqësi duke hapur kanale dhe toka të reja nga 10-12 orë në ditë. Organet e sigurimit të Enver Hoxhës e quanin këtë kamp «model riedukimi» për të burgosurit politikë, po në fakt ishte kampi që zinte vendin e parë në Shqipëri për degjenerimin dhe shkatërrimin moral të të dënuarve. Mungonte uji i pishëm dhe kushtet higjienike ishin në zero. Parazitët, (sidomos morrat), u thithnin gjakun këtyre fatkëqinjve. Me dhjetëra të dënuar kanë gjetur vdekjen nga sëmundjet dhe vetëvrasjet nga dëshpërimi.

Kampi i kompleksit «Dinamo» — Ky kamp u ngrit në afërsi të Liqenit Artificial të Tiranës, me 400 të burgosur, dhe punoi për një periudhë 10-vjeçare, (1977-1987), për ngritjen e kompleksit sportiv «Dinamo» të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të qindra apartamenteve banimi për efektivat e kësaj ministrie.

Shënim: Në shumicën e rrethëve të Shqipërisë pranë Degëve të Punëve të Brendshme, mbaheshin nga 20-50 të burgosur me dënime të vogla për ndërtim apartamentesh për efektivat e sigurimit dhe të policisë.

MANDELËT E SHQIPËRISË

Republika e Afrikës së Jugut, me 30 milionë banorë dhe me një sipërfaqe 1 milion km², ka nxjerrë një Nelson Mandela, që bëri 27 vjet burg me televizor mbi tryezë, me bukë të bardhë dhe mish fazani.

Mandelët shqiptarë e kanë bërë burgun me një krodhë buke, me supë patatesh dhe kanë fjetur në beton në temperaturat —25°C, të mbuluar me batanije të grisura. U ka munguar një copë laps dhe një copë letër për t'u shkruar të afërmeve të tyre. Po kush janë këta Mandelë dhe ku ndodhen? Kudo, në gjithë Shqipërinë, nga Vermoshi në Konispol.

Dhe ja disa prej tyre:

1. Sami Dandëllia nga Devolli i Korçës. Bëri 43 vjet burg dhe do të bënte përsëri, po të mos kishte vdekur aty.

2. Petrit Velaj, student nga Kanina e Vlorës. Bëri 40 vjet burg, aq sa bëri dhe Rudolf Hesi, krahu i djalhtë i Adolf Hitlerit.

3. Haxhi Mekolli nga katundi Arrëz i Korçës, fshatar analfabet. Vuajti 40 vjet burg dhe vdiq në internim, në Gradishtë të Lushnjës.

4. Musine Kokalari, nga Gjirokastra, shkrimtare dhe intelektuale e shquar. Vuajti 40 vjet burg e internim, gjer-sa vdiq në një kasolle në Rrëshen të Mirditës. Rast unik në Shqipëri dhe ndoshta në të gjithë Evropën Lindore.

5. Ilia Treska, nga Berati. Arrestuar në moshën 16 vjeç, kur ishte nxënës në gjimnazin e Gjirokastrës. Vuajti 35 vjet burg dhe tani mbijeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

6. Pjetër Arbënori nga Shkodra, mësues. Luftoi për pluralizmin më 1960 dhe e pagoi me 28 vjet burgim. Sot Kryetar i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Shqipërisë.

7. Kudret Kokoshi, poet, përkthyes e jurist nga Vlora. Nuk i mjaftuan 2 vjet internim në kampin nazist të Mat-hauzenit, por bëri 20 vjet burg në Burrel. Tani ndodhet në fundin e rrugës që i kishin paracaktuar. Vdiq para disa ditësh.

8. Lazër Radi, jurist, poet dhe përkthyes. Arrestohet më 1944 dhe vuan 45 vjet burg e internim, për pikëpamjet e tij politike, filozofike, properëndimore. Sot, në moshën 77-vjeçare, është një nga udhëheqësit e Lëvizjes Demokratike për Bashkimin e Shqipërisë.

9. Patër Meshkalla, klerik Shkodran. Euridit dhe atë shpirtëror i të gjithë bashkëvuajtësve, pa dallim besimi dhe krahine. Vuajti 30 vjet burgim dhe vdiq në mjerim të plotë, si ushtar besnik i Jezu Krishtit.

10. Ali Maliqi, nga Dibra. Patriot, bujar dhe gojëmbël me të gjithë. Mbas 25 vjet burgim, vritet në mënyrë misterioze në kampin me punë të detyruar të Elbasanit, në prag të lirimimit nga burgu.

11. Eshref Zagorçani, nga Pogradeci, mësues, vuan 36 vjet burgim dhe 5 vjet internim. Aktualisht i mbetur në mes të katër rrugëve, pa familje, pa shtëpi, në moshën 70 vjeç.

12. Xhemal Bali, nga Vërva e Konispolit. I dënuar tri herë nëpër burgjet për agjitacion e propagandë. Hyri në moshën 20 vjeç dhe doli nga burgu në moshën 52 vjeç.

13. Nikollë Zefi, nga Oróshi i Mirditës. Vuajti 26 vjet burgim për të vetmin faj se deshë të ikte jashtë shtetit. për të fituar bukën e gojës për fëmijët e tij të mitur.

14. Osman Kazazi, student tiranas. Vuajti 40 vjet burg e internim dhe sot kryetar i Shoqatës së Ish-të Burgosurve Politik të Shqipërisë.

15. Bardhyl Belishova. inxhinier elektrik, nga Tirana Vuajti 26 vjet burgim për pikëpamjet e tij politike.

16. Dhori Grinjoti, boksier. Dënohet për tentativë arratisjeje dhe pastaj për shpërthimin e burgut të Burrelit. Vuajti 28 vjet burgim.

17. Bedri Spahiu, ish-anëtar i Byrosë Politike të Partisë së Punës dhe Prokuror i Përgjithshëm, ka vuajtur 17 vjet burg dhe 17 vjet internim për kritikën e tij ndaj Enver Hoxhës.

18. Dom Simon Jubani, klerik shkodran, vuajti 28 vjet

burgim. Në nëntor të 1990-s, sapo kishte dalë nga burgu jep meshën e parë në Shkodër për besimtarët katolikë, mbas një çerek shekulli të ndalimit të fesë. Iu dha Honoris Causus nga Universiteti i San-Franciskos të SHBA.

A doni të tjerë Mandelë politikë?

Shqipëria ka shumë. Mbi dhe e nën dhe. Njihini dhe tregojani botës, për të treguar vitalitetin e këtij populli, që ka thyer rekorde në çdo etapë historike.

E PAMPOSHTURA MUSINE KOKALARI

Musine Kokalari, kjo Bubulinë e shekullit të njëzetë, e fillon veprimtarinë politike qysh në bankat e shkollës së mesme femërore të Tiranës, nga fundi i viteve tridhjetë. E lindur në një familje intelektualësh, më 1917, me prindër dhe vëllezër juristë, me mendime nga më të moderuarat për kohën, ajo brumoset qysh në fëmijëri me ide përparimtare, me dashuri të pakufishme për trojet shqiptare dhe me urrejtje për regjimet totalitare. Duke qenë një njohëse e thellë e tabanit kombëtar dhe e kulturës botërore, ajo përfaqon idealin socialdemokrat, si të vetmen rrugë për përparimin e vendit tonë. Mbaron shkëlqyeshëm Universitetin e Romës dhe kundërshton postin e dhënë në Fakultetin e Letrave të këtij universiteti, vetëm për t'u ndodhur midis popullit të saj në ato kohëra të vështira. Pushtimi fashist i 7 prillit e hidhëroi thellë Musinenë, por ajo është e bindur se diktaturat kanë jetë të shkurtër, se boshti fashist Romë-Tokio-Berlin do ta humbasë luftën grabitqare, se Shqipëria do të çlirohet nga zgjedha fashiste, se liria dhe drejtësia do të triumfojnë. Gjatë viteve 1940-43 Musineja zhvillon një veprimtari politike të ethshme intelektuale me botëkuptim pro demokracive perëndimore, që ishin përkrahëse të rregullta të së parës mesazjeri shtypi në Shqipëri, që ajo e drejtonte me aq sukses. Ajo diskutonte me patos gjendjen kritike në vend, ngjarjet në frontet e luftës dhe nxirrte konkluzionet për detyrat imperative të inteligjencës shqiptare në situatat e krijuara. Ajo ndiqte me mosbesim veprimtarinë e dyshimtë të Partisë Komuniste Shqiptare, duke zbuluar rolin negativ të emisarëve jugosllavë. Ajo kritikonte ashpër gjithë kolaboracionistët me pushtuesit e huaj dhe i paralajmëronte ata për fundin e turpshëm. Mbas dështimit të Konferencës së Mukjes. gusht 1943 dhe kapitullimit të Italisë me 8 shta-

tor të po atij viti, Musineja iu vu punës për krijimin e menjëhershëm të PSD Shqiptare, si një grupim politik ndër-mjet partive të djathta Ballit, Legalitetit dhe Partisë Komuniste Ajo, së bashku me juristin Skënder Muço, profesorin Isuf Luzi, juristin Abaz Omari e të tjerë, formuan Partinë Socialdemokrate Shqiptare dhe botuan në ilegalitet 6 numra të gazetës «Zëri i Lirisë», organ i PSD-së. Musineja zhvilloi takime të shumta me intelektualë të pavarur, me udhëheqës të partive politike, për të krijuar një front nacionalçlirimtar pluralist, gjë që u hodh poshtë nga PKS, e drejtuar nga sllavofilë. Pikërisht për këtë veprimtari politike Musineja vihet në shënjestër jo vetëm nga Gestapoja gjermane, por dhe nga udhëheqja komuniste, e posaçërisht nga Enver Hoxha, i cili e njëjtte mirë karakterin dhe forcën intelektuale të saj, mbasi me të lartpërmendurën binte dhe farefis. Më 1944, Skënder Muçoja, mbas këshillimeve me Musinenë, organizon në Dukat të Vlorës forcën e armatosur të PSD-së, pranë së cilës u ngarkua me një emision ushtarak amerikan, që mbante lidhje të vazhdueshme me komandën aleate të Mesdheut. Dukati u përgatit si bazë për zbarkimin e mundshëm të ushtrive aleate në Shqipëri, gjë që shqetësoi së tepërmi udhëheqjen komuniste shqiptare, e cila urdhëroi asgjësimin e menjëhershëm të këtij grumbullimi forcash, për të zhdukur çdo grumbullim opozitar kundër PKS, që mund të gëzonte përkrahjen e aleatëve perëndimorë. Këto veprime të socialdemokracisë shqiptare alarmojnë dhe Gestapon gjermane, e cila, me tradhti, arreston në fund të gushtit 1944 Skënder Muçon së bashku me profesor Ismail Yzeirin dhe Sako Mezirin, të cilët i pushkaton po atë ditë, në katundin Kallm të Lushnjës, me urdhër të gjeneral Fistunit. Kjo që një humbje e madhe për socialdemokracinë shqiptare dhe i shkaktoi një tronditje të thellë Musinesë, e cila përkohësisht, në rrethanat e krijuara, ndërpreu veprimtarinë e saj. Me 12 nëntor 1944, kur ende zhvilloheshin luftime në rrugët e Tiranës, Musineja arrestohet së bashku me dy vëllezërit e saj, Vesium dhe Muntaz Kokalarin, nga një komandë partizane, me urdhër sekret të Enver Hoxhës dhe mbahet dy javë në arrest në një bazë të kthyer në burg; kurse vëllezërit e saj dhe kushëriri, Syrja Kokalari, vriten barbarisht në bimsat e Hotel Bristolit, që ndodhej në qendër të Tiranës, bashkë me 9 të pafajshëm të tjerë. Sigurisht vrasja mizore e vëllezërvë të saj të pafajshëm që një tjetër

goditje e rëndë për Musinenë e brishtë, por kjo ia shtoi më tepër urrejtjen dhe veprimtarinë kundër murtajës së kuqe, që kishte shtrirë kthetrat e vdekjes në mbarë vendin tonë. Megjithëse nën mbikëqyrje dhe e ndjekur këmba-këmbës nga agjentët e Sigurimit, me guxim dhe zgjuarsinë që e karakterizonte, arrin të krijojë lidhje të reja politike me ish-të njohurit e saj, që i kishin shpëtuar terrorit komunist. Në mars të 1945-s, formon një grupim politik, ku midis të tjerëve bënin pjesë profesor Gjergj Kokoshi dhe juristi Suad Asllani. Në verën e 1945-s hyn në lidhje me dy grupe të rezistencës antikuniste, të udhëhequra përkatësisht nga Sami Çeribashi dhe Qenan Dibra, harton memorandumimin që u dërgohet në emër të këtyre grupeve misioneve ushtarake aleate të akredituara në Tiranë dhe me 6 nëntor 1945, me përpjekjet e saj titanike, në shtëpinë e Ali Kavajës, në lagjen ku 5 vjet më parë ishte formuar PKSH, formohet i pari grupim opozitar antikomunist «Bashkimi Demokratik». Në mbledhjen e 6 nëntorit u miratua njëzëri nga të gjithë të pranishmit përmbajtja e memorandumit, ku kërkohet ndërhyrja e qeverisë aleate pranë qeverisë së Enver Hoxhës për anulimin e përgatitjeve për zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, për Asambleshën Kombëtare, mbasi këto zgjedhje do të manipuloheshin nga PKSH dhe do të shkelej çdo parim demokratik. Fatkeqësisht qeveritë aleate heshtën dhe zëri i opozitarëve të regjimit komunist në Shqipëri trokiti në derë të shudhët. Personalisht Musineja, duke përbuzur rrezikun që i qëndronte mbi krye si shpata e Demokleut takohet me kolonelin anglez Palmer, duke i bërë një ekspozë verbale të gjendjes në vend para zgjedhjeve dhe kërkesat e opozitës klandestine: po përsëri heshtje dhe sakrifikim i opozitarëve shqiptarë, për hir të konjunkturave politike të kohës. Shqipëria lihet nën ombrellën e Beogradit dhe rrezikon të humbasë pavarësinë, duke u shndërruar në një republikë të shtatë të Jugosllavisë Federative. Në janar të 1946-s Musineja arrestohet, duke filluar kështu kalvarin e torturave dhe të mundimeve dyzetvjeçare. Duron me stoicizëm të gjitha torturat dhe fyerjet e hetuesve injorantë dhe xhelatë, del para gjyqit ushtarak të kryesuar nga Frederik Nosi dhe prokuror Nevzat Haznedarin, duke mbajtur një qëndrim plot dijitet dhe duke mos mohuar aspak pikëpamjet e saj politike. Me replikat e saj të spikatura dhe plot argumenta, Musineja i vë akuzatorët në shtyllën e turpit. Dënohet me 2 korrik të 1946-s me 20 vjet burgim

si «sabotatore dhe armike e betuar e pushtetit popullor». Njohu të gjitha burgjet e diktaturës komuniste, duke përfshirë dhe burgun-ferr të Burrelit. Gjatë gjithë viteve të vuajtjes së dënimit, Musinesë iu bënë presione nga më djallezore, me porosi të vetë diktatorit, i cili kërkonte me këmbëngulje që ajo të thyhej moralisht dhe i kërkohet të thoshte vetëm dy fjalë: *Kërkoj falje*, duke i premtuar lirinë e menjëhershme dhe një pension të mjaftueshëm. Ajo s'pati asnjë tundim dhe emisarët e dërguar nga Enver Hoxha, për këtë qëllim, ktheheshim duabosh dhe kokulur, duke marrë me vete kundërshtimin kategorik të Musinesë. Inkuizitori i madh nuk mundi ta përkulte këtë Zhan D'Arkë shqiptare. Ajo u bë një simbol i disidencës shqiptare dhe udhëheqëse shpirtërore e grave shqiptare që vuanin dënimin në burgjet e diktaturës komuniste. Shumë ish-të dënuara politike, si Drita Kosturi, Rita Koka, Nuriye Koçuli, Qefsere Begeja, Hava Golemi, Marije Medicina, Jolanda Tafmizi, Lavdije Petrela e të tjera, flasin me veneration për qëndrimin dinjitoz të Musinesë ndaj veglave të diktaturës, për këshillat e saj për të qëndruar me moral të lartë dhe për idetë që u ngulte në shpirtrat e mendjet e tyre për fitoren e lirisë dhe shkatërrimin e diktaturës. Lirohet nga burgu Mirditës. Punon në bujqësi dhe në ndërtim si punëtoreset llaçi, me çizme llastiku gjer në gju. Dimër e verë. Përgjotë largohet as 100 metra nga vendi i internimit pa lejen e degës së Punëve të Brendshme. Shikohet me admirim dhe frikë nga banorët e Mirditës, por askush nuk guxon t'i afrohet dhe t'i thotë një fjalë. E rraskapitur nga vuajtjet e pafund dhe e dërmuar nga punët e rënda, Musineja sëmuret nga kanceri dhe vdes e vetmuar në vendin e interqë t'i mbyllte sytë. Shoqërohet në banesën e fundit nga dy varrmihës të komunales dhe nga operativi i Sigurimit, gura e saj, sa poliedrike e fundit për këtë heroinë. Fibëlltyrë unike jo vetëm për vendin tonë, po për gjithë vendet e Evropës Lindore, që lënguan për gjysmë shekulli nën terrorin komunist. Musineja u mor me politikë jo si një karrieriste e etur për pushtet, po për të mbrojtur interesat kombëtare në çaste dramatike për vendin tonë dhe për të shpëtuar kombin nga tragjedia që i përgatitën armiqtë e

Shqipërisë, sllavët shovinistë, të sheqerosur me ideologjinë komuniste. Është imperativ i kohës që arti dhe letërsia shqiptare t'ua prezantojë brezave të rinj me objektivitet dhe realizëm figura të ndritura si Musine Kokalari, të lëna në harresë dhe të deniguara nga regjimi komunist.

I përjetshëm qoftë kujtimi i saj!

* * *

Në ditarin e saj intim, dhuruar disa ditë para se të vdiste, zotit Platon Kokalari, ajo shkruan:

«Njoha kulturën demokratike. Njoha tragjedinë e përmbysjeve të mëdha revolucionare. Njoha një gjyq special. Njoha 16 vjet burg dhe 20 vjet internim me përplasje andej-këndeje. Njoha punën e punëtorit me normë individuale, njoha punën e krahut me normë kolektive në bujqësi e në ndërtim. Njoha vetminë e vetëkërkuar, shoqërinë e rastit në burg dhe gjithë ndryshimet që pasojnë nga ky tërmet i pandërprerë për të konsoliduar diktaturën e proletariatit...»

Dhe më poshtë vazhdon:

«Kam 38 vjet që kam harruar ç'do të thotë familje. Nganjëherë them me vete se nuk fitova gjë që mbeta gjallë. Ndoshta do të ishte më mirë t'i kisha mbyllur sytë një herë e përgjithmonë, kështu merrnin fund edhe vuajtjet, me gjithë gjendjen tragjike. Kjo do të ishte një zgjidhje shumë e mirë. Në spitalin onkologjik ajo shkruan në ditarin e saj: «Këtu kuptova një gjë. Për mua jo vetëm nuk interesohen, por kanë qejf të më zvarritin. Dhe vetë kontrollet e këtyre muajve s'janë gjë tjetër veçse fjalë të kota. Ç'do të ngjasë?...»

MËSUES, SHOK DHE BASHKËVUAJTËS

Në një ditë të ngrohtë tetori të vitit 1962, për herë të parë pas dënimit, dilja në oborrin e burgut të Tiranës. Një mori të burgosurish, të të gjitha moshave, po bënëin pajtosin. Njerëz kockë e lëkurë, me fytyra të drobitura, të veshur me lecka të arnuara me lloj-lloj ngjyrash. tërhiqnin me mundim këmbët e lodhura. Në dritaret e katit të dytë, ku ndodhej drejtoria e burgut, shiheshin turli hetuesish dhe oficerë të Sigurimit, që me buzëqeshje cinike i tregonin njëri-tjetrit viktimat e tyre. Midis të burgosurve, më tërhoqi vëmendjen një njeri i shkurtër, me syze të trasha miopi, që mbante në kokë një peshqir në formë turbani indian. Nga pamja dukej intelektual që kish pësuar një traumë të fortë psikike. Kur unë u ndodha pranë tij, ai u ndal dhe më vërejti me kujdes nga koka në këmbë. Më hetonte me një mënyrë të habitshme dhe pas disa minutash më pyeti:

«A mos je Agimi ti? Më njeh mua? — dhe vazhdoi të më zhbironte me një vështrim gjithë frikë. Ishte e pamundur ta njihja këtë njeri të shndërruar në një qenie gjysmë njerëzore dhe gjysmë shtazore. Vetëm timbri i zërit të tij ishte njerëzor dhe i njohur për mua. Këtë zë e kisha dëgjuar shumë kohë përpara, për një kohë të gjatë. Nga timbri i veçantë ky zë më ishte ngulitur në mendje dhe, megjithëse kishin kaluar shumë vjet, e njoha. Ky ishte zëri i mësuesit tim të letërsisë, Gjergji Komninos. Gjergji Komnino, mësuesi im elegant në gjimnazin «Qemal Stafa» të Tiranës, si të paskan katandisur kështu?! Si të kanë transformuar në një dordolec! Kush janë ata «Kompraçikos» të shek. XX!. Sa mllef paskan pasur kundër teje?! Ç'mund të kesh bërë ti, o shpirt njeriu, që janë hakmarrë kaq mizorisht?! Mezi mblodha veten dhe e pyeta me zë të dridhur se kur ishte dënuar dhe sa.

— Më dënuan me vdekje më 1956-n. Gjashtë muaj duke ngrënë si qeni, në koritë, gjashtë muaj me duar e këmbë të lidhura me hekura, gjashtë muaj duke urinuar në tesha, gjashtë muaj... — U mundua të drejtonte duart, por më kot. Të shkuara, i thashë. Jo, më tha me irritim, s'ka të shkuara, as të harruara! Diktatura ka qenë, është dhe do të jetë sa të jetë gjallë Satani!

Jo, or Gjergj, çdo gjë ka një fund dhe fundi po afron. I dhashë disa biskota që më kish sjellë atë ditë familja. I hëngri me nofulla se në gojë s'i kish mbetur asnjë dhëmb, asnjë dhëmballë. Nuk desha ta lodhja me pyetje. Do kisha kohë për të mësuar tragjedinë e tij. Ato pak ditë që qëndrova në burgun e Tiranës prej tij mësova se kishte punuar në Institutin e Shkencave, në degën e folklorit. Ishte denoncuar nga një i afërt dhe e kishin arrestuar për një raport që kishte hartuar për gjendjen reale në vend. Ishte një kronikë, një kronikë e zezë, por e vërtetë. Puna e tij si mbledhës i folklorit i kish dhënë mundësi që ta njihje mirë Shqipërinë, nga jugu në veri, nga perëndimi në lindje. S'kishte lënë njeri pa takuar dhe skutë pa u futur. Si pjesëmarrës i Luftës Nacionalçlirimtare, ishte i zhgënjyer. Si idealist ishte deziluzionuar plotësisht.

«Çdo gjë gënjeshtër, prapaskenë, kurth, antikombëtare, antihumane qysh nga fillimi dhe vazhdon, vazhdon» dhe e mbylli bisedën me ekslamaconin:

«Deri kur, o prapësi, o dreq, deri kur, o mallkim?!» Sytë i shkrepstin dhe mjekra i dridhej. Kalova me Gjergjin disa vjet vuajtje nga një burg në tjetrin. Ai s'e hiqte turbanin nga koka dhe trastën e librave nga qafa. Nëpër kampet me punë të detyruar gardianët e ngacmonin vazhdimisht dhe e shihnin me përçmim si dembel që «hante supën e qeverisë kot». Ai fshihej me kujdes nga sytë e tyre përgjues dhe s'pushonte për asnjë çast të filozofonte me bashkëvuajtësit për Kantin, Volterin, Bejkonin, Pirandelon, me të cilin kishte mbrojtur diplomën në Universitetin e Zagrebit, paçka se shumë prej tyre s'e kuptonin dhe disa vagabondë mundoheshin edhe të talleshin me të. Vuajti 15 vjet burgim, pa ndihma, vetëm me supën e burgut, nga një kamp në tjetrin, duke ndërtuar «veprat e socializmit». U lirua në fund të vitit 1971, në moshën 53 vjeç. Pushteti popullor» nuk i siguroi as punë, as pension. E strehuan

në një dhomë të braktisur, ku ç'binde jashtë, hynte brenda. U struk si Diogjeni në strofkën e vet. Dilte vetëm natën, për të mbledhur letra në kazanët e plehrave, autori i parë te ne i monografisë voluminoze për poetin tonë kombëtar Naim Frashërin. Pas shembjes së diktaturës komuniste në Evropën Lindore, ishte gjallëruese së tepërmi. Për asnjë çast nuk pushonte së agjituari me njerëz të çdo moshe dhe profesioni. Fliste për drejtësinë, për humanizmin, për të vërtetën. «Lektorati i tij i preferuar» ishin policët. U lutej si Krishti që të mos përdornin dhunë dhe i bënte të stepeshin edhe ata më fanatikët. Shkoi gjithë entuziazëm të merrte pjesë në grevën e urisë së studentëve në shkurt 1991, por ata ia kundërshtuan kërkesën, për shkak të moshës së tij të thyer (74 vjeç). Me lekët e bukës së gojës u drejtua në postën më të afërt, për t'i dërguar telegram solidarizimi komisionit të grevës. Tri ditë para se të largohet nga Atdheu më erdhi në shtëpi. Kishte hartuar një program për shoqatën e ish-të burgosurve, t'internuarve dhe të persekutuarve politikë. Sytë i shkëlqenin dhe timbri i zërit ishte më kumbues se asnjëherë tjetër. Kurrë s'e kisha parë aq dinamik. «Ne jemi opozita e vërtetë —, më tha, — dhe s'jemi pak, por më dhjetëra mijëra, me qindra mijëra, Ne dhe fëmijët tanë duhet të rrokim flamurin e lirisë dhe të demokracisë, meqë dhamë jetën, rininë dhe gjithçka për lirinë dhe demokracinë. Ne, që u persekutuam, u burgosëm, u torturuam, u pushkatuam dhe u shpërndamë si zogjtë e korbit në pesë kontinentet. Ne...» — dhe fliste e fliste me një zjarr që më bëri të dyshoja se mos ishte prekur përsëri nga ndonjë krizë psikike. U mundova ta qetësoja, duke e vënë në dijeni se shoqata po formohej dhe punët e saj po ecnin në rrugë të mbarë. U ndamë miqërisht, si gjithmonë. Pa kaluar as pesë ditë, mbeta i shtangur para ekranit të televizionit, kur RAI UNO po jepte lajmet e orës 23.00. Ato ditë kishte ndodhur eksodi masiv nga Vlora dhe Durrësi. Fytyra e Gjergjit doli në ekran duke u intervistuar nga një gazetar italian. Fliste me kokë e me duar për Shqipërinë. Fliste ash'u siç dinte ai. midis asaj morie refugjatësh.

O Gjergji, o vëlla! Në çfarë trysnie psikologjike u ndodhe kur i ktheve krahët Atdheut, që ti e deshe aq shumë? A mos vallë t'u kujtuan prangat, torturat, kazanët e pleh-

rave? A mos vallë të erdhi ndër mend thënia e San Zhystit:
«Një popull i shtypur nuk ka aspak atdhe.»? A mos vallë
u nise si misionar për t'u treguar vëllezërve arbëreshë
plagët e Nënës? Për një gjë jam i sigurt, o mësuesi im
i shumëvuajtur, se kudo që të ndodhesh, do të mbetesh
një atdhetar i flaktë.

PROFESOR FOTO BALA

Për profesor Foto Balën kisha dëgjuar përpara se ta njihja personalisht nga shokët e mi, që kishin vazhduar gjimnazin e Gjirokastrës në vitet 1945-46, ku ai u jepte gjuhën frënge. E dija se ishte nga Vunoi i Himarës dhe babai i tij, Dhimitër Bala, kishte qenë një fanolist i zjarhtë dhe prefekt i Gjirokastrës gjatë viteve 1920-24. Me ardhjen e Zogut në fuqi, në dhjetor të vitit 1924, Dhimitri emigron jashtë shtetit dhe kthehet më 1939, si shumë shokë të tij. Më 1945 Dhimitër Bala, në moshën 65 vjeç, dënohet me vdekje dhe ekzekutohet nga diktatura komuniste, Foton e njoha më 1962, në burgun e Burrelit, ku ai vuante dënimin qysh prej vitit 1947. U miqësua me shpejt me njëri-tjetrin, se na lidhte profesioni dhe ideali antikomunist. Ndodheshim në një kaush së bashku dhe shtretërit i kishim ngjitur. Ishte njeri i kulturuar, zotëronte tri gjuhë të huaja: frëngjisht, italisht, greqisht dhe ishte njohës i thellë i filozofisë e i historisë botërore. Ishte diplomuar në filozofi në Universitetin e Monpeljesë, më 1932, dhe kishte punuar në Liceun francez të Korçës. Kishte qenë apolitik para se ta dënonin.

Në bisedat që bënim më fliste për të kaluarën e tij, që e gjykonte si fatalitet.

Në Gjirokastrë jam njohur me Enver Hoxhën qysh kur isha 12 vjeç. Ishim moshatarë dhe së bashku shkuam në Korçë për të vazhduar Liceun. Kishte një zgjuarsia diabolike dhe ishte pervers. Flija me të në një dhomë, por akoma s'e kisha njohur ashtu si duhej. Kur mbaruam Liceun, na u dha bursa e shtetit për të vazhduar studimet e larta në Monpelje të Francës, megjithëse unë isha me baba të arratisur politik. Ja, ky ishte regjimi i Zogut, që disa kallexhinj faqezinj e quajnë diktaturë obskurantiste. Edhe në Monpelje qëndrova në një dhomë me Enverin. U ndava

me të kur ai mbeti në klasë dhe u detyrua të largohej. Ishte i pabesë. Më punonte lloj-lloj poshtërsish, që unë i kuptoja me vonesë. Sa herë e kisha sharë dhe pështyrë në fytyrë, por ai zgërdhihej. Ishte i pacipë. Kur u largua nga Franca, thashë se shpëtova prej tij, pò fati më bashkoi përsëri, në Liceun e Korçës, gjatë viteve tridhjetë. Më kishte smirë, se unë isha i diplomuar, emëruar profesor, me rrogë bazë 220 franga ar në muaj, kurse ai paguhej me orë mësimi, 130 franga. Në Korçë përzihej me lloj-lloj vagabondësh dhe me femra imorale. Katër herë kishte marrë sëmundje veneriane. Në një gjyq të zhvilluar në Bruksel, kundër një grupi agjentësh sovjetikë, më 1939, emri i Enver Hoxhës u përmend disa herë nga të pandehurit dhe nga prokurori belg. Në dhjetor të 1944-ës ndodhesha në Tiranë. Më erdhën në shtëpi Fejzi Dika dhe Nonda Bulka dhe më propozuan për t'i bërë një vizitë Enver Hoxhës, që banonte në hotel «Dajti». Në fillim refuzova. E njihja më mirë se ata se kush ishte Enveri, por, meqë këmbëngulën, pranova dhe u nisëm të tre për te selia e diktatorit. Në sallon na priti adjutanti i tij, një kapiten i ri, me fytyrë të egër. I thamë se ishim ish-shokët e Komandantit të Përgjithshëm dhe i dhamë emrat tanë. Mbas disa minutash kapiteni u kthye më i vrenjtur se ç'ishte dhe na tha se Komandanti nuk do të na priste, mbasi ishte i zënë me punë. Më hipi gjaku në kokë. E! u thashë shokëve kur dolëm nga hotel «Dajti», e morët vesh se kush është Enver Hoxha?! Mjerë ky popull në ç'duar ka rënë! Ata kishin mbetur si të shokuar dhe s'e hapën gojën. Fejziu dridhej nga inati dhe pështynte vazhdimisht në tokë.

Një herë tjetër, duke biseduar me Foton për shkaqet e fitores së komunizmit në Shqipëri, ai radhiste si faktor nr. 1, zemërgjerësinë e autoriteteve kuislinge ndaj komunistëve dhe numëronte me dhjetëra fakte, se si funksionarë të lartë, ndihmonin lëvizjen komuniste.

«Do të të tregoj një fakt, ku kam qenë dëshmitar okular», — më tha, duke u vrenjtur në fytyrë:

«Ishte vera e vitit 1943. Babai im, Dhimitri, në atë kohë, kishte funksionin e kuestorit (shef policie) të prefekturës së Durrësit. Unë kisha shkuar atje, së bashku me familjen, për të kaluar pushimet. Një ditë, kur ndodhesha në zyrën e babait, hyri ordianca e tij dhe lajmëroi se Enver Sazani, Shefqet Beja dhe Sheh Karbunara dëshironin ta takonin kuestorin. Babai dha urdhër që të futeshin brenda

dhe, kur ata u futën, më prezantoi me ata. Kamerieri solli kafet dhe llokumet e mirëseardhjes. Nga mënyra e përshëndetjes dukej se ishin të njohur prej kohësh. Pa pikën e druajtjes filluan bisedat politike anti Bosht dhe pro Aleatëve. Flitej me admirim për betejën e Kurskut, ku gjermanët kishin lënë me qindra tanke të shkatërruara dhe për fitoret e tjera të Ushtrisë së Kuqe. Flitej me entuziazëm për një mision të Radio Londrës, ku u thureshin lavde Myslym Pezës, Mestan Ujanikut dhe të tjerë udhëheqësve të çetave partizane. Në zyrën e kuestorit të policisë flitej si në një bazë ilegale të Partisë Komuniste. Nga fundi i bisedës, doktor Enver Sazani, anëtar i këshillit nacionalçlirimtar për prefekturën e Durrësit, mori një qëndrim zyrtar dhe iu dejtua babait me këto fjalë: «Zoti Dhimitër! Në emër të qarkorit të Durrësit kërkojmë nga ju ndërhyrjen pranë komandës së karabinierisë për lirimin e një shoferi të arrestuar dje në Urën e Dajlanit, nga karabinieria italiane, nën ndenjësën e të cilit u gjetën 10 pistoleta dhe 500 fishekë. Këto armatime, me urdhër nga lart, do t'i dërgoeshin qarkorit të Gjirokastrës. Kemi frikë se mos italianët përdorin tortura ndaj shoferit dhe ai dekonspiron shokët e qarkorit, që kanë lidhje me të, prandaj, ju lutemi, të ndërhyjni sa më paë, duke i dhënë çështjes karakter ordiner, se gjoja armët do shiteshin për fitime personale dhe ishin blerë në persona të panjohur. Më kot mundahej babai t'ua mbushte mendjen se kompetencat e tij nuk e lejonin të ndërhynte në komandën e karabinierisë dhe se komandanti i saj për prefekturën e Durrësit ishte një nënkolonel italian, shumë rigoroz dhe i pakorruptueshëm. Atëherë u ngrit Shefqet Beja dhe i tha babait:

«Këtë detyrë, zoti Dhimitër, do ta kryeni me çdo kusht. Kjo është gur prove për devotshmërinë tuaj ndaj popullit, ndaj Atdheut.» — Mbas shumë debatesh babai çedoi dhe pranoi të shkonte në komandën e karabinierisë për ndërhyrje në favor të shoferit të arrestuar. Mbas morën premtimin nga Dhimitri, u larguan, duke më përshëndetur dhe mua. Gjatë gjithë bisedës unë s'hapa asnjëherë gojë. Isha fryrë aq shumë kundër babait. Prisja me padurim largimin e tyre. Dhe, me të ikur, i them tim eti:

«Ç'po bën, mor baba, a je në vete?! Si pranon që në zvrën tënde të të bëjnë presion përfaqësuesit e Nacionalçlirimtares dhe të të flasin haptazi kundër Boshtit dhe pro Aleatëve? Si pranon të ndërmjetësosh për lirimin nga bur-

gu të një terroristi komunist? Nuk të kuptoj, baba, pse sillesh kështu?»

«Po çfarë të bëj, mor bir? Si mund t'i arrestoj shqiptarët dhe t'ua dorëzoj pushtuesve italianë? Mos e dhëntë zoti një gjë të tillë! I di të gjitha: kush janë komunistët. ku i kanë bazat, ku i bëjnë mbledhjet, por asnjëherë nuk do të vë dorë seriozisht mbi ta. Është okupatori në mes.»

«Po komunistët nuk do t'jua dinë për nder. këto që bëni për ta sot. Ata do t'ju dënojnë, po të marrin pushtetin.»

«S'ka gjë, mor bir. le të na dënojnë. Këto që bëjmë i di populli, i di Atdheu, i di Zoti. Ne, kështu na dikton zemra dhe edukata jonë, të mos e shesim asnjëherë shqiptarin tek i huaji, sado i lig që të jetë», — më tha e uli sytë me një pikëllim që s'e kisha parë asnjëherë gjatë jetës sime. Megjithëse në gjyq i dolën mjaft dëshmitarë, të cilët vërtetuan me fakte bindëse për ndihmën që i kish dhënë Lëvizjes Nacionalçlirimtare, atë e dënuan me vdekje dhe e pushkatuan, ashtu si dhe shumë shokë të tij.

«Më 1945 më caktuan profesor në gjimnazin e Gjirokastrës, duke më survejuar natë e ditë, derisa më arrestuan nga mesi i vitit 1946. U akuzova se kishim krijuar grupin e Neoballistëve, se ishim lidhur me misionet anglo-amerikane dhe plot marrëzira të këtij lloji, që jo vetëm s'i kishim bërë, por as në ëndërr s'i kishim parë. Më dërguan në Tiranë. Në fillim më trajtuan butë, por, kur unë nuk pranova të pohoja ato që më servirnin, hetuesit «xhentilë» filluan torturat nga Mihallaq Zecishti, Stavri Zhara, Kadri Hazbiu e të tjerë, që tmerrohem dhe sot kur i kujtoj. U thashë se isha gati të pranoja çfarë të donin, vetëm të ndalonin torturat. U ndritën sytë dhe filluan menjëherë të mbushnin procesverbalet, duke shkruar se isha anëtar i kryesisë së komitetit neoballist, se isha agjent anglo-amerikan-francez, se do të vritnim gra, pleq dhe fëmijë, madje dhe Krishtin e Muhamedin po të ishin gjallë dhe plot marrëzira të neveritshme, që vetëm mendja e komunistëve mund të shpikë. I ndjeri Enver Sazani, me të cilin qëndrova disa ditë në një qeli, më tregoi se hetuesi Mihallaq Zecishti i kishte djegur dhe sytë me cigare, gjersa i kishte marrë pohimin se ishte agjent anglo-amerikano-francez. Doktor Sazani më tregonte ato ditë të fundit të jetës së tij se hijena Mihallaq i kishte pasë thënë se këto pohime i donin shokët jugosllavë për të demaskuar imperializmin, po nuk i tha

se ky kishte qenë një nga planet e shumta sllavo-komuniste për zhdukjen e inteligjencës sonë, zbatuar me servilizëm nga Enver Hoxha dhe xhelatët e tij. Shumë nga ata, që nuk pranuan të bëheshin «bilbila», dhe shumë nga ata, që u bënë të tillë, u dënuan njëjloj, me vdekje, dhe u pushkatuan. Mua më dënuan me burgim të përjetshëm, për të vuajtur si Sizifi i mitologjisë. Kam bërë 17 vjet burg gjer tani dhe një Zot e di sa do të vuaj ende. Para disa muajsh i bëra një letër Enverit, për të më falur dënimin e mbetur, vetëm që të gjeja nënën gjallë. Doja ta varrosja me duart e mia, se babait as varrin nuk ia dija, po katili m'a kundërshtoi kërkesën dhe dha urdhër për të më internuar familjen në Tërbuf. Ja pra, sa shpirtmizor që ishte Enver Hoxha. Dhe Timur Lengu do ta kishte zili».

U lirua nga burgu i Burrelit mbas 19 vjet vuajtjesh, me një koleksion sëmundjesh, megjithatë mbijetoi. U gjallërua pa masë kur vdiq diktatori.

«Tashti le të vdes, — më tha, — jam i lumtur.» Jetoj gjer në fillim të vitit 1991, duke parë dhe agimin e demokracisë. Në librin e diktatorit «Kur hidheshin themelet», që do të ishte më i saktë të titullohej «Kur hapeshin varret», ai shkruan se Foto Bala u bë bashkëpunëtor i fashistëve italianë dhe për këtë mori dënimin e merituar nga gjyqi i popullit. O tempora! O mores!

KRYEPESHKOPI I SHQIPËRISË; VISARION XHUVANI

Nuk kisha veçse dy javë që ndodhesha në burgun e Burrelit, kur në mbrëmje, i shoqëruar nga gardiani për në WC, dallova në sfondin e korridorit një njeri me raso të zezë, fytyrë dhe flokë të bardhë si dëbora, një Abat Farie të gjallë, që ecte i kërrusur nga pesha e viteve dhe e vuajtjeve. A vallë ishte një halucinacion, apo hija e Abatit Farie e ikur nga Kështjella e Ifës dhe ardhur në burgun-ferr të Burrelit, ku për çdo çast të vinin në mendje vargjet e të madhit Dante: «Humbni çdo shpresë ju që hyni...

Ishte rreptësisht e ndaluar ta pyesje gardianin, por

shiko dhe kalo!

Në adoleshencën time, kur kisha lexuar «Konti i Monte Kristos», Abati Farie më ishte ngulitur në tru dhe shpesh e shikoja në ëndërr, kurse tani, ajo që shikoja në korridoret e errëta të burgut, s'ishte më ëndërr. Ishte një realitet. Mbas një muaji, kur më nxorën nga qelia dhe gardiani më shoqëronte për në kaushin nr. 9, te dera e kaushit nr. 7, pashë Abatin të gjallë, që ngjasonte si dy pika uji me Farienë, por më i pashëm, më burrëror dhe më fisnik se Abati francez. Dhe ai më pa dhe diçka pëshpëriti, kur gardiani ktheu krahët, bëri një kryq në drejtimin tim. Pyeta për të bashkëvuajtësit dhe më thanë se ishte Visarion Xhuvani. ish-kryepeshkopi i kishës ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, që për 16 vjet vuante dënimin në këtë skëterrë të diktaturës Enveriste. Më lindi dëshira të njihesha me Hirësinë e tij. Profesor Foto Bala më dha fjalën se do të ma plotësonte dëshirën. Mbas disa ditësh, kur po dilnim në oborr, u futëm fshehurazi në kaushin nr. 7, së bashku me Foton. Visarioni kishte ditë që s'dilte në pajtos. Ishte i pamundur dhe qëndronte në kaush duke u lutur në heshtje. Të gjithë bashkëvuajtësit e respektonin dhe e ndihmonin

me sa mundnin këtë apostol të krishtërimit, që regjimi i tiranit komunist e kishte dënuar pa asnjë faj.

«Mos u mërzit, or bir! — më tha Visarioni. — ditë të mira do të vijnë patjetër. Zoti s'ka për të duruar gjatë. Ti je i ri dhe do t'i shohësh, kurse unë...» — dhe ngriti duart lart, drejt qiellit. Në pamjen e tij kishte diçka hyjnore, që të impononte heshtje dhe respekt. Ky qe takimi i parë dhe i fundit me Dhespotin e nderuar. Mbas një muaji, më 26 nëntor 1962, Visarioni u lirua me dekret të posaçëm të Presidiumit.

Përse vallë diktatori e liroi para plotësimit të dënimit peshkopin?

Për të lehtësuar ndërgjegjen e rënduar nga pesha e krimeve, apo? Enigmë! Kur doli nga burgu, la çdo gjë. Mori me vete vetëm rason e zezë, duke lënë një imazh të pashlyeshëm midis bashkëvuajtësve. Nuk i harroi për asnjë çast shokët e burgut dhe u dërgonte letra nga Manastiri i Shën Gjonit në Elbasan, ku kaloi vitet e fundit të jetës së tij, si eremit i vërtetë.

Profesor Bala, me të cilin kryepeshkopi kishte letër-këmbim, më tregoi se Visarioni kishte lindur në Elbasan, në lagjen «Kala», më 1890, në një familje patriotë, që s'kishte të bënte aspak me familjen e Aleksandër Xhuvanit. Në shkollën fillore kishte pasur fatin të kishte mësues patriotin, gjuhëtarin e madh, kushëririn e tij, Kristoforidhin. Shkollën e mesme dhe të lartën i kreu në Athinë, në Fakultetin e Teologjisë me nota optimale. Shërbeu si klerik në Sofie dhe në Cetinë. Më 1919, si peshkop i Kishës Ortodokse dha meshën e parë në gjuhën shqipe në Elbasanin e tij të dashur. Ajo ditë u shndërrua në një manifestim të fuqishëm popullor dhe pati jehonë në mbarë Shqipërinë.

Emri i Visarion Xhuvanit u bë simbol për themelimin e Kishës Autoqefale. Zgjidhet senator në Kongresin e Lushnjës, më 1920, dhe më 1922, së bashku me Fan Nolin, organizon Kongresin për Kishën Autoqefale Ortodokse të Shqipërisë, duke goditur rëndë synimet e mbrapshta të Patriarkanës së Stambollit. Me përpjekjet e tij titanike i imponohet Patriarkanës, dhe kjo e fundit, mbas shumë hezitimesh, e njeh si Peshkop të Shqipërisë më 1923. U zgjodh deputet në periudhën 1920-1924 dhe me fjalën e tij u bë një mbrojtës i flaktë i demokracisë. Më 1929 u zgjodh Kryepeshkop i Shqipërisë dhe luftoi me mish e me shpirt për kombëtarizimin e Kishës Ortodokse Shqiptare.

Diktatura komuniste e gjeti Visarionin peshkop të Vlorës. Atë e vunë nën një survejim të rreptë gjersa e arrestuan më 1946. Xhelatët e kuq nuk u ndalën aspak para këtij atdhetari dhe kleriku të shquar. E torturuan fizikisht dhe shpirtërisht në mënyrën më barbare. Ata u munduan më kot që ai të pohonte «krimet» e tij dhe, kur panë se çdo lloj torture e përdorur kundër tij nuk e përkuli këtë stoik të krishtërimit, e dënuan me burgim të përjetshëm pa asnjë argument këtë atdhetar, demokrat dhe klerik të shquar.

Gjatë gjithë kohës së vuajtjes së dënimit ai u bë Atë shpirtëror i bashkëvuajtësve, duke i ngjallur besim se diktatura do të përmysej, liria do të vinte dhe demokracia do të fitonte.

Vdiq në Manastirin e Shën Gjorit, afër Elbasanit, në moshën 76-vjeçare, i vetmuar dhe në mjerim të plotë.

Dr. KALIVOPULLI VDES NË BURG

Kush nuk e ka dëgjuar emrin e doktor Kalivopullit në ish-qarkun e Gjirokastrës? Sa qindra e mijëra fëmijë, gra e burra ka shpëtuar nga kthetrat e vdekjes! Fjala e tij ishte më balsam se ilaçet që jepte. Pesëdhjetë vjet mjek me bluzë të bardhë. Figura e tij qysh së gjalli ishte shndërruar në legjendë. Puna dhe respekti i njerëzve e gjallëronin 75-vjeçarin Aleksandër Kalivopulli. Dhe ai vazhdoi të luftonte kundër vdekjeve të njerëzve. Luftoi për t'u bërë më i dobishëm. E kishte filluar që nga bankat e shkollës. Në të gjitha ciklet, deri në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Athinës, doli shkëlqyeshëm. Në studime pasuniversitare mbrojti gradën shkencore Doktor. Oferta për të qëndruar në Athinë apo qytete të tjera të Evropës nuk e joshi këtë intelektual. Ai kthehet të punojë në Gjirokastrë, pranë vendlindjes së tij, Dropullit, ku punon 50 vjet me një devotshmëri shembullore dhe shëroi mijëra minoritarë shqiptarë.

Në qershor të vitit 1959 Kalivopulli u bë i njohur në të gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj. Kinostudioja «Shqipëria e Re» i kushtoi një dokumentar ku prezantoi para gjithë opinionit publik punën e tij të palodhur, kurse «Zëri i Popullit» i kushtoi një shkrim të veçantë. Paskëtaj Kuvendi Popullor e deklaroi për 50 vjet shërbim në mjekësi. Në këtë përvjetor u ngritën doli për shëndetin dhe ndihmesën e tij të çmuar dhe i uruan të vazhdonte punën. Doktorin u emocionua dhe me lot në sy tha: «Do vazhdoj të punoj me të gjitha forcat, derisa të më punojë zemra!»
Dhe ç'ndodhi?!

Kalivopullit më 3 korrik 1960 i hidhen prangat në duart e fishkura, në duart që i dridheshin nga puna dhe pleqëria, në ato duar që kishin ekzaminuar me mijëra të sëmurë. E lidhën me hekura si kriminel dhe e rrasën në burg,

në një qeli të errët të burgut të Tiranës. Kë arrestuan? Doktorin demokrat, që Zogu e kishte ndjekur e persekutuar, kurse Italia, pas Luftës Italo-Greke, e kishte burgosur dhe internuar në Itali mbi një vit.

Pas arrestimit të doktorit në shtëpinë e tij ra tërmet e mbi tërmete. Nga kon'rollet e njëpasnjëshme, shtëpia u kthye disa herë përmby. E shoqja me gjithë fëmijët u bënë grusht. Të dy djemtë dhe të dyja vajzat, me sytë të zgurdulluar, dridheshin në gjirin e nënës. I rrëmbyen 2000 napolona floriri... (O zot, a ka regjistër ku janë shkruar këto para?!) Po kështu edhe 200.000 lekë në arkën e kursimit, si dhe gjithë pasurinë e tundshme e të patundshme. Dy vjet në hetuesi. Dy vjet tortura e izolim hermetik. Dhe 75-vjeçari Kalivopulli sfidon vdekjen. Me gjakftohtësinë dhe logjikën e tij të palëkundshme, me karakterin e pastër e human u thoshte hetuesve:

«Si është e mundur, zoti hetues, të dal kundra fëmijëve të mi, si është e mundur, që unë të jem agjent? Ku i keni fakte?» Po fanatikët e regjimit, ata që dinin të merrnin jetë, nuk e dëgjonin zërin e tij. Ata vazhdonin ta rrihnin e ta torturonin si tradhtar. Ai mbeti gjallë si aktorakuzë ndaj diktaturës. E dënuan me 18 vjet burgim për tradhti, pa dëshmitar. E sollën në burgun e Burrelit «kriminelin» e rrezikshëm 75-vjeçar.

Të burgosurit e pritën si Eskulapin. Atyre u shërbeu si baba për dy vjet rresht, derisa dha shpirt. Si njeri i papërkulur, megjithëse dridhej nga vuajtjet dhe pleqëria, u bërben e njerëzve që nuk njihnin dritën. I sfilitur ecte korridoreve të errëta të burgut, i mbajtur prej krahëve nga bashkëvuajtësit. Gradualisht shëndeti i tij binte e keqësohej. Ishte shndërruar në një fantazmë, në një fantazmë që nuk të frikësonte, por të bënte ta adhuroje. Të gjithë e deshën, i shërbenin dhe e ndihmonin me sa mundnin. Edhe pse në agonë, s'pushonte duke u dhënë këshilla të sëmureve. Ata të mjerët dëgjonin me veshët ngritur. Doktor Kalivopulli u ndizte një fije shprese në ato labirinte të errëta të burgut.

Doktorit si vullkan i shpërtheu një vendim që tronditi burgun. Ai shpalli grevën e urisë. Kështu ai vendosi t'i jep-te edhe një goditje, goditjen e fundit regjimit diktatorial të Hoxhës. Ai ndërpreu ushqimin. Të burgosurit e shikonin me admirim, krenari edhe me dhimbje. Dalëngadalë po e linin forcat, e ndiente mjaft vetminë dhe ndarjen nga

familja. Hapte sytë dhe shihte në errësirën e qelisë siluetat e fëmijëve, kujtonte fytyrat e tyre, zërin e tyre dhe buzëqeshte si në ëndërr. Në qelinë e errët filloi të fliste me vete, të përmendte emrat e fëmijëve: Sokrat, Kristo, Niqi... Po në birucën e errët e të ftohtë të Burrelit nuk dëgjonte njeri! Megjithëse bashkëvuajtësit mundoheshin t'ia lehtësonin vuajtjet, i qëndronin afër, ai filloi të ndiente dhembje dhe frikë në shpirt.

Ditët kalonin dhe doktor Kalivopulli vazhdonte i vendosur e i palëkundur grevën e urisë. Sytë po i perëndonin, gardianët, që deri atë çast e shikonin me përbuzje, u habitën me vendosmërinë e doktorit. Me armën e urinë ai qëllonte dhe çarmatoste. Kundërshtarët e alarmuar filluan telefonatat për rrezikun e doktorit. 12 ditë rezistoi duke luftuar me vdekjen. Në ditën e 13 dhe pikërisht më 18 shkurt 1964, pushoi së rrahuri zemra e tij, zemra e burrit fisnik, zemra e profesorit, zemra e atij që dha shpirt në kaushin nr. 10 të burgut të Burrelit. Bashkëvuajtësit i mbyllën sytë, e veshën me rrobat e tij të reja dhe me pika loti në faqe mbajtën një minutë heshtje. E varrosën te «Qershia», ku ishin varrosur me qindra fatzinj të tjerë dhe ku sot e kësaj dite nuk i gjenden eshtrat.

I NDERUAR DHE I RESPEKTUAR NGA TË GJITHE

Patër Meshkallën e kam njohur në kampin me punë të detyruar të Skrofotinës, gjatë viteve 1970-72, ku disa qindra të burgosur politikë punonin si sklleverit e Egjiptit për tharjen e kënetës së Nartës. Për moshën e tij të thyer Patër Meshkalla nuk punonte. Me shpirt dhe me mendje ishte me shokët e tij bashkëvuajtës, duke i përcjellë dhe duke i pritur çdo ditë, me fjalë ngushëlluese dhe shpresëdhënëse. Patër Meshkalla, një nga Mandelët e Shqipërisë. shquhej si njeri me cilësi të larta njerëzore. Ai ishte kthyer në simbol të durimit, të dhëmbjes dhe stoicizëm, i vëllazërimit të të burgosurve politikë pa dallim feje, ideologjie dhe krahine. I lindur në Shkodër, në një familje të varfër qytetare, më 1901, u diplomua shkëlqyeshëm në teologji dhe filozofi dhe jetoi në shumë vende të Evropës si ushtar i denjë i Jezu Krishtit. Ai ishte një enciklopedi e gjallë dhe një mësues i papërtuar për bashkëvuajtësit e tij. Kur të burgosurit diskutonin për ndonjë term gjuhësor, goftë dhe në gjuhë të huai, ose për ndonjë subjekt politik, historik, filozofik, sociologjik e tjera dhe s'binin dakord me njëri-tjetrin, fjalën e fundit e kishte Patër Meshkalla. që me kënaqësi dhe pa pikën e përtesës jepte shpjegimin e duhur dhe të përpiktë. Patri ishte kthyer në një mësues shpirtëror për të gjithë bashkëvuajtësi. Atë e respektonin të rinjtë dhe pleqtë dhe e adhuronin për forcën e tij të madhe shpirtërore. Ai ishte mjeshër i bisedës dhe e bënte atë me një shkathtësi mahnitëse. Me fshatarët bisedonte me dashuri për punët e fshatit, me intelektualët plot zjarr e për çdo problem me një kompetencë shkencore. Truri i tij ishte një makinë e përsosur elektronike. paçka se diktatura komuniste e kishte dënuar dy herë dhe ai kishte vuajtur në burgjet e skëterrës së kuqe 25 vjet dënim. Asnjëherë nuk u dëgjua nga goja e tij një fjalë hakmarrëse

kundër atyre që i kishin shkaktuar gjithë ato vuajtje dhe privacione pa asnjë të drejtë. Edhe kur ndonjë bashkëvuajtës i shprehte urrejtjen ndaj veglave të diktaturës, Patër Meshkalla, me zërin e tij lu'ës, shprehej: «Fali, o Zot, se nuk dinë çfarë bëjnë!»

Të paharruara do të mbeten replikat e tij me Mehmet Shehun, Gjin Markun, kur këta ishin në majën e piramidës komuniste dhe me prokurorë, gjykatës, vegla qorre të diktaturës së Enver Hoxhës, Patër Meshkalla, me fjalët e tij plot urtësi dhe logjikë të hekurt, i vinte te shtylla e turpit. Ata mundoheshin ta ngacmonin Patrin si klerik, por shkolin përlesh dhe ktheheshin të qethur.

Kur një prokuror, mbasi i lexoi aktakuzën dhe u kërkos me numrin e madh të dëshmitarëve që dëshmonin kundër Patër Meshkallës, mori këtë përgjigje: «Nuk dëshmojnë këta mjeranë, Zoti prokuror! Flet buka e gojës, që ju ua pritni.» Nuk i harroj sytë e tij plot jetë e mallëngjim, kur në qershor të vitit 1972 më transferuan së bashku me shumë shokë bashkëvuajtës nga kampi në punë të detyruar i Ballshit, për në minierën-ferr të Spaçit. Patër Meshkalla na përqafoi me lot në sy dhe na jepte shpresë dhe guxim. Nuk na u nda për asnjë çast, derisa ne, të lidhur me pranga dhe zinxhirë në këmbë dhe në duar, u larguam të shoqëruar me roja të armatosura gjer në dhëmbë. Fy'yra e tij e imët dhe shprehëse, nuk më është ndarë për asnjë çast nga mendja. Ai ka mbetur në kujtesën e mijëra ish-të dënuarve politikë si ushtar i denjë i Krishtit dhe bir besnik i Shqipërisë. Emri i tij duhet të zënë një vend nderi në historinë e kombit tonë.

* * *

I interesuar për Patër Meshkallën, pranë ish-nxënësve të tij, Zef Perollit dhe Matei Guralumit, njëkohësisht shokë dhe bashkëvuajtësit e mi, mësova se Patër Meshkal'a, ka drejtuar me sukses rrethin e Shën Pjetrit të rinisë katolike të Tiranës prej viteve 1937-1945. Ai ishte edukator i shkëlqyeshëm, sa i dashur, aq dhe i rreptë e këmbëngulës i palodhur me nxënësit e tij. Ai u mësonte nxënësve të tij, përveç mësimëve mbi kateizmin kishëtar, edhe etikën, estetikën dhe pjesë të ndryshme të filozofisë. Patri ishte i pasionuar mbas natyrës dhe organizonte shpesh ekskursione

në gjirin e saj. Patri në rrethin e tij të «Shën Pjetrit» vinte në skenë pjesë të shkurtra teatrale të adaptuara nga letërsia kombëtare dhe e huaj. Ai ishte njëkohësisht skenarist, regjisor dhe aktor me mjeshtëri të rrallë. Patri ishte publicist i mprehtë dhe ka shkruar shumë artikuj, skica dhe poezi të revistat «Leka», «Hylli i Dritës» dhe në të tjera organe të shtypit të asaj kohe. Me guximin që e karakterizonte, ai ka shkruar edhe në gazetën «Bashkimi» gjatë viteve 1945-1946, para se të arrestohej nga diktatura komuniste, duke mbrojtur me dinjitet kishën katolike shqiptare. Mbas daljes nga burgimi i parë, në fillim të viteve gjashtëdhjetë, Patri, pa u trembur nga kërcënimet e Sigurimit dhe të instruktorëve të Partisë, fillonte predikimet para besimtarëve të druajtur me fjalët: «MOS KINI FRIKË» Patër Meshkalla ishte dhe një antifashist i vendosur dhe këtë e shprehte haptazi në kohën e pushtimit italian. Grindet keq me kapelanin italian Patër Selca dhe për këtë internohet në Itali. Kjo gjë shkaktoi protesta të ashpra të të rinjve katolikë shqiptarë, të cilët dërguan dhe një përfaqësi në Romë, duke kërkuar lirimin e menjëhershëm të Patër Meshkallës. Autoritetet italiane u detyruan ta lironin mbas disa muajve Patër Meshkallën, duke mos e ashpërsuar më tepër gjendjen e krijuar. Me këtë rast poeti Mark Ndoja i kushton një poezi Patrit, prej së cilës ësh'ë marrë kjo strofë:

*Pret Shqipnija punë t'madhja prej teje!
Pra, o i Ndjeshëm tejet, atë Mëshkalla.
Për punë t'madhja fetare e A'dheje
A tui t'pritë me dëshirat ma t'gjalla.
Zgjidh, pra, lundrën, vrapo, kalo detin,
Të do shqipja nën flatra zog t'vetin.*

Kur u lirua nga burgimi i dytë, në fund të viteve shtatëdhjetë, megjithëse në moshë të thyer dhe pa asnjë të ardhur financiare, ai qëndroi i papërkulur para presioneve kërcënuese për asgjësimin e tij fizik nga ana e Sigurimit të Shtetit. Shumë besimtarë katolikë shkonin fshehtas te Patër Meshkalla, si Nikodemi te Krishti dhe Patër i papërtuar u gjendej afër në çdo vdekje dhe pagëzim. Vdes më 28 Korrik 1988 dhe funerali i tij kthehet në mënyrë të pavetëdijshme në një manifestim të heshtur proteste kundër diktaturës komuniste. Varri i tij u shndërrua në një

vend polegrinazhi për besimtarët katolikë. Mbas vendosjes së demokracisë, më 28 qershor 1992, Patër Meshkallës i bëhen nderimet në varrezat e Shkodrës me rastin e përvëlimit të banesës së fundit, ku flasin shumë klerikë dhe bashkëvuajtës të tij në prani të qindra besimtarëve shkodranë dhe të ardhur nga Tirana.

RUMUNI

Dera e kampit u hap dhe një skërfyell i gjatë u fut brenda. Ishte kockë e lëkurë, me ca sy të mëdhenj bojë-qiell, sy të akullt, që shikonin si të hutuar. Mollëzat e faqeve i dukeshin si dy kodra të zhveshura. Flokët i kishin gjysmë të bardhë, gjysmë të thinjur. Një gojë e madhe, me buzë të rrudhosura, pak e hapur, lejonte të dalloje disa dhëmbë të mëdhenj e të rrallë, si gurë kilometrazhi. Ishte veshur me një kostum të zhubrosur prej stofi që nuk ishte tregtuar në dyqanet tona. Qëndroi në këmbë, midis oborrit të kampit, me një batanije të grisur nën sqetull, duke lëvizur vazhdimisht gish'at e tij të hollë e të gjatë, pa guxuar të bënte një hap më tutje. Jo shumë larg tij, dhjetëra të burgosur e shikonin me kureshtje. Askush s'afrohej për ta përshëndetur, si zakonisht, me fjalët: «Vëlla, nga të kemi? Mos u mërzit. Kjo që të gjeti ty ka gjetur me mijëra të tjerë para teje dhe do të gjejë edhe të tjerë pas teje.»

Papritur u dëgjua një zë, që klithi me të madhe: «Oh, rumuni! E paskan rrasur brenda!» Ishte Bashkim Kina, një i burgosur elbasanas, që e njihte të porsaardhurin. Kishin punuar së bashku në fabrikën e vajit. I shtyrë nga kurreshtja dhe nga humanizmi, i thashë Bashkimit ta merrte rumunin dhe ta sillte tek unë, për të pirë një kafe. Bashkimi iu afrua, e përshëndeti, i dha dorën dhe bashkë me të u drejtua për tek unë. U ulëm mbi dyshekun tim, ku u mblodhën dhe shumë të tjerë.

«Nga të kemi, or mik?» — e pyeti Hamdi Falloni, një i burgosur i vjetër, nga Drashovica e Vlorës, që e thërritnim me nofkën «noksani».

«Rumun, nga Bukureshti, George Nikolau më quajnë», — u përgjigj me një shqipe të deformuar dhe zgjati dorën për të marrë një cigare t'ofruar nga një i burgosur.

«Dhe ti ishe mangët, o rumun. Grekër e jugosllavë kemi me bollëk!» — vazhdoi Hamdiu.

Ndërkaq Bashkimi e kishte bërë kafen dhe ia vuri «rumunit» përpara. Ai e piu me një të rrufitur.

«Paska qenë teraqi i madh i kafes», — tha një i burgosur Foto Lezoja i vendosi përpara një thelë bukë të madhe me ca kokrra ullinj në një kapak kutie.

«Sa të kanë dënuar?» — e pyeta. Nuk m'u përgjigj me gojë, po më tregoi të 10 gishtat e duarve.

«Ja paskan futur një dhjetëshe turke, të ngratit», — tha Xhemal Bali.

«Po ç'deshe në Shqipëri, or teveqel?» — i tha «noksani».

Rumuni nuk mundi të përgjigjej, se gojën e kishte plot me bukë, por vendosi gishtin dëftues në tëm'hat për të thënë se fajin ia kishte koka.

«Jo, or mik! Ty s'ta ka bërë koka, por këmbët, që të sollën tek ky vend i mallëkuar.» — tha një i burgosur.

«Rumuni» s'reagoi dhe vazhdoi të hante si i babëzitur.

«Sa hetuesi bëre? — e pyeta unë. Ai hapi përsëri 6 gishtat dhe m'i tregoi. — Asgjë, 6 muaj?! Unë kam bërë 26 muaj dhe natë e ditë, vër topuz», — tha Hamdiu.

«Të zdruguan ndopak në hetues?» — e pyeti Robert Bishqeni.

Përsëri nuk foli, po zgjati duart dhe tregoi shenjat e prangave, që i kishin mbetur në lëkurë.

«Paske pasur të bësh me Thanas Cakun», foli Bashkimi, — tortura me byzylykët është me'oda e tij e preferuar.» «Rumuni» pohoi me kokë.

«Ke punuar në cirk si pantomimist?» — e pyeti Mërkuri me shpoti.

«Jo, mekanik avionësh», — tha dhe kollofiti kafshatën e fundi të bukës me kokrrën e ullirit. Desha ta pyesja pse kishte ardhur në Shqipëri. Kur kishte ardhur. Me çfarë akuze e kishin dënuar. A kish familje, etj., etj. po nuk m'u duk çast i përshtatshëm. Me rast dhe takt do t'i mësoja të gjitha. Ndërkohë, tellalli i kampit, Kujtim Pe'a bërtiti në kupë të qiellit:

«Merrni gavetat për bukë!» I dhashë një pjatë alumini, lugë nuk më ndodhej.

«Rumuni» u rreshtua me Bashkimin për të marrë supën me patate dhe, kur e mori, nuk priti të gjente një lugë, por e thifhi si të pinte një gotë birrë me eks. Gardiani i caktoi një vend në gjysmerrësirë, nga fund i kapa-

nonit dhe i dhanë një dyshek kashte e dy batanije të grisura. Pas dy ditësh erdhi në vendin tim dhe me shumë druajtje m'u lut t'i jepja një kafe. Ia bëra dhe e ftova të ulet mbi dyshek. Ndezëm nga një cigare dhe në heshtje po shijonim kafën e ngrohë. Pa e pyetur, filloi të më tregonte me një shqipe të prishur me theks rumun.

«Gjyshi shqiptar nga Berati. Shkuar në Rumani në kohën e Turqisë. Jetoi 90 vjet dhe vdiq më 1930, kur unë isha 10 vjeç. Ishte marangoz. Edhe babai këtë profesion kishë, por u vra nga bombardimi në qershor të 1944-ës. Nënë e kisha rumune, moldaviane. Ka disa vjet që ka vdekur. Gruan e kam besarabiane, nga Jashi. Kam dhe një vajzë që studion për inxhinierë. Gjyshi, që më deshi dhe e desha shumë, shpeshherë më thoshte: Georgiu, mos harro se në dejet e tua rrjedh gjak shqiptari. Këtë mos e harro, sa të jesh gjallë!». Dhe unë kurrë nuk i preva marrëdhëniet me diasporën shqiptare në Bukuresht. Një ditë, në shtëpinë e një mikut tim, me origjinë shqiptare, u njoha me një nëpunës të ambasadës shqiptare në Bukuresht. Nëpunësi u tregua mjaft entuziast për këtë njohje dhe më bëri një ftesë familjarisht të vizitoja ambasadën me rastin e 28-29 Nëntorit. E pranova ftesën me kënaqësi dhe shkova. Në pritje ishin shumë të ftuar me origjinë shqiptare. Para se të largoheshim, nëpunësi më la një takim, në një nga restorantet më luksoze të Bukureshtit. Shkova në orën e caktuar. «Nëpunësin» e gjeta ulur në një separe dhe me të parë, më ftoi me dorë për te tavolina e tij. Pasi më pyeti për gjërat e zakonshme, ndryshoi menjëherë tonin dhe mori një pozë zyrtare. «Dëgjo Georgiu, — më tha. — të gjitha demokracitë popullore kanë tradhtuar, janë bërë revizioniste. Vetëm Shqipëria në Evropë dhe Kina në Azi mbajnë flamurin e komunizmit. Ty, si shqiptar, të takon të mbrosh Shqipërinë dhe të luftosh për të. Duam të na ndihmosh. Nuk ta lëmë pa ta shpërblyer.» — dhe mundohëj të më zhbironte duke më parë ngultas në sy. Pas një pauze të rëndë ai vazhdoi: «Ta kërkoj këtë emër të Atdheut të përbashkët, do të na ndihmosh? Si thua?» «E çfarë mund të bëj unë? — iu përgjigja. — S'e kuptoj, si mund t'ju ndihmoj!»

«Jo ndonjë gjë e madhe. Ja për shembull, të shpërndash material propagandistik nëpër ndërmarrje, reparte dhe institucione. Tash për tash asgjë më tepër.»

Dhe mori një pozë tepër zyrtare. Ndërsa unë po pija

gotën e birrës të shoqëruar me haviar, «nëpunësi» i ambasadës nxori nga çanta e tij e zezë një formular në formë deklarate të shkruar rumanisht dhe shqip dhe ma vuri përpara për ta firmosur. «Shkruaj emrin e plotë dhe firmose.» — dhe nxori nga xhepi i brendshëm i xhakëtës stilografin e tij të lyer me ar. Deklarata ishte një akt që unë zotohesha të punoja për Sigurimin shqiptar. Georgiu, mos e shit lirë veten, mendova, me stilograf në dorë, dhe e pyeta me gjysmë zëri: Po çmimi sa do të jetë? Si fillim ke 50.000 lei, pastaj çdo gjë varet nga puna që do të kryesh. Dakord, më tha duke buzëqeshur në mënyrë triumfuese. Dakord iu përgjigja dhe firmosa deklaratën. Me shpejtësi hapi çantën dhe më numëroi 50.000 lei. Pastaj nxori nga një xhep sekret një pako me trakte shkruar në gjuhën rumune dhe më porositi t'i futja menjëherë në xhepin e brendshëm. Mori me nxitim deklaratën e firmosur dhe e futi në çantë. U ngrit në këmbë dhe, duke më dhënë dorën, tha me zë të ulët: «Suksese, George Nikolau!» — dhe u largua me hapa të shpejtë. Mbeta vetëm në tavolinë, duke shtrënguar me dorën në xhep të 50.000 leit. Thirra kamerierin dhe porosita shampanjë. Kisha vendosur të bëhesha hapë. Pas disa ditësh fillova të shpërndaja traktet. Papritur, diktova se një civil po më ndiqte nga prapa. Kuptova se isha zbuluar. Nga frika dogja pjesën e trakteve që më kishin mbetur. Të nesërmen, kur po bëhesha gati të dilja nga shtëpia ia behu një veturë me oficerë të Sekuritates. Më kontrolluan apartamentin dhe më morën me vete. Në një nga seksionet e Sekuritates së Bukureshtit më priste një hetues i veshur civil. Kujt i shërbeni ju, më tha hetuesi duke më shtrënguar nofullat. Nuk e kuptoj, iu përgjigja si i hutuar. Nuk kuptoni, më tha dhe bëri një hap drejt meje. Po këto çfarë janë, duke më tundur disa trakte para hundës. Sa të kanë paguar? Spiun i ndyrë! Unë s'jam spiun, jam shqiptar, u përgjigja. Ai i ra me grusht tavolinës. Ti dhe babai yt keni lindur dhe jeni rritur në Rumani. Haram e paçi bukën që keni ngrënë këtu! dhe dha urdhër të më çonin në qeli. Të nesërmen në mëngjes më çuan përsëri në zyrën e hetuesit. Aty ishte dhe një major i Sekuritates. Ju, tha majori, keni shpërndarë trakte për hesap të Shqipërisë, trakte me frymë armiqësore ndaj kampit socialist, ku bën pjesë dhe Rumania. Për këtë dënohesh me burg. Po ne menduam ndryshe. Vendosëm të të nisim për Shqipëri. Ndosh-ta aty të shpërblejnë dhe të bëjnë ministër, shtoi me ironi.

Shoqëruar me një oficer dhe një polic më nisën urgjent për në Kostancë. Më hipën në një anije që do të nisej në mesnatë për në Shqipëri dhe më mbyllën në një kabinë, nën mbikëqyrjen e një marinari, që ishte siç duket njeriu i Sekuritates. Pas 4 ditësh mbërritëm në Durrës. Zëvendëskapiteni më dorëzoi në policinë e portit, së bashku me një dosje. Pas 1 ore më morën me gaz dhe më çuan në një shtëpi sekrete të Sigurimit, në Shijak. Aty më mbajtën 1 javë. Më vizitonin vazhdimisht oficerë të Sigurimit, të ardhur nga Tirana, por iknin të deziluzionuar, pasi e kuptonin se unë nuk kisha ndonjë «peco-groso».

Në mbarim të javës më komunikuan se isha caktuar të punoja si mekanik në fabrikën e vajit në Elbasan. Pas disa muajsh qëndrimi në Shqipëri, kuptova se këtu gjendja ishte më keq, se në çdo vend tjetër të Evropës Lindore. S'durova dot. Fola. Më arrestuan dhe më rrasën brenda. Kryehetuesi i Elbasanit, Thanas Caku, çdo herë që më merrte në pyetje më shtrëngonte duart me hekura dhe bërtiste duke më thënë: «Je spiun, me ç'mision të kanë dërguar? Kush të ka dërguar? Fol, i poshtër». — dhe më qëllonte ku të mundte. Jam spiuni juaj, mirë ma punuat. Ai tërbohej dhe më kërcënonte se do të ngordhja në qeli, si qen, në qoftë se nuk do të pohoja se isha dërguar si agjent i KGB Sovjetike. O Zot! Mos e duro këtë gjëmë! thosha me vete dhe vendosa të duroja çdo torturë, po nuk do të pohoja kurrën e kurrës me gojën time një të paqenë që kërkonte xhelati Caku. Kur e panë se nuk doli gjë nga ajo që kërkonin, e ndërruan pllakën dhe më thanë se kisha sharë Enver Hoxhën, Partinë, kisha folur për mangësitë ekonomike e të tjera broçkulla të tilla. Po i thashë, kam thënë të vërtetën. Më gënjyet! Më morën në qafë me 50.000 lei të qelbura. Më shkatërruat mua dhe familjen, Zoti mos u duroftë! Brenda dy ditësh më mbushën procesverbalin, ku akuzohesha për agjitacion e propagandë. Pas dy javësh më nxorën në gjyq. Kishin sjellë 3 dëshmitarë, që unë s'i njihja as si fytyra. Ata thanë çka i kish porositur hetuesia. I kishin kërcënuar me bukën e gojës dhe me burg, po të mos thoshin ato që donin ata. Më dënuan me 10 vjet burgim dhe qeshnin sikur të më kishin dënuar 10 ditë. Dhjetë vjet! Një jetë, e përse? Kërkova të më kthenin në Rumani, po prokurori, me një buzëqeshje cinike, m'u përgjigj:

«Vua j dënimin njëherë, pastaj shohim e bëjmë.»

Tani më mori lumi dhe një Zot e di si do të bëhet.

Sytë e akullt bojë qielli i mbërthëu në një pikë dhe gjithë pamja e tij ngriu si të ishte goditur nga një shok i fortë elektrik. U tremba dhe më erdhi shumë keq për të. Mendoja se mund të qetësohej duke i dhënë diçka për të ngrënë. I vendosa përpara një tenxhere me groshë dhe një copë bukë të madhe. Për habinë time, nuk pranoi të hante. Kujtimet e tmerrshme ia kishin prerë oreksin. I dhashë një cigare. E thithte tymin me gjithë forcën e mushkërive. U ngrit të ikte. Iu luta ta merrte me vete tenxheren me groshë. E mori si me përtesë dhe më falënderoi me gjithë shpirt. U largua si një hije e gjatë, i kërrusur, me tenxheren në dorë.

BEDRI SPAHIU

Bedri Spahiun e kam njohur për herë të parë në vitin 1941. te baraka e tij e kinkalerisë, e vendosur në një skaj të sheshit të «Çerçizit», në Gjirokastrë, kur bleva një stilograf të markës «Pelikan». Më bëri përshtypje shkaktësia dhe dashamirësia për të më shërbyer, po mbi të gjitha sytë e tij ngjyrë çeliku, që lëvizin me një shpejtësi të çuditshme. Në mbrëmje pyeta babanë për kinkaleristin dhe ai më tha se quhej Bedri Spahi dhe ishte nga lagja «Manalat»; kish qenë oficer në kohën e mbretit Zog, por ishte çmbilizuuar për pikëpamjet e tij komuniste. Mbas një viti emri i këtij kinkaleristi të panjohur u bë strumbullari i bisedave të nxënësve nëpër shkollë, të burrave nëpër kafene dhe të grave nëpër sofatë e portave. Thoshin se ishte udhëheqësi i komunistëve në qarkun e Gjirokastrës, se italianët ia kishin vënë kokën në ankand për 500 napolona, se hante darka dhe pinte verë himare te shtëpia e kuestorit kuisling Koço Mukës, se ishte guximtar dhe bridhte fshat më fshat për propagandë komuniste, se tek Ura e Lekit ishte arrestuar së bashku me shoqëruesin e tij Kapo Baçon, nga një kapter shqiptar i karabinerisë, pa bërë asnjë rezistencë, se gjyqi ushtarak fashist në Tiranë e kishte dënua vetëm me 2 muaj burgim, se...

Të gjitha këto sa thuheshin pro e kundër tij, e bënin figurën e Bedri Spahiut më tepër enigmatike dhe kureshtare në sytë e masave. Për herë të dytë e pashë Bedri Spahiun mbas kapitullimit të Italisë, në shtator të vitit 1943. në polemikë me Ali Këlcyrën, ku ai u tregua i zgjuar, por aspak i kulturuar, retorik por arrogant. Për herë të tretë Bedriun e pashë në prill të vitit 1945. para Teatrit Popullor, ku zhvillohej Gjyqi Special, veshur me një kostum të zi dhe çantë të zezë nën sqetull. atë ditë kur ai mbajti pretencën si Prokuror i Përgjithshëm. duke kërkuar 17 dënime me vdekje,

të ish-funksionarëve të regjimeve të kaluara dhe eksponentëve të Ballit Kombëtar. Një turmë e mbledhur para Teatrit dhe e nxitur nga komunistët, me të parë Bedriun, filluan të këndonin:

*Reaksionarët porsi miu
I gjykon Bedri Spahiu.*

Të tjerët filluan të thërritnin duke duartrokatur: «Prokurori! Rroftë Prokurori! Rroftë Bedri Spahiu!»

Bedriu qëndronte te shkallët e Teatrit, me një buzëqeshje të hidhur në fytyrë dhe iu drejtua turmës me këto fjalë: «Prokurori e tha fjalën e tij. Tashti e ka fjalën popullit.» «Në litar!» bërtiti turma! «E po në litar!» iu përgjigj Bedriu turmës. duke hapur krahët anash në shenjë miratimi. Pastaj zbriti shkallët me nxitim, duke u drejtuar nga vetura që e prisie. pronë e ndonjë tregtari të sekuestruar. Këtij Robespieri të vogël shqiptar i kishte hyrë vetja në qejf në ato ditë terrori të kuq. Në vitin 1949 u zhvillua gjyqi kundër gjeneral-leitnant Koçi Xoxes, ish-Sekretar i KQ të Partisë Komuniste Shqiptare. zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Brendshme, personi nr. 2 pas Enver Hoxhës, ger në vjeshtën e vitit 1948. Bedri Spahiu në këtë gjyq ishte pjesëri në rolin e prokurorit, po kësaj radhe kundër një shoku të tij të idealit dhe bashkëpunëtor në terrorin shtetëror. Aktakuza kundër Koçi Xoxes ishte plot tri'lime dhe supozime për bashkëpunim agjenturor me emisarët e Partisë Komuniste Jugosllave si Vukmanović Tempon. Blazho Javanovicin e të tjerë të deleguar nga Jugosllavia «motër», që bënë ligjin në Shqipëri gjatë periudhës 1944-48.

Të gjitha gjynahet e Enver Hoxhës dhe Byrosë Politike gjatë kësaj periudhe duhet t'ia ngarkonin teneqexhiut Koçi Xoxe. Në Pretencë Bedriu kërkoi dënimin kapital për Koçi Xoxen, po thonë se ky i fundit i tha Bedriut se aktakuza e tij do t'i lexohej dhe Bedriut mbas disa vjetësh. ashtu siç ndodhi në të vërtetë, më 1957. Më vonë, i penduar, i thotë Enver Hoxhës se e kish përdorur si «patericë» për asgjësimin e Koçi Xoxes. duke ia përplasur në fytyrë dhe shumë padrejtësi që kish bërë diktatori Hoxha. Vetë Enver Hoxha e pohon këtë në veprat e tij duke folur me mllëf kundër këtij komunisti «rebel».

Në vitin 1953 emërohet me punë si spontator në Ndërmarrjen e Grumbullimit në Elbasan. Më 1956 internohet së

bashku me Tuk Jakovën në Kështjellën e Kaninës. Më 1957 arrestohet dhe, mbas një hetuesie të gjatë torturoese, dënohet me 25 vjet burg me akuzën «Për përmbysjen e pushtetit popullor». Sillet së bashku me Tuk Jakovën në kaushin nr. 6 të burgut të Tiranës. I pyetur nga kartelisti i burgut se çfarë kishte bërë, që ishte dënuar 25 vjet burgim, Bedriu i përgjigjet i nervozuar: «Një mut!» Kartelisti, një oficer i ri u shtang dhe hezitoi të shkruante, po Bedriu ngulmoi që të shkruante atë çfarë i kish thënë. Atëherë ndërhyri Tuku, si gjithmonë, i qetë dhe i ekuilibruar, dhe i tha kartelistit të shkruante se kishin dashur «të përmbysnin» pushtetin popullor», ashtu siç thuhej në vendimin e gjyqit. Shpesh kaushin nr. 6, ku vuanin dënimin Bedriu me Tukur, e vizitonin gjerarkë të lartë komunistë, me qëllim që të provokonin të lartpërmendurit. Një ditë shkuan «për vizitë» ministri i Funëve të Brendshme Kadri Hazbiu dhe kryetari i Gjykatës së Lartë Aranit Çela. Ata e provokonin Bedriun që ky të nxehej dhe të fillonte debatin. po dialogu zhvillohej në pozita të pabarabarta dhe përfundonte gjithmonë me futjen e Bedriut në birucë për 1 muaj, në kushte çnjerëzore. Bashkëvuajtësit e tij të kaushit nr. 6 kujtojnë se në një nga këto «vizita» Bedriu u nxehej keq dhe iu drejtua Kadriut dhe Aranitit me këto fjalë:

«Ju jeni provokatorë dhe vrasës. Mos më provokoni se do t'i heq petët lakrorit dhe do t'ju dalin lakrat!». Në këto raste atij i dridheshin duart dhe buza e poshtme. Fytyra i nxihej dhe sytë i shkrepnin. Gjeneralët komunistë buzëqeshnin nga zori, po brenda zienin si vullkan. Një herë një ish i burgosur, i ardhur nga rrethi i Gjirokastrës, i foli mbrapa derës së mbyllur: «E, more, Bedri Spahiu? A hëng-rëm bukë me lugë të florinjte dhe a pimë qumësht nga rubinetat e ujit, ashtu siç na thoshe në kohën e luftës?» «Kush je ti, more djalë?» — e pyeti Bedri nga brenda kaushit. I dënuari, për të bërë humor, iu përgjigj: «Hap televizorin të më shikosh!. Në verën e vitit 1966, kur unë vuaja dënimin në kampin me punë të detyruar të Fushë-Krujës, për të ndërtuar fabrikën e çimentos, një ditë prej ditësh nga autoburgu, bashkë me 8-10 të dënuar të tjerë, zbriti dhe Bedri Spahiu, ish-anëtar i Byrosë Politike të Partisë Komuniste Shqiptare dhe sekretar ideologjik i saj, i zgjedhur në Kongresin e I. në nëntor të vitit 1948. Ata u futën në oborrir e kampit dhe u rrethuan nga të burgosurit e shumtë, që i mbytnin me pyetje nga më të ndryshmet. Ardhja e auto-

burgut ishte njëfarë ngjarjeje për të burgosurit e kampit se nga të dënuarit e ardhur rishtas në mësonim mjaft gjëra që nuk thuheshin në radio dhe në shtyp. E ftova të pinim një kafe dhe u ulëm në një tryezë të mensës verore, ndërkaq shoku im himarot. Kosta Dhimoaleksi, e kishte vënë xhezven në zjarr dhe na solli filxhanët. Me Bedriun nuk njihesha drejtpërdrejt po fatkeqësinë time e kishte mësuar. Ndërkohë Radio-Tirana filloi të transmetonte këngë labe dhe, për habinë tonë, Bedriu mbeti si i ngrirë, me filxhanin e kafes në dorë. Dy pika loti u rrokullisën në faqet e tij të vyshkura dhe mori një pamje tronditëse. Ai që ishte protagonist dhe dëshmitari i kushedi sa ngjarjeve rrëqethëse, derdhe lot si fëmijë nga ndikimi i këngës labe: «Keni kohë që nuk keni dëgjuar këngë?» — e pyeta unë.

«Plot 10 vjet!» — m'u përgjigj me sy të fiksuar tek atoparlanti. Ndërkaq vjen një i burgosur dhe na thotë se dëngun e plaçkave të Bedriut e kishin çuar në infermieri. Bedriu, i irrituar, lë kafën përgjysmë dhe së bashku drejtohem për në ambulancën e kampit, që ishte disa metra larg nesh. Te porta e ambulancës qëndronte komandanti i kampit, kolonel Qemal Nallbani. Ky i komunikoi Bedriut se, me porosi të drejtorit të kampeve dhe burgjeve të Shqipërisë, kolonel Qamil Manes, do të qëndronte një muaj në infermieri, sa të merrete veten, Bedriut filluan t'i dridheshin duart dhe buza e poshtme dhe mjaft i acaruar i tha komandantit:

«Nuk dua asnjë privilegj nga ju, kam ardhur këtu për të punuar së bashku me bashkëvuajtësit e mi. Ju lutem, më caktoni një vend në kaponon së bashku me ta». «Bedri Spahi ke qenë dhe Bedri Spahi ke mbetur, o derëzi!» — tha komandant Nallbani dhe u largua i menduar. E caktuan në brigadën e Bajram Hysenit si ujar. Disa të burgosur e ngacmonin ndonjëherë, gardianët dhe oficerët e provokonin. Bedriu irritohet dhe hartonte protesta energjike, drejtuar organeve të larta të Partisë dhe të shtetit.

Nga Fushë-Krujë, në dhjetor të 1966-s. na transferuan në Elbasan, në vendin e quajtur «Gropa e Tezes.»

Edhe këtu do të ndërtonim një fabrikë çimentoje. Për mungesë fronti pune, një pjesë e të burgosurve qëndronin brenda në kamp, midis tyre dhe Bedriu. Ai shkruante vazhdimisht, por belanë e gjenin 1000 të burgosurit e tjerë. se cdo muaj sigurimi i Elbasanit, me urdhër të shefit Nevzat Haznedari (që s'na u nda gjersa ngordhi), në bashkëpunim

me komandën e kampit, organizonte kontrolle. Të gjitha teshat, librat, tenxheret dhe pjatat hidheshin kapicë në mes të kapanonit dhe hajt të gjente secili të vetën. Pikësynimi kryesor i këtyre kontrolleve ishte rikuizimi i shkrimeve të dyshimta, piketimi i personave që i shkruanin dhe gjetja e ndonjë objekti që ata quanin të rrezikshëm. Në një nga këto kontrolle u riarrestua Xhemal Bali nga Vërva e Konispolit. Ai u akuzua se, me porosi të Bedriut, i kishte dërguar një promemorie KQ të PPSH për gjendjen e rëndë në vend. Xhemal Bali kundërshtoi në mënyrë të prerë kishte bërë një gjë të tillë dhe, megjithëse ekspertiza e laboratorit të MPB vërtetonte se vetëm 6 shkronja nga shkrimet e Xhemalit korrespondonin me shkrimin e promemories, ai u ridënua nga «Gjyqi i popullit» me 10 vjet burgim, plus dënimit të mëparshëm. Në biseda intime Bedriu tregonte se shkakut i disgracies së tij ishte kontradikta me Enverin, në lidhje me Sigurimin e Shtetit. Bedriu kërkonte që kjo armë të vihej nën kontrollin e Partisë, kurse Enveri kundërshtonte me rreptësi, duke argumentuar se për natyrën e tij sekrete Sigurimi duhet të përgjigjej vetëm përpara Sekretarit të Parë të KQ të PPSH, pra vetëm përpara Enver Hoxhës. për ta përdorur si Shtetë dhe Demokleut kundër të gjithë atyre që s'i shkonin mbas oreksit. Mbas dënimit të Xhemal Balit dhe vrasjes misterioze të Ali Maliqit, më 1967, Bedriu i hyri frika se mos organizohej nga Sigurimi dhe zhdukja e tij fizike, prandaj çdo ditë i drejtohej me letra dhe telegrame udhëheqjes së Partisë-shtet, duke kërkuar vetëizolim e tij dhe sigurimin e jetës. Për çudi, kërkesën e tij e morën parasysh dhe e izoluan në një qeli të burgut të Burrelit, së bashku me gaztorin e gjyqit të Teme Sejkos. Jonuz Parizon. Diktatura nuk u ngi me vuajtjet e Bedriut. I arrestoi dhe i dënoi të dy djemtë, njërin mbas tjetrit dhe familjen ia internoi për më shumë se 3 dekada në fshatrat e Elbasanit. Vetëm nga fundi i vitit 1990, kur dhe në Shqipëri agoi liria, Bedriu u la i lirë së bashku me familjen dhe u vendos në Tiranë. Nga mesi i vitit 1991 boton një shkrim në gazetën «Republika», me titull «Bedri Spahiu revizionon Bedri Spahun». Këtu Bedriu 83-vjeçar bën një konfesion me një dozë pendimi për të kaluarën e tij, por jo të plotë dhe të gjithanshme. Ai nuk përmend asgjë nga krimet monstruoze që janë kryer gjatë kohës së luftës në zonën operative Vlorë-Gjirokastër, ku ai ishte personi nr. 1. Ai e kalon tangencialisht periudhën kur ka qenë prokuror i përgjith-

shëm dhe Sekretar i KQ të PPSH gjatë periudhës nëntor 1948-mars 1952, ku s'janë bërë pak gjëra të kobshme në kurriz të këtij populli fatkeq. Në shtypin opozitar, gjatë vitit 1992, emri i Bedri Spahiut është përmendur disa herë, por akuzën më të rëndë këtij ish-lideri të PK Shqiptare ia bën z. Hysni Alimerko në gazetën «Balli i Kombit», duke e bërë përgjegjës indirekt për vrasjen e Hysni Lepenicës dhe të 36 ballistëve në Gërhot të Gjirokastrës në shtator të vitit 1943. Në replikën e tij Bedriu akuzon pa të drejtë Ismail Golemin, se gjoja ky kishte qenë shkaktari që kishte provokuar gjakderdhjen, po nuk mohon akuzën, se, në çastin e hapjes së zjarrit nga ana e ushtrisë italiane, ai ndodhej në zyrën e gjeneralit italian që komandante divizionin «Ferrara». Në këtë replikë ai shpall botërisht se s'ka për t'iu përgjigjur asnjë shkrimi që shkruhet kundër tij.

«KAPITENI I ASFALISË»

Kisha dëgjuar për Kosta Filin shumë gjëra. E kisha parë të filmuar kur doli si dëshmitar kryesor në gjyqin e kundëradmiralit Teme Sejko. Emri i Kostës ato ditë lakohej në të gjitha rasat në seancat e gjyqit fantazmë.

Kosta Fili! Kush ishte ky «palikar», që u bë «hero» i ditës në ato ditë maji të vitit 1961? Rasti e solli ta njihja personalisht në kampin me punë të detyruar të Laçit, më 1965. ishte një shtat mesatar prej atleti, gjysmë blond e me sy bojë qielli. Isthe i shkathët dhe çdo lëvizje e bënte të saktë. Fliste pak dhe dëgjonte shumë. Mjaft i kujdesshëm në marrëdhënie me njerëzit dhe mundahej të evitonte njohjet me bashkëvuajtësit. Shoqërohej vetëm me 2-3 bashkëfshatarë të tij dhe me asnjë tjetër. Rastësia e solli që të flinim afër me njëri-tjetrin, dhe kur mësoi se unë kisha qenë mësues disa vjet në Sarandë dhe në Konispol, filloi të afrohej, po gjithmonë me rezervë. Edhe natën, kur flinte, bënte gjumë lepurit. Shpesh ngrihej nga gjumi dhe qëndronte mbi shtrat duke pirë cigare. Me bisht të syrit vëzhgonte rreth e qark dhe kontrollonte me kujdes çdo lëvizje. Ishte e qartë se ai ruhej si shejtani nga thimjani nga ndonjë goditje e befasishme vdekjeprurëse. Mbi shpatullat e tij mbante shumë gjynahe. Një ditë më tregoi fotografinë e vajzës që vazhdonte shkollën pedagogjike në Janinë. Ishte një vajzë e bukur 14-vjeçare, me një fytyrë mjaft melankolike. Për përmbajtjen e letrës që kishte marrë nga familja nuk më tha asgjë. Mësova se gruan dhe fëmijët i kishte në Janinë. Ishte arratisur në Greqi nga katundi i lindjes Mursi, më 1953, në moshën 23 vjeç. Mbasi kishte kryer shërbimin ushtarak në kufi me Jugosllavinë dhe për «merita» të veçanta ishte graduar nënoficer. Në Janinë kishte zënë punë si fatorino autobuzi në linjën Janinë — Athinë —

— Janinë. Në fillim të vitit 1959 Z. Muzina, një tregtar shumë i pasur, që jetonte në Athinë, i ikur nga Shqipëria për t'u shpëtuar ndjekjeve të regjimit komunist, këshillohet me zotin avokat Papadhima, i arratisur edhe ai në Greqi, po për ato motive të Z. Muzina, për të gjetur mënyrën se si të tërhiqnin nga Shqipëria një shumë të konsiderueshme monedha ari, që Z. Muzina, i kishte propozuar afër një shëllgu në kopshtin e tij në Muzinë të Delvinës, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Z. Papadhima, mbas disa muajsh, njofton Z. Muzina, se ai kishte njohur një çift djem të shkathët, të arratisur nga Shqipëria, të cilët punonin në Greqi punëra të rëndomta dhe që mund të ishin të gatshëm ta kryenin misionin e Z. Muzina kundrejt një shpërblimi.

Z. Muzina e miratoi me kënaqësi planin e avokatis. pasi paret e propozura i konsideronte të humbura. Midis shumë banditëve, z. avokat parapëlqeu Kosta Filin nga Mursia. Mihal Licin nga Leshnica dhe Vangjel Zahon nga Alikoja. Që të tre nga rrethi i Sarandës, që e njihnin mirë terrenin ku do të vepronin. Takimi me të lartpërmendurit u bë në vilën e Z. Muzina, në prani të Z. Papadhima, ku u hartua një aktmarrëveshje për ndarjen e arit në mbarim të operacionit. U vendos që veprimi do të kryhej në fshehtësinë më të madhe dhe të tre shokët do të pajiseshin nga Z. Muzina me nga një pistoletë, para se të kalonin kufirin shqiptar. Zoti Muzina do t'i priste në Janinë për disa ditë. Kufiri u kalua në dhjetor të 1959-s, në afërsi të katundit Sminec, ku shtresa e dëborës ishte mbi 1 metër. Mbas 7 orë udhëtimi të mundimshëm të tre shokët arritën në katundin Leshnicë, ku u strehuan te tezja e Mihal Licit. Të nesërmen kishin vendosur të shkonin në Muzinë për të marrë arin e propozuar, po tezja e Mihalit, mbas një ore, kur tre shokët kishin bujtur në shtëpinë e saj, shkoi e denoncoi në repartin e kufirit dhe ata ranë si miu në çark. Nuk bënë asnjë rezistencë, por ngritën duart lart, me të dëgjuar breshërinë e armëve, në drejtim të shtëpisë dhe thirrjen «Dorëzohuni, se jeni të rrethuar!» I çuan në komandën e batalionit në Theologo, me duart të lidhura nga mbrapa dhe me thes të zinj në kokë, për të mos u njohur gjatë rrugës. Filluan të tringëllojnë telefonat me degën e Punëve të Brendshme të Sarandës dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Bëheshin pyetje dhe jepeshin urdhra me zëra të shqetësuar. Më së fundi u urdhërua nga Ministria e Punëve të Brendshme që të tre diversantët të niseshin urgjentisht për në Tiranë, me

masa sigurimi të jashtëzakonshme. U përgatitën qelira të veçanta dhe trajtim «special». Filloi hetuesia intensive. Gje-neral Nevzat Haznedari iu përvesh punës me vrull të papërmbajtur. Qysh në ditët e para të 3 diversanët treguan iden-titetin e tyre, qëllimin e ardhjes në Shqipëri dhe skicat, me të cilat i kishte pajisur Z. Muzina për të gjetur arin. Mini-stria e Punëve të Brendshme, nisi urgjent një grup special oficerësh në katundin Muzinë, të cilët natën vonë u kthyen në Tiranë, së bashku me arin e gjetur. Megjithëse gjetja e arit VËRTETONTE katërcipërisht deponimet e «3 diversan-tëve», hetuesit kërkonin me këmbëngulje deponime të tjera për misionin e tyre «tepër sekret» të ardhjes në Shqipëri. Nga torturat e përdorura prej xhelatëve hetues, Vangjel Zahoja çmendet, kurse Mihal Liçi kthehet në një kufomë të gja-llë dhe përfundon në spital. Kosta Fili për t'i shpëtuar fatit të shokëve të tij, pranon të luajë çfarëdo roli që do t'i ngar-konin. Mbas vizitës së Nikita Hrushovit në Shqipëri, në Maj 1959, i cili deklaroi në Aeroportin e Rinasit se vinte në Shqi-përi si ajo amvisa e mirë. për të fshirë pluhurat nga raf-tet, Enver Hoxhës çdo ditë i përforcohej ideja se sovjetikët kishin filluar të dyshonin për të dhe mund të përgatitnin përmbysjen e tij me anën e ushtarakëve të lartë shqiptarë, të përgatitur në Bashkimin Sovjetik. Diktatori Hoxha filloi të ravizonte në trurin e tij të sëmurë një projekt plan për të dhënë një goditje në radhët e ushtrisë, me qëllim frikësimi të oficerëve madhorë. Qysh në muajt e parë të vitit 1960, ua paraqit idetë e këtij plani shokëve të tij Mehmet Shehut e Hysni Kapos, duke rënë dakord që «kurbanit» do të ishte kundëradmirali Teme Sejko, i pasuar nga një grup oficerësh në marinë, në ushtri dhe kuadro partie. Për zbatimin dhe detajimin e hollësishëm të këtij plani u ngarkuan ministri i Punëve të Brendshme Kadri Hazbiu dhe tre ndihmësit e tij; Rexhep Kolli. Aranit Çela dhe Nevzat Haznedari. Plani, i detajuar. në fillim të majit, iu dërgua diktatorit për mira-tim, i cili, mbasi e miratoi, dha porosi që goditja të bëhej e rrufeshme dhe se repartet e kufirit e forcat e Sigurimit të viheshin në gatishmëri nr. 1, për të krijuar psikozë në popull se diçka përgatitej nga armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm kundër Shqipërisë.

Më 1 korrik 1960 u arrestua kundëradmirali «komplotist» Teme Sejko së bashku me 100 persona të tjerë, të piketuar qysh më parë nga organet e Ministrisë së Punëve të Brend-shme. Ndjaj këtyre fatkëqinjve. u vunë në përdorim «ko-

sheret e bletëve», të shpikura nga mendja diabolike e xhelatit Nevzat Haznedari. Për shumë muaj me radhë, «kapiteni i Asfalisë» Kosta Fili mësonte përmendsh nga oficerët e Sigurimit rolin që do të luante në gjyqin dramatik të Teme Sejkos. Ai trajtohej me ushqim special, njihej me anën e fotografive me personat kundrejt të cilëve do të depononte, mësonte pyetjet e mundshme që mund t'i bëheshin nga të pandehurit, dhe përgjigjet që do t'u jepte. Gjyqi u hap në fund të muajit maj 1961 në kinema «Brigada», rrethuar me tre kordonë policësh dhe oficerë sigurimi. Nuk mungonin dhe 2 makina zjarrfikëse në gatishmëri të plotë. Nga masat e sigurimit ky gjyq u kalonte të gjitha gjyqeve që ishin zhvilluar deri atëherë në Shqipëri nga diktatura komuniste. Në sallë hyhej vetëm me ftesa, të cilat u ishin ndarë kuadrove të larta të dikastereve, ushtrisë dhe Sigurimit. Ishin ftuar dhe pjesëtarë të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë. Prokurori i gjyqit ishte xhelati i mirënjohur i popullit shqiptar Aranit Çela dhe kryetar Shuaip Panariti. Dy të arrestuarit kryesorë Taho Sejko kryeredaktori i «Zërit të Popullit» dhe Hajri Mane, ish-kapiteni i zbulimit, nuk u nxorën në bankën e të akuzuarve se kishin vdekur gjatë torturave në hetuesi. Të pandehurit kryesorë ishin: Teme Sejko (kundraadmiral), 2. Abdyl Resuli (kolonel në ushtri), 3. Tahir Demi (kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Elbasanit) 4. Sami Murati (ish-sekretar i Partisë së Punës në rrethin e Sarandës) e të tjerë. Nuk mungonte në zbarën e të akuzuarve dhe gaztori 65-vjeçar Jonuz Purizo, kryeplak i katundit Vërvë gjatë tri regjimeve që i jepte këtij gjyqi tragjik dhe ngjyra të theksuara komike.

Në aktakuzën e lexuar nga prokurori thuhej se organet e Sigurimit të shtetit, të udhëhequra nga «porositë» e shokut Enver, kishin zbuluar një nga komplotet më të rrezikshme kundër Partisë dhe Republikës së Shqipërisë, të përgatitura nga UDB-ja Jugosllave, monarko-fashistët grekë dhe Flota e Gjashtë Amerikane. Beogradi. Athina dhe Shtabi i Flotës së Gjashtë Amerikane, të dislokuar në Mesdhe, kishin përgatitur me vite me radhë këtë plan gjakatar «për të përmbysur» pushtetin popullor në Shqipëri dhe popullin shqiptar do ta mbytnin në një lumë gjaku, por në sajë të vigjilencës së Sigurimit dhe të Partisë me në krye shokun Enver, komploti dështoi dhe komplotistët dolën në bankën e të akuzuarve. Gjithë aktakuza ishte një kopje e zbehtë e akt-

akuzave të gjyqeve staliniane të zhvilluara në Moskë gjatë viteve 1936-1937, e hartuar tërësisht me trillime të shpifura, që nuk mund t'i besonte askush, përveçse komunistëve fanatikë dhe injorantë. I vetmi gazetar i huaj që u lejua të merrte pjesë në disa seanca gjyqësore qe një gazetar polak, i cili shkroi se gjyqi kundër Teme Sejkos ishte një kostum i zi, i qepur me penj të bardhë. Ky përcaktim u transmetua dhe nga Radio Londra gjatë komenteve të saj në gjuhën shqipe.

Të gjithë komentatorët e radiove të huaja, gazetarë specialistë për çështjet ballkanike dhe opinioni i shëndoshë në vend, thoshin se ky gjyq ishte fund e krye një trillim dhe shigjetat e padukshme drejtoheshin kundër rusofilëve, duke i paralajmëruar se kështu do ta pësonin të gjithë ata që do të guxonin t'u shkonte ndërmend të ngriheshin kundër Enver Hoxhës.

Kosta Fili, me gradën e kapitenit të Asfalisë, i veshur shik, me kravatë dhe këmbë franceze, në çdo seancë depononte kundër të pandehurve, për takimet që kishte pasur me ta, si koordinator i «komp'otit». Ai fliste për kontaktet me Panajot Plakun, Haki Rushitin, Teme Sejkon, Hajri Manen e të tjerë, për urdhrat e gjeneralëve grekë, jugosllavë dhe amerikanë, për koordinimet e komplotistëve me shtabet e jashtme, për mesazhet e koduara që kishte transmetuar dhe të tjera profka, që i kishte mësuar përmendsh nga hetuesit e Sigurimit, gjatë gjithë kohës së izolimit të tij. Çudia ishte se çdo gjë që Kosta depononte kundër të pandehurve, ata e miratonin pa asnjë hezitim, madje disa, me pohimet e bëra, rëndonin më tepër pozitën e tyre të mjerrshme. Avokatët u porositën në mënyrë kategorike nga vetë kryetari i gjyqit Shuaip Panariti, se mbrojtja e të pandehurve nuk do t'i kalonte 15 minutat dhe do të ishte shumë e matur. Avokati i mirënjohur Koço Dilo më ka treguar në lidhje me këtë gjyq, se ka qenë për shumë ditë mjaft i shqetësuar, mbasi kishte përdorur gjatë mbrojtjes, për një të pandehur, fjalën *fatkeq*. Gjyqi dha vendimin me vdekje për shtatë të pandehur, midis të cilëve: Teme Sejko, Abdyl Resuli, Tahir Demi, Ali Arapi dhe për katër të tjerë: dënime me burgime të rënda. Mbas këtij gjyqi. Gjykata Ushtarake e Tiranës, dënoi me vdekje shumë «komplotistë» të lidhur me Teme Sejkon, si majorin e zbulimit Nevruz Bejleri, Refat Hamitin Beqo Plakun, Rushan Mul'ain, Dalan Dalanin, duke mos përmendur qindra vjet burgim që u

dhanë kundër qytetarëve të thjeshtë dhe të pafajshëm. Në të gjitha këto gjyqe, Kosta Fili, ishte dëshmitar i akuzës. Vetë ai u dënua me vdekje, por, kur mori përsipër rolin e ngarkuar, dënimi iu kthye me 25 vjet burg. Me frikë në zemër dhe ndërgjegje të vrarë edhe sot jeton në Gumenicë të Greqisë, i vetmuar, i sëmurë dhe i heshtur si peshku.

KOSHERET E BLETËVE

Qershor 1960

Zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme ndriçojnë nga dritat e ndezura gjithë natën. Punohet pa ndërprerje, ditë e natë. Hartohen listat e viktimave, që do të shoqërojnë arrestimin e kundëradmiralit «komplotist». Viktimat do të jenë çamër, të ndodhur në të gjitha rrethet e Shqipërisë. por më shumë në rrethin e Sarandës. Janë fshatarë të thjeshtë, punëtorë, zanatçinj dhe tek-tuk ndonjë kuadër, anëtar i Partisë së Punës. Në hartimin e planit operativ çdo gjë shkon si thika në gjalpë. Vetëm mbetet një pengesë që ende s'është zgjidhur: Si do të bëhet izolimi i 100 e ca personave që do të arrestohen në rrethin e Sarandës? Këta fatkëqinj, po atë ditë do të transportoheshin në burgun e Tiranës. Mendimet ishin të ndryshme, por asnjë variant nuk ishte i pëlqyeshëm. Dihet se një nga pikat kulminante të «shokut», që i jepesh personit të arrestuar, ishte izolimi hermetik prej mjedisit rrethues. Atëherë si do të izoloheheshin 100 e ca veta që do të arrestoheshin në pak orë? Duheshin 100 e ca gaze (një lloj xhipsi sovjetik me të cilin arrestoheshin zakonisht njerëzit). Kjo nuk ishte e lehtë, si do të veprohet pra për të bërë izolimin e të arrestuarit? «Eureka»! thirri gjithë entuziazëm kryehetuesi i Republikës gjeneral-majori Nevzat Haznedari. «Kosheret, kosheret! Urgjentisht të ndërtohen 100 koshere bletësh me dërrasa lisi. Ja dhe dimensionet: 80 cm 70 cm x 80 cm. Të mbërthehen me gozhdë 10 cm, me mbyllje hermetike, me dy doreza hekuri anash, me një brimë ballore afër kapakut me diametër 2 cm për një ajrosje minimale».

U hartua skica dhe u dërgua urgjentisht në burgun e artizanatit, me urdhër që të përfundonin brenda 48 orëve. Me të thënë e me të bërë. Sipër kapakut të koshereve, u shkruan numrat rendorë me bojë të zezë. Ky numër do të

korrespondonte me numrin simbas listës. Në grupin operativ, përveç oficerëve që do të merreshin me arrestimin e personave, u caktuan dhe katër policë të fuqishëm, që ushtronin sportin e ngritjes së peshave në klubin «Dinamo». Këta të fundit, do të kishin si detyrë futjen e të arrestuarve në koshere, mbylljen e saj me dy dryna anësorë dhe vendosjen e koshereve në makinën transportuese. Më vonë, kur të mbërrinin në Tiranë, do t'i shkarkonin kosheret dhe do t'i vendosnin simbas numrave rendorë nëpër biruca. Punë pak e lodhshme për këta diva të fuqishëm. Çdo gjë ishte përgatitur me përpikmërinë më të madhe. Në 30 qershor 1960 kolona me gaze dhe 3 kamionë të mbyllur, të ngarkuar me koshere, u nisën për në Sarandë, në fshehtësinë më të madhe. Operacionin e drejtonte vetë gjeneral Nevzati, i kapardisur në një «Varshavë» së bashku me 2 ndihmësit e tij. Si pikë-grumbullimi ishte caktuar posta e policisë në katundin Hoxhë (Livadhja) të Sarandës. Kolona mbërriti në Hoxhë në orën 23.00, ndërsa gjenerali, me ndihmësit e tij, e kaloi natën në shtëpinë e pritjes në Sarandë. Kryetari i degës së Punëve të Brëndshme i kishte marrë të gjitha masat për një pritje të përzemërt. Në darkën madhështore, ku s'mungonin as putarkat e skuqura dhe as thëllëzat e pjekura, as vera Italiane, dhe as vodka ruse. Në mëngjes u ngritën herët. Së bashku me kryetarin e degës dhe operativët e zonave, detajuan planin e arrestimeve. Nuk kishte asnjë problem. Personave që do të arrestoheshin natën e 1 korrikut, nuk u kishte shkuar kurrë ndër mend se ishin «piketuar» dhe u ishin caktuar dhe kosheret ku do të futeshin. Arrestimet do të fillonin në orën 3 mbas mesit të natës. Për të qenë «konform ligjit», gjatë bastisjes do të ishte i prani-shëm dhe një anëtar i këshillit popullor. Të arrestuarin fatkeq e lidhnin me pranga, me duar mbrapa shpinës dhe në kokë i vendosnin një thes të zi, për të mos parë asgjë se ku e çonin. Kjo bëhej krejtësisht për efekt psikologjik ndaj viktimës. Në postën e policisë së Livadhjasë të arrestuarin e priste Kosherja me numrin rendor simbas listës. Policët e fuqishëm e kapnin prej krahësh viktimën dhe me grushte e shqelma e futnin në kosheren që i përkiste. Ajo mbyllej hermetikisht, me dy drynat anësorë çelësat e të cilëve futeshin në një zarf me letër të fortë, që kishte të shkruar sipër numrin e kosheres. Zarfat depozitoheshin në një çantë që e mbante një nga oficerët e Ministrisë së Punëve të Brëndshme. Arrestimet vazhduan deri në orën 6 të mëngjesit

të datës 2 korrik 1960. «Plani u realizua 99%», mbasi një bari dhish nuk mundën ta arrestonin. Atij i kishte humbur një keç dhe gjithë natën bridhte gërxheve për ta gjetur. Në orën 10 të mëngjesit, kolona me kosheret e bletëve. u nis për në Tiranë. Para nisjes, nga pika e grumbullimit u nis ky radiogram për dikasterin: «Operacioni u krye me sukses. Kosheret e bletëve u nisën për Tiranë, — gjeneral-major Nevzat Haznedari».

SHKATËRRIMI I TRURIT

TË SËMURËT PSIKIKE NË BURGJE DHE NË KAMPE ME PUNË TË DETYRUAR

Një nga njollat më të zeza të diktaturës enveriane është trajtimi mizor i të sëmurëve psikikë në hetuesi, gjatë gjyqimit, në burgje dhe në spitalet psikiatrike.

Sa të sëmurë psikikë janë arrestuar. Sa janë çmendur në proceset hetimore? Sa të tillë janë dënuar nga gjyqet e diktaturës? Sa të sëmurë psikikë janë pushkatuar? Sa të tillë kanë bërë vetëvrasje? Sa të sëmurë psikikë të burgosur politikë janë sakatuar ose zhdukur nëpër spitalet psikiatrike të Vlorës, të Tiranës, dhe të Elbasanit?

Askush nuk e di me saktësi këtë numër dhe kurrë nuk ka për t'u mësuar e vërteta. Dora gjakatare e Sigurimit nuk ndalej për të arrestuar dhe të sëmurë psikikë, të njohur publikisht dhe të trajtuar nëpër klinikat psikiatrike. Më kujtohen:

1. Xhafer Dema, më 1963, mbasi nxitet nga disa provokatorë në një pijetore të Tiranës, bërtet «Rroftë Zogu!», paçka se Zogu kishte 2 vjet që kishte vdekur. Trajtohet mizorisht në hetuesi dhe dënohet me 8 vjet burgim.

2. Qemal Gega, doktor veteriner i diplomuar në Francë, i vëllai i Liri Gegës, megjithëse i sëmurë psikik dhe në moshën 70 vjeç, arrestohet dhe dënohet 10 vjet për agjitacion e propagandë. Një pjesë jo e vogël e të arrestuarve politikë, pësonin trauma psikike gjatë torturave në hetuesi, dhe «gjyqet e popullit». jashtë çdo norme ligjore, i dënonin këta fatkëqinj pa marrë aspak parasysh gjendjen e tyre shëndetësore.

3. I tillë ishte Petro Rondo nga Himara, i çmendur në hetuesi, më 1965, dhe gjyqi e dënon me 25 vjet burgim. 22 vjet punoi Petroja në galerat e Spaçit, duke ulërirë si ujë i tërbuar, pa asnjë mjekim, pa asnjë trajtim.

4. Hajri Pashaj nga Hekali i Mallakastrës. Babanë ia kishin pushkatuar komunistët dhe ai ishte çmendur në hetuesi në moshën 20-vjeçare. Gjyqi e dënoi me 20 vjet burgim Kur u bë revolta e Spaçit, në maj 1973, dërgohet në Spaç për të shuar revoltën me hekur e me zjarr, Drejtori i Sigurimit të Shtetit, Feçor Shehu, bashkëfshatar i Hajriut. Në një bisedë kërcënuese me të burgosurit, pas shypjes së revoltës, Feçori i thotë Hajriut: «Ti je armik. Edhe babanë armik e ke pasur, prandaj, si ia bëmë atij, kështu do të ta bëjmë edhe ty po e luajte bishtin!» «Mua, të më hash m...» — iu përgjigj Hajriu, shumë i zemëruar. Në atë situatë, vetëm një i çmendur mund të merrte kaq guxim. Pas kësaj Hajriun e pushkatojnë, bashkë me 3 të burgosur të tjerë, në një humnerë të Spaçit. Me Hajriun kam vuajtur 6 vjet dënim dhe të gjithë e dinin, se ai ishte i sëmurë psikik,

5. Kujtim Çuni, nga Kukësi, i arratisur me gjithë familjen në Jugosllavi, më 1949, kur ai ishte 2 vjeç. Shkon familjarisht në Australi dhe në moshën 16 vjeç kthehet në Shqipëri i fshehur në hambarët e një tragei italian. Me të zbritur në tokën e vendlindjes, e arrestojnë dhe e torturojnë derisa çmendet, për t'i marrë pohimin se ishte agjent i CIAS. Në gjyq nuk flet asnjë fjalë, megjithatë e dënojnë 10 vjet burgim. E bien në kampin e Fushë-Krujës, ku shkatërronte çdo gjë që gjente përpara e sidomos pasqyrat e berberëve. Gardianët e rrihnin për çdo ditë dhe e mbanin të lidhur me pranga. E hoqën nga kampi dhe nuk mësuam asgjë për fatin e tij.

6. Koço Gjini nga Korça, ish-oficer i Sigurimit. Dërgohet si i «arratisur» në Francë, më 1960, me mision për të vrarë Xhepin, (Sadik Premten). Me të mbërritur në Paris. ndërron mendje dhe nuk e kryen misionin që i kishin ngarkuar «ustallarët». Sigurimi shqiptar i bën atentat, por shpëton i plagosur rëndë. Shtrohet në një spital të Parisit nga autoritetet franceze, dhe, me ndërhyrjen e ambasadës shqiptare, kthehet në Shqipëri. Çmendet gjatë hetuesisë dhe dënohet me 25 vjet burgim. Kishte një trup të madh dhe zë të trashë, si të ariut. Verë e dimër bridhte nëpër kamp zbathur dhe i veshur me zhele. Kishte uri prej ujku dhe hante mbeturinat që hidheshin në plehra. Fliste vazhdimisht me vete, duke përsëritur, fjalën, Xhepi, Xhepi, Xhepi...

7. Aristidh Hesera nga Dropulli, nxënës i shkëlqyer. Arrestohet në moshën 18 vjeç, çmendet në hetuesi dhe bën vetëvrasje në Spaç, në moshën 23 vjeç.

8. Fadil Kokomani, vëllai i ish-gjeneralit Muharrem Komomanit, gazetar durrsak. Dënohet me vdekje, më 1963, për pikëpamjet e tij politike, por nuk ekzekutohet, se pëson traumë psikike gjatë gjykimit. S'i bëhet asnjë trajtim mjekësor dhe detyrohet të punojë me kamxhik mbi kokë, në kampet me punë të detyruar. Më 1978, duke qenë i çmendur, dënohet përsëri me vdekje dhe pushkatohet në Spaç, së bashku me Vangjel Lezhon dhe Xhelal Koprenckën.

9. Gjokë Hoti nga Bajza e Shkodrës, i sëmurë psikik në Spaç, ridënohet edhe 10 vjet të tjerë gjatë vuajtjes së dënimit të parë.

10. Ali Goxhaj nga Konispoli, ish-sekretar i Komitetit Ekzekutiv, arrestohet si «komplotist» me grupin e Teme Sejkos, më 1960. Nga torturat në hetuesi pëson traumë psikike. Dërgohet në spitalin psikiatrik të Elbasanit dhe mbas 10 vjetësh e nxjerrin nga spitali të pashëruar dhe e dënojnë me 25 vjet burgim. I çmendur, vuan 20 vjet dënim, duke punuar nëpër kampe me punë të detyruar. Sot brendh nëpër Shqipëri pa pension dhe i pakuruar.

11. Nexhdet Dalasi nga Devolli i Korçës. I çmendur në hetuesi. Dënohet 3 herë me nga 10 vjet burgim për agjitacion e propagandë, duke qenë i shtruar në psikiatrinë e Elbasanit.

12. Nush Huli nga katundi Fushë-Kuqe i Krujës, mësues. Arrestohet në moshën 22 vjeç, më 1960 i akuzuar për përgatitje atentati kundër Mehmet Shehut. Çmendet gjatë hetuesisë, megjithatë dënohet me vdekje. Presidiumi ia kthen dënimin me 25 vjet burgim. E sjellin në burgun e Burrelit, më 1963, mbasi e kishin mbajtur 3 vjet në spitalin psikiatrik të Tiranës.

13. Mazllëm.....¹⁾, kosovar. Vuante dënimin në burgun e Burrelit, megjithëse i çmendur, gjatë viteve gjashtëdhjetë bërtiste me një zë të llahtarshëm: «Më jepni bukë! Unë jam Zoti!».

Në spitalet psikiatrike dërgoheshin vetëm ata të sëmurë psikikë që paraqitnin rrezikshmëri dhe pengonin punën nëpër kampe. Ata mbaheshin në kushte tejet çnjerëzore, të zhveshur, të ndyrë, të zbathur, të uritur, me absese të hapura nëpër këmbë, me mikrobën e stafilokokut, për të mos lëvizur nga shtrati i tyre. Ata keqtrajtoheshin nga personeli mjekësor, shumë prej të cilëve ishin oficerë të Sigurimit të Shtetit, dhe,

1. Mbiemri nuk më kujtohet mbasi ka kaluar një kohë e gjatë.

simbas urdhrave që merrnin, edhe i zhduknin fizikisht, duke përdorur «marifetet e tyre». Të shumta kanë qënë rastet kur ata hidheshin me kokë në beton, nga katet e sipërme të spitaleve, ose digjeshin me alkool, që ia vidhnin personelit mjekësor. Ata mbaheshin në spitale për shumë vite dhe pa asnjë kurim. Kur ndonjë e tepronte me sharje kundër udhëheqjes së Partisë-shtet, e dënonin dhe e çonin në galerat e Spaçit ose të Qafëbarit. Në vitin 1983, në kampin e Përparimit të Sarandës, një i sëmurë psikik, që kundërshtonte të dilte në punë, u rrah nga gardianët derisa dha shpirt. Një tjetër të sëmurë psikik po në këtë kamp e xhveshën lakuriq në acarin e dimrit, e lidhën në një shtyllë dhe e lanë atje derisa vdiq. Shumë oficerëve të Sigurimit dhe të ushtrisë, që dinin «sekrete», kur dënoheshin u jepnin barna për të humbur kujtesën. Ishte i zakonshëm përdorimi i narkotikëve gjatë hetuesisë, për dobësimin e sistemit nervor. Efektet e këtyre barnave unë i kam ndier edhe diçka vjet mbas dënimit. Shumë të burgosur politikë kanë vuajtur gjithë jetën nga veprimi i tyre. Kjo dukej aqik në kapanonet e Spaçit, dhe të Ballshit, ku kishte me shumicë të burgosur të sëmurë: «Pavijoni nr. 6» i Çehovit, ishte parajsë në krahasim me pavijonet tona psikiatrike. Simbas Kodit Penal të diktaturës komuniste, kur i burgosuri dënohej me vdekje dhe pësonte traumë psikike, vendimi nuk mund të ekzekutohej pa raportin e një komisioni mjekësh psikiatër, të cilët duhej të vërtetonin se i dënuari ishte plotësisht i përgjegjshëm. Në të shumtat e rasteve mjekët e pa aftë nuk ishin në gjendje të dallonin simulantin nga i sëmuri psikik.

Atëherë këtyre mjekëve sharlatanë u vinte në ndihmë Sigurimi me «minj birucash», që ishin «specialistë» për të përcaktuar nëse i dënuari me vdekje ishte me të vërtetë i çmendur apo simulant. Këta futeshin në qeli së bashku me të dënuarin dhe qëndronin atje gjersa të zbulonin të «vërtetën». Fjala e tyre i çonte në plumb ose në spitalin psikiatrik fatkëqinjte e dënuar me vdekje. Dhe mjekët e «nderuar», mbasi hidhnin firmat në raportin mjekësor, e shuanin rimorcin e ndërjegjes me gota konjaku.

Personat me trauma psikike, që u përmendëm më sipër, unë i kam njohur personalisht gjatë vuajtjes së dënimit tim 11-vjeçar. Mund të them me siguri se të burgosurit politikë me trauma psikike, gjatë periudhës gjysmëshekullore të diktaturës komuniste në Shqipëri, kanë qënë diçka qindra.

GJENERALI I ZI, NEVZAT HAZNEDARI

Nevzat Haznedarin e njihja si fytyrë qysh më 1947-n, kur ai, si prokuror ushtarak, ishte bërë i lahtarshëm në gjyqet që zhvilloheshin në kinema «17 Nëntori» të Tiranës, ndaj të ashtuquajturve «grupe armiqësore». Më ishin ngulur në kujtesë koka e tij e madhe si e sllavëve të vjetër, trupi i tij i fortë, por pak i kërrusur, sytë e tij ngjyrë çeliku, që çlirojnë edhe beton armenë dhe duart e tij, si putrat e ariut siberian. Më kishin thënë se rridhte nga një familje bejlerësh të rënuar të Leskovikut. Babai i tij, gjatë viteve tridhjetë bridhte kafeneve të Korçës, në gjendje të mjerueshme, derisa vdiq në rrugë dhe e varrosi bashkia. Nevzati në atë kohë vazhdonte Normalen e Elbasanit, me bursë shtëfi. Në Normale, shokët e thërritnin me nofkën «egërsirë». Literatura e tij e preferuar ishin romanet me tortura. Më 1938-n, mbasi mbaron Normalen e Elbasanit, emërohet mësues në katundin Postenan të Leskovikut. Ish-nxënësit e tij tregojnë se atyre u shpëtonte shurra kur mësuesi i kërcënonte edhe për gabimet më të vogla. Mbasi s'bëri dot karrierë në Partinë Fashiste, gjatë periudhës 1939-42, hoqi këmbë e zezë dhe veshi këmbë e kuqe, duke u bërë një nga krerët e lëvizjes komuniste në nënprefekturën e Leskovikut, së bashku me Kiço Kasapin dhe Ali Glinën. Në pranverën e 1943-shit, ai pushkaton në grykën e Postenanit Gaqi Tashkon së bashku me të birin, Petraqin dhe Petro Tashon, për të vetmin faj se ishin distancuar nga Lëvizja Nacionalçlirimtare, kur kishin kuptuar se atë e drejtonte dora e komunistëve. Në fund të 1944-ës, ekzekutohet Muharrem Rusi, ish-kryetar i bashkisë së Leskovikut, njeri i nderuar dhe i respektuar në të gjithë krahinën. Fill mbas vendosjes së diktaturës komuniste, Nevzati iu caktua detyra e prokurorit ushtarak të qarkut të Korçës, ku bëhet i famshëm për bëmat dhe gjëmat e tij. Merr pjesë në ekzekutimin e grupit të inxhinierëve të Malëqit në nëntor të

vitet 1946, duke u hedhur me dorën e tij litarin në fyt, Abdyl Sharrës dhe Kujtim Beqirit. Zoti Ali Selenica, jurist, vdekur në burgun e Burrelit, më 1963, gjatë vuajtjes së dënimit me të, më tregonte se në fillim të 1945, kur ai punonte si avokat në qytetin e Korçës, gjyqi ushtarak komunist, me prokuror Nevzat Haznedarin, jepte çdo ditë «në emër të popullit» 10-15 dënime me vdekje. Shumica e të dënuarve ishin intelektualë dhe fshatarë analfabetë, që kishin shkuar me forcat e Ballit.

Gjyqi s'bënte asnjë dallim midis fajtorëve të vërtetë dhe të pafajshmëve. Shpata e diktaturës komuniste në dorën e kriminelit Nevzat binte mizorisht mbi kokat e njerëzve të pafajshëm. Merreshin nëpër këmbë dhe normat më të thjeshta juridike. Të tilla gjyqe nuk zhvilloheshin as në kohën e inkuzicionit dhe jo e jo në kohën e sundimit otoman. Sado i du ruar dhe frikacak që të ishte, revoltoheshë nga kjo «drejtësi» e përdhunuar mizorisht. U revoltova më tregonte Z. Selenica, kur Nevzati kërkoi dënimin me vdekje për një ballist nga fshatrat e Devollit, që ishte memec. Ai e akuzonte, midis të tjerash, se devolliu ballist kishte zhvilluar propagandë kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Zoti Ali, si avokat i të pandehurit, thoshte se akuza kundër klientit të tij ishte sa absurde, aq edhe qesharake, mbasi i akuzuari ishte memec dhe s'kishte mundësi ta kryente krimin e agjitacionit. Nevzati e kishte fyer avokatin me fjalët më të ndyra dhe e kishte akuzuar se kishte qenë fashist dhe për këtë arsye i mbronte me zjarr armiqtë e popullit.

Zoti Ali Selenica replikon me prokuror Nevzatin duke i thënë se fashist kishte qenë ai, gjë, që ishte e njohur nga gjithë qarku i Korçës, kapiten Nevzati tërbohet nga zemërimi dhe kërkon pezullimin e seancës gjyqësore. Zoti avokat Selenica, mbas 1 ore, e pa veten me pranga në duar, në një qeli të errët të sigurimit të Korçës. Mbas tre muaj torturash, të bëra personalisht nga Nevzati, zoti Ali u dënua me burgim të përjetshëm si «armik i popullit», kurse dy djemtë e tij, për t'u shpëtuar persekutimeve, u vranë duke u përpjekur të kalonin kufirin shqiptaro-grek. Brenda 11 vjetëve (1945-56), duke guar me qindra njerëz në botën tjetër, xhelati Nevzat arriti gradën e gjeneralit, duke u bërë simbol i krimit shtetëror. Nuk kishte të arrestuar për çështje «armiqësore» që Nevzati të mos e kishte marrë në pyetje dhe të mos e kishte «ledhatuar» me putrat e tij. Nuk kishte të burgosur që të kishte shpëtuar pa u gjakosur nga takimi me të. Edhe xhela-

tët e vegjël nëpër zyrat e hetuesisë, nëpër burgjet dhe kampet e përqendrimit, qëndronin para tij si pula të shushatura. Kaloj nëpër duart e tij me mijëra viktime, që nga fshatarët e thjeshtë, gjer tek intelektualët e shquar, ministra, gjeneralë dhe anëtarë të Byrosë Politike, duke e mbyllur karrierën me «grupin» e Beqir Ballukut. Më 1954, kur të burgosurit politikë në kampin nr. 4 në Tiranë, u përpoqën të hapnin një tunel për të shpëtuar nga ferri komunist, «drejtësia» enveriane ra pa mëshirë në krenat e atyre fatkëqinjëve, që deshën të fitonin lirinë e grabitur padrejtësisht. Mbi 20 veta u dënuan me burgime të rënda dhe 4 prej tyre: Abdul'a Bajrami, Mark Zefi, Isuf Velaçni dhe Zyhdi Mancaku u ekzekutuan në qelitë e burgut të vjetër të Tiranës nga xhelati Haznedar, duke u çarë kafkat me levë hekuri. Takimin personal me këtë Lucifer, e pata në një dhomë të hetuesisë së burgut të Tiranës. në prillin e vitit 1962. Ishte i shoqëruar me 3-4 oficerë madhorë, që qëndronin gatitu mbrapa tij. I lidhur me pranga, më ulën në karrigen e betonuar të të pandehurit ndërsa gjeneral Nevzati. me një vizore në dorë, më pyeti se çfarë kisha biseduar me baxhanakun e tij, mësues Fatmir Beratin. I thashë se me Fatmirin kisha qenë koleg në shkollën «50-Vjetori» të Kombinatit të Tekstileve, dhe s'kisha aq afëri me të për të biseduar çështje politike. Filloi të bërtiste me të madhe dhe u kthye nga oficerët duke u thënë se ne duheshim linçuar po ç't'i bënte shokut Enver, që thoshte të zbatohet ligji. «Këta surretër deshën të riformonin Partinë Social-Demokrate, atë që s'e bëri dot Musine Kokalari, më 1946-n dhe do ta pësojnë në më keq se ajo.» Me një të hapur të krahëve, sikur do të çante dru, ma veshi me vizore në kokën e qethur zero. M'u errën sytë dhe i mbuluar me gjak rashë nga karrigia pa ndjenja. Kur erdha në vete, pashë se ndodhesha në qelinë time, me një leckë të ndyrë të lidhur në kokë. Kapter Koli, që shquhej për butësi midis gardianëve të qelive. më solli një shami të lagur me ujë, për të fshirë gjakun e ngrirë në fytyrë dhe në rrobat e trupit. E dija se Fatmir Berati ishte baxhanak me Nevzatin, por ky i fundit nuk fliste me të dhe deshi ta fuste brenda. mbasi Fatmiri e kish origjinën nga një familje e prekur nga pushteti komunist. Ky qe takimi i parë dhe i fundit me kryexhelatin e diktaturës enveriane, gjeneralin e zi, Nevzat Haznedarin. Më 1959 Nevzati rimonton grupin e Leskovikut me persona që kishin shpëtuar të gjallë mbas vuajtjes së dënimit. prej grupit të Leskovikut, të 1947, duke i shtuar dhe fatkëqinj të tjerë, për të plotësuar numrin stan-

dart 20. Kësaj radhe operacionin e kryente zëvendësministri i parë i MP Brendshme, Mihallaq Ziqishti, me ndihmësit e tij, Rexhep Kollin e Nevzat Haznedarin.

Vangjel Stefan Cini, që ka mundur të shpëtojë gjallë nga grupi i Leskovikut, më ka treguar me zë të dridhur dhe fytyrë të ngrysur për ato ditë të tmershme torturash. Arrestimet u bënë në orën 02.00 të 30 marsit 1959. U arrestuan 19 veta brenda 1 ore, mbasi numri 20 në listë, Kolaq Koznai, kishte vdekur dhe për këtë i hoqën vërejtje të rëndë mikroshelatit Tare Isufi, Kryetar i degës së Punëve të Brendshme të Kolonjës, që s'kishte njoftuar me kohë dikasterin për zëvendësimin e tij. «Më torturuan në mënyrën më çnjerëzore. Më lanë vetëm mbathjet, më lidhën këmbë e duar me prannga dhe me një zinxhir në qafë. Tare Isufi, më tërhiqte rrëshqanë në dyshemenë e një dhome torturash, ndërsa Nevzati, me takat e çizmeve, më godiste me sa mundte gishtat e duarve dhe të këmbëve. Më binte të fikët, më hidhnin kova me ujë për t'u përmendur dhe, kur unë përmendesha. Rexhep Kolli me Nevzatin më thoshin të pohoja se isha agjent grek, përndryshe do të ma merrnin shpirtin pak e nga pak. Mbasandaj Nevzati ndërronte torturën, më shtrengonte fytin dhe në sekondat e fundit të frymëmarrjes ma lironte, duke më hedhur në gojë tym duhani, që më shkaktonte një kollë të tmerrshme, që s'kam për ta harruar sa të jem gjallë. Mbas 3 ditë torturash më çuan në lumin e Starjes, ku kishin hapur një varr rreth 50 cm të thellë. Më futën brenda dhe Nevzati më drejtoi «smithin» e bardhë me mulli në lulen e ballit. Instinktivisht mbylla sytë, dhe ai qëlloi në ajër, pastaj urdhëroi të më nisnin për Tiranë, ku do të ma hiqte mishin me pinca. Mbas 10 muaj torturash, kur ne pranuan çdo gjë që na servirën hetuesit, simbas skenarit të gjeneral Nevzatis, na nxorën në gjyqin ushtarak, me përjashtim të Thanas Lulës, të cilin nuk e thyen dot dhe i trembeshin, se ai do të hidhte poshtë me përbuzje akuzat e sajua, gjë që mund t'u jepte zemër dhe shokëve të tjerë të grupit. Gjatë seancave gjyqësore, Nevzati, në sy të gjyqtarëve, na kërcënonte vazhdimisht, duke na thënë se kokat tona do t'i dërgonte me tepsi në Leskovik, si kokën e Shën Joan Pagëzuesit. Mbas katër seancash gjyqësore, u dënuan me vdekje Mihal Cini, Thoma Buda, Janaq Ruqi, Hajredin Gega, Shahin Hajdari, Këço Kuqoshi dhe Thanas Vila (në seancë të veçantë), të cilët u ekzekutuan mbasi disa ditësh, ndërsa Xhevat Zerja dhe Musa Shemja vdiqën në duart e xhelatëve hetues. Tre të tjerë vdi-

qën gjatë vuajtjes së dënimit dhe gjithë të tjerët kanë vdekur mbasi u liruan nga burgu, me përjashtimin tim, që arrita të shoh lindjen e demokracisë dhe të nxjerr në dritën e diellit krimet e diktaturës komuniste.

Për çdo grup «armiçësor» që do të arrestohej në Shqipëri Nevzati do të shpikte diçka të re në torturat e tij. Për «komplotistët» e Teme Sejkos vuri në përdorim kosheret e bletëve, për grupin e Devollit, dollapët e hekurt, atyre që do të pushkatoheshin më parë u thyente kafkat me leva hekuri. Kripën në plagët e hapura, ampulat me vaçuri, futjen në gropat e fekaleve, korentin elektrik, shtrydhjen e organeve gjinitale, futjen në fuçi me copa akulli, varjen nëpër çengela kokëposhtë, fryrjen me pompë nga anusi i quante jashtë mode, dhe të konsumuara prej tij. E kishin dërguar për përvojë në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë por thuhet se «shokët» kinezë i la me gojë hapur, nga përvoja e tij shqiptare. Ata thanë se s'kishin çfarë t'i mësonin këtij «gjeniu» në lëmin e torturave dhe e falënderuan duke i dhuruar në shenjë mirënjajeje një libër me skica torturash që përdorehin në kohën e dinastisë Min.

Më 1974 diktatori e thirri Nevzatin nga Elbasani, ku kryente detyrën e kryetarit të degës së Punëve të Brendshme, për t'u bërë hetuesinë «deshve të ushtrisë». Shpirtërat e Beqir Ballukut, Petrit Dumes e Hito Çakos, e dinë se çfarë kanë hequr nga ky satana, deri dje shok dhe mik i tyre. Flitet se ndaj tyre ka përdorur torturat e Dinastisë Min, të përpunuara ashtu siç dinte ai. Me këtë hetuesi e mbylli karrierën e «lavdishme» një nga xhelatët më të ndyrë që ka nxjerrë kombi shqiptar. Diktatura i dha si shpërblim një vilë në rrugën «Tefta Tashko» dhe pension special. Vdiq papritur dhe njerëzit flasin se e helmuan me urdhër të diktatorit për të zhdukur një arkiv të gjallë krimesh. Me siguri shpirti i tij ndodhet në rrethin e nëntë të Ferrit.

DEKLARATA¹⁾

Kur më çuan në burgun e Burrelit, në vjeshtën e 1962-shit, më caktuan në kaushin nr. 9. Midis 40 të burgosurve që ishin në këtë kaush, ndodhej dhe Muhamet Hoxha nga Gjirokastra. Metja, siç e thërritnin bashkëvuajtësit, kishte një trup mesatar, por të fuqishëm. Ecte pak i përkulur nga një reumatizëm kronik. Sytë i kishte të rrumbullakët si dy sfera bojë qielli dhe i lëvizte në mënyrë të habitshme. Fliste shumë dhe cigaren «mahorka», të mbështjellë me fletë librash të vjetër. s'e hiqte nga goja. Qe veshur me një palë rroba të vjetra shajaku, të përshtatshme për klimën e ftohtë të Burrelit. Shpesh këndonte me zë të ulët këngën e vjetër labe:

*Gryk' e Selckës është zënë,
I ziu Resul nga të bëjë,*
.....

«I pëlqen» Metes kjo këngë, më thoshte profesor Foto Bala. «Resuli është i ziu Mete, dhe... Gryka e Selckës është burgu» dhe buzëqeshte idhur.

— E qartë, — iu përgjegja Fotos dhe shihja Muhametin me keqardhje e kureshtje.

Një ditë më ftoi në dyshekun e tij: «Babën tënd e kam njohur, — më tha, — në mos gabohem, ka qenë mësues, apo jo? E pinte duhanin me llullë. Ti ke qenë i vogël atëherë. Më thanë se, kur u rrite, u bërë mësues historie dhe banoje në Tiranë. Mos u mërzit! S'do mbetet burrë në Shqipëri pa provuar derën e burgut. Por, kam një hall tjetër, Kam shkruar, ashtu siç di unë, kujtimet e mia, S'kam shkollë; vetëm pesë klasë fillore dhe një kurs njëvjeçar xhandarmërie. Tani

1) Shih shënimin në fund të faqes 108.

kam dëshirë t'i hedhësh dhe ti një sy e një dorë. Si thua, do ma bësh këtë nder?»

«Me shumë qejf», — i thashë.

«Janë kujtimet për jetën time, ç'kam kaluar e ç'kam hequr. Janë të vërteta si drita e diellit, madje disa gjëra dhe i kam harruar. Kanë kaluar vite... Po të duash kopjoi, ndoshta ndo një ditë do të të duhen.»

Shqepi dyshekun dhe nxori një bllok të sajuar me lloj-lloj copa letrash të shkruara me laps, por me një shkrim të lexueshëm. E mora dhe shkova në vendin tim.

Unë, Muhamet Hoxha kam lindur në Gjirokastrë, në lagjen «Palorto», rrugën «Sokaku i të marrëve», më 1915. Mbas mbarova shkollën fillore, hyra në gjimnaz, por, meqë s'veja mirë me mësim, im atë, Zequa, më hoqi nga shkolla dhe u detyrova të punoja poshtë e lart në punëra të rëndomta dhe të vështira për të nxjerrë bukën e gojës. Më 1935 vendosa të regjistrohesh në shkollën e xhandarmërisë. Mbas një viti e mbarova kursin me nota të mira. U emërova tetar xhandarmërie në nënprefekturën e Krujës, me rrogë mujore 60 franga ari në muaj. Detyrën e kryeja me korrektësi, eprorët më lavdëronin dhe mbas dy vjetësh u gradova rreshter.

Më 1939, në kohën e pushtuesit italian, u futa në karabinieri, me gradën kapter. Shërbeja si postëkomandant në qytetin e Kavajës.

Në verën e vitit 1943 u transferova me shërbim në Elbasan. Atje pata rast dhe ndihmova Llambi Peçinin dhe dy komunistë të tjerë të arratiseshin nga burgu. S'di si m'u mbush mendja dhe thashë të bëja një sevap.

Në korrik të vitit 1943, në një operacion në nënprefekturën e Gramshit, 100 karabinierë shqiptarë iu dorëzuan forcave partizane. Një pjesë e mirë qëndroi me ta. Unë dhe disa të tjerë nuk pranuan, atëherë komanda partizane na mori nga një deklaratë, ku zotoheshim se do të venim në shtëpitë tona dhe nuk do të shërbenim më në forcat e armatosura, ndryshe do ta paguanim me kokë. Menduam se kjo u mbyll me kaq. Me t'u kthyer në Elbasan të çarmatosur, italianët na arrestuan dhe do të na nxirrnin në gjyq ushtarak si dezertorë e tradhtarë, po kapitullimi i Italisë në shtator të '43-shtit i pengoi. Ne shpëtuam.

Gjatë okupacionit gjerman vazhdova të shërbeja në armën e xhandarmërisë në Tiranë, me gradën kapter i parë. Koha rrokullisej me rrëmuje.

Mbaroi tetori dhe hyri nëntori i vitit 1944. Punët dukeshin ashiqare se si do merrnin fund. «Deklaratën» e dhënë partizanëve dhe që se kisha harruar më shfaqej çdo natë në ëndërr. Më bëhej si një litar që më shtrëngonte fytin. Shpesh ngrihesha i llahtaritur nga gjumi, i mbuluar me djersë. Ndizja cigaren dhe rrija e mendohesha ashtu pa gjumë deri në mëngjes. Si të bëja? Të ikja? Ku të veja? S'kisha asnjë grosh në xhep. Prindërit e mi ishin të vjetër dhe s'kishin asnjë ndihmë veç meje. Të qëndroja? Mos o Zot! Kisha dëgjuar se disa shokë të mi i kishin pushkatuar partizanët në Berat dhe në Korçë. Pra, patjetër duhej të ikja; nga sytë këmbët.

Më 2 nëntor u nisa për në Shkodër. Atje ziente si në kosherë bletësh. Shihje kudo në rrugë turli njerëzish të armatosur; ballistë me shqiponjë në kapele, zogistë me qeleshe të bardha, mirditorë të Marka Gjonit, xhandarë me uniforma, dibranë të Halil Alisë, oficerë shqiptarë me automatikë nër duar, komunistë të dezertuar me Sadik Premten në krye, të dënuar me vdekje në mungesë nga Partia Komuniste, çetnikë me mjekrra të zeza, bullgarë, kaukazllinj e deri grekë të kuizlingut Luras. Armë nga të gjitha arsenalet e botës! Uniforma të shumëngjyrshme. Në kafenetë dhe restorantet s'kishe vend ku uleshe e kudo dëgjohej: «Shkodra nuk do të bjerë në duart e komunistëve; 20.000 të armatosur mund ta mbajnë atë derisa të bëhet zbarkimi i anglo-amerikanëve që pritej ditë-ditës. Nga ana tjetër, edhe 10.000 çetnikë jugosllavë, me në krye Drazha Mihalloviçin, kishin bërë ofertën për të ardhur në Shkodër. Tregtarët shkodranë ishin të gatshëm të ndihmonin me para dhe ushqime. Formoheshin komitete njëri pas tjetrit, me emra nga më të çuditshmit. Krerët vazhdonin mbledhjet natë e ditë. Të gjithë qemë si në ethe.

Edhe moti ishte kundër nesh. Shi, breshër, borë, të ftohtë si në asnjë vjeshtë tjetër.

Komanda gjermane ishte e irrituar. Ajo i shikonte këto forca të armatosura jo si fatkeqe, por si fajtorë të pjesshëm për disfatën e tyre. Kolonat gjermane tërhiqeshin drejt veriut si gjarpërinj të plagosur. Brigadat e shumta partizane po mbyllnin darën e rrethimit përreth Shkodrës. Zbarkimi aleat s'po dukej. Disa krerë po zhdukeshin pa lënë gjurmë. «Komitetet» u shkrinë si kripa në ujë. Oburra t'ia mbathim! Një shumicë e madhe u drejtua nga Ulqini; ia hipën motobarkave të ulqinakëve dhe i ranë Adriatikut mes për mes. Disa qindra të tjerë, me në krye Halil Alinë, Prengë Calin e Idriz Jazoniu ngjiten maleve me borë. Po kështu, qindra të tjerë,

me Ismail Golemin me shokë, vajtën në katundin Bardhaj dhe iu dorëzuan partizanëve. Një pjesë tjetër, edhe kjo e madhe, iu ngjiti si me mastiçe autokolonave gjermane, pa ditur se ku shkonin.

Kisha mbetur para «Kafes së Madhe», i drobitur, me sy të zgurdulluar. Ç'të bëja? Nga t'ia mbaja?! Për Ulqin? Po minat në det? Po nëndetëset nën ujë? Të veja në malë për të luftuar, s'më kishin mbetur më forca. Po të dorëzohesha te partizanët e dija ç'më priste. Deklarata më shponte sytë. Ndërkohë, si e dërguar nga qielli, para meje ndaloi një kamionçinë me ballistë të armatosur. Në të qe Mehmet Alltuni nga Kavaja. Iu luta të më merrte të paktën deri në Podgoricë, por ai më tha që s'kishte mundësi. Kamionçina qe ngarkuar mbi kapacitetin, si të ishte një mullar me njerëz. Iu luta me lot në sy, duke i thënë se mund të qëndroja edhe në parafango, ndonëse binte shi e borë. Siç duket u prek dhe më lejoi. U nisëm. Makina uturinte nga mbingarkesa. Lamë prapa Shkodrën dhe morën drejtimin e Koplikut. Rrugës shikoje njerëz të armatosur dhe makina të rënda gjermane të mbuluara me rrjeta maskimi. Mbas një ore udhëtimi kaluam Hanin e Hotit dhe u futëm në tokën Jugosllave. Lufta kishte zhdukur kufijtë dhe postëblloqet. Ku shkonim asnjë s'e dinte, veç larg e drejt veriut, pa destinacion të caktuar, pa ditur ç'mund të na ndodhte një orë më vonë, ose... edhe një minutë më vonë.

Në mbrëmje mbërrimë në Podgoricë (Titogradi sotëm); një qytet i shkatërruar nga bombardimet anglo-amerikane. Aty takoj shumë ballistë nga Shqipëria e Jugut. Strehohem bashkë me ta në një hotel gjysmë të rrënuar, ku, të mbledhur rreth zjarrit, na zuri gjumi nga lodhja.

Mbas dy ditësh qëndrimi në Podgoricë, filluam marshimin me këmbë drejt Sarajevës. Ishim rreth 200 shqiptarë të armatosur. Ecnim natën dhe ditën, për të mos u zbuluar, strehoheshim në fshatrat e braktisura buzë rrugës, banorët e të cilëve, me qen e mace, qenë larguar me kohë. Avionët anglo-amerikanë s'pushonin së bombarduari gjatë gjithë ditës. Ishim pa ushqim dhe veshje dimërore. Gjatë ditës kontrollonim ndër shtëpitë e braktisura mos gjenim diçka për të ngrënë, thaheshim në zjarre dhe natën vazhdonim udhëtimin. Auto-kolonat gjermane, me drita blu, ecnin me utërimë përkrah nesh. As me sy nuk na shinin e jo më të na ndihmonin, sikur

gjer dje s'ishim aleatë. Nuk bënin më shumë se 20 kilometra gjatë natës, kështu që mbas rreth 20 ditësh mbërrimë në Sarajevë. Ishim të rraskapitur dhe të uritur. Banorët dhe forcat e rendit atje na shikonin sikur të kishim ardhur nga një planet tjetër. Drejtuesit tanë shkuan në komandën e Sarajevos, atëherë ata na strehuan në një xhami të madhe. Banorët e qytetit na sollën ushqime. Kur na pyesnin për emrat dhe dëgjorin nga ne «Muhamet», «Beqir», «Osman», etj. buzëqeshnin dhe thoshin «Dobro musliman». Kështu qëndruam 1 javë, aq sa morëm pak veten.

Nga fundi i dhjetorit erdhi te ne Vehbi Frashëri dhe na tha se kish siguruar autorizim nga komanda gjermane për të na nisur me autokolonat e tyre deri në Zagreb. U nisëm në 1 janar, në mbrëmje. Ecnim shumë ngadalë, makinat ndaleshin herë pas here për t'iu fshehur bombardimeve ajrore. Në Zagreb arritëm mbas 14 orësh udhëtimiti.

Qyteti ishte mbuluar nga bora. Na strehuan në disa kazerma në periferi të qytetit, ku gjetëm dhe shumë shqiptarë të tjerë të ardhur para nesh. U bëmë kështu rreth 500 veta. Na dhanë ndërresa dhe uniforma të reja, blu, siç dukej nga rezervat e ushtrisë franceze. Natën ishim më të qetë. Ditën orë e çast kishte alarme ajrore. Drejtoheshim nga një shtab me në krye kolonel Vehbi Frashërin.

Një ditë na lajmëruan se do të na vizitonte një anëtar i qeverisë kroate. U mblodhëm në një kazermë që shërbente si kinema. Ministri kroat erdhi i shoqëruar nga disa oficerë ustashe dhe konsullin shqiptar pranë Republikës Kroatë. Konsulli, që përfaqësonte «hiçko habilin» (asgjënë), luante vetëm rolin e përkthyesit. Ministri, pasi na uroi mirëseardhjen, shprehu keqardhjen për pushtimin e Shqipërisë nga të kuqtë. Foli për armën sekrete gjermane që do vihej së shpejti në përdorim dhe do të ndryshonte fatin e luftës. Na ftoi që të kishim besim te Fyhreri dhe te Raihu III. Na tha se fitorja do të ishte e sigurt! Pastaj, si me ngadalë, filloi të futej në temë, për qëllimin e vizitës së tij. Konsulli përkthente me një dialekt të rëndë shkodran. Me fjalë të bukura, ministri na bëri thirrje që të inkuadroheshim në ushtrinë kroate: do të na paguanin me florinj dhe së fundi do të na ndihmonin të çlironim Shqipërinë nga komunistët. Shkurt, na ftoi të regjistroheshim vullnetarë.

I pari u ngrit Nexho Bejleri nga Libohova. Ishte trim dhe syri s'i bënte tërr. «Ore zotërinj, — tha Nexhua, — ne s'ishim në gjendje të mbanim Shqipërinë dhe jo të mbrojmë

Kroacinë! Ju falënderojmë për mikpritjen, po na lini të qetë të vazhdojmë rrugën tonë të panjohur për ku jemi nisur.»

Ministri kroat thartoi buzët dhe konsulli shkodran diçka pëshpëriti nëpër dhëmbë. Megjithatë, oferta kroate gjeti joshës dhe u regjistruan rreth 50 vullnetarë. Këta u larguan po atë natë, së bashku me oficerët kroatë, në drejtim të panjohur për ne.

Mbas dy javësh u larguam nga Zagrebi me trena gjermanë drejt Austrisë. Ishim ndarë në grupe të vogla dhe qëndra e grumbullimit do të ishte qyteti austriak Insbruk. Duke udhëtuar për disa orë, gjithnjë natën, kaluam në tokën austriake. Mëngjesi na zuri në një stacion fshati që ishte një kryqëzim i madh rrugësh të hekurta. Shumë trenat kishin ndaluar në vend të shkatërruar nga bombardimet ajrore, që sapo kishin pushuar. Duke pritur shumë orë, derisa të hiqeshin lokomotivat dhe vagonët e shkatërruar, papritmas nga qielli u dëgjua gjëmim, i avionëve të rëndë bombardues. Filloi një bombardim i tmerrshëm. Toka dridhej si të ishte goditur nga një tërmet shumëballësh. Ç'të shihje!? Trena që digjeshin, civilë e ushtarakë të lebetitur, të vrrarë e të saktosur. Njerëz që fluturonin si harabela. Unë s'di se si u gjenda poshtë një ure të vogël këmbësorësh. U shtriva mbi betonin e ngrirë të urës, me duart mbi kokë. Bombat pëlctinjin njëra pas tjetrës: një ferr i vërtetë, që s'di sa vazhdoi. Në këto raste minuta të duket orë.

Kur u qetësua çdo gjë, u ngrita, hodha sytë përreth: asnjë i gjallë veç meje. U tmerrova akoma më shumë. Siç dukej Zoti më kish ruajtur për të vuajtur më vonë. I fola vetes me zë të lartë: «Mbahu, Muhamed». Më erdhi çudi që dëgjova zërin tim. Buzë rrugës vura re një burrë e një grua të zhytur në një pellg gjaku; pranë tyre një valixhe lëkure. Thashë se do të kishte për të ngrënë. E hapa dhe mbeta i mahnitur: bizhuteri floriri me gurë të çmuar që s'më kishin parë kurrë sytë veç në filma. M'u duk vetja si në përralla. Mbusha xhepat, duke parë përreth se mos më shihte njeri, por asnjë i gjallë, vetëm kufoma dhe trenat që digjeshin. Nuk e di sa qëndrova aty, ndenjor, për të marrë veten. Nata po afrohej, atëherë, me sforcim të madh mposhta mpirjen dhe u ngrita përsëri në këmbë.

Dallova së largu disa drita të zbehta të një fshati austriak. U nisa në drejtim të tyre, gjithnjë duke kthyer kokën prapa e duke hequr këmbët zvarrë. Mbas disa orësh, ashtu i kapitur, mbërrita në shtëpitë e para të fshatit. Mbasitrokit

disa herë në portën e parë, m'u përgjigj një zë plaku në gjermanisht dhe, pas pak, ai doli me një fener në dorë, më kundroi nga koka te këmbët me vëmendje dhe së fundi më bëri shenjë të hyja brenda. Bëra si më tha, me druajtje, Gruaja e tij, në prag të derës, dukej shumë e shqetësuar. Me shumë me gjeste, me ca fjalë italisht, që ata s'i kuptonin, u përpogë t'iu shpjegoja se isha nga ata që kisha shpëtuar nga bombardimi i tmerrshëm pak më parë. Më kuptuan, se edhe ata e kishin parë dhe dëgjuar bombardimin e stacionit. Në fytyrat e tyre lexova keqardhje.

Përpara se të më përgatitnin banjën, më sollën për të ngrenë gjalpë dhe proshutë të skuqur, po mua, nga lodhja e frika, më qe prerë oreksi dhe hëngra pothuaj fare pak. Pas banjës, fjeta si i vdekur në një shtrat të pastër e të ngrohtë që më përgatitën. Nuk qe e thënë të flija gjatë e të shlodhesha mirë se, rreth orës tre mbas mesit të natës, filluan të fluturonin përsëri skuadrilje bombarduesish. Sidoqoftë isha larg stacionit. Ndeza cigare dhe mendoja për shokët. Ç'u bënë? Shpëtoi ndonjë gjallë? Po unë vetë ku ndodhem? Si do më vejë halli? Ma ngrohni pak zemrën ari dhe byzilykët me gurë xhevahiri të atyre fatkëqinjve, që më mbetën mua. Deri në mëngjes s'më zuri më gjumi.

Të nesërmen e pyeta plakun për Insbrukun. Ai më fliste gjermanisht, më shumë me shenja dhe më dha të kuptoja se ishte larg, shumë larg, në perëndim, prandaj më ftoi të qëndroja atje, pranë tij, gjer në fund të luftës, që, sipas tij ishte çështje javësh. Siç pashë, nga gjendja ekonomike ishte mirë, në stallë kishte pesë lopë alpine. Më tregoi me mall fotografitë e dy djemve, njëri i vvarë në frontin rus, kurse tjetri luftonte në frontin e perëndimit. Propozimi i plakut, i bërë me dashamirësi, më pëlqeu dhe vendosa të qëndroja atje sa të gjente guri vendin, ku mbas disa ditësh në fshat ia behu Ushtria e Kuqe. Ata, me të ardhur, u ranë kambanave dhe me megafon njoftuan që të gjithë burrat e fshatit të mblidheshin në oborrin e kishës. Kush nuk i bindej këtij urdhri, do të pushkatohej në vend. Ky urdhër përsëritej çdo tri minuta. Plaku u shqetësua së tepërmi. Më dha një kostum civil të djalit të tij të vvarë.

U futa në banjë gjoja për t'u veshur dhe, me shumë mundim, në trup, në vatat e kostumit, nën astar, nën jakë e ku munda, fsheha thesarin tim, si të vetmen shpresë që më mbante gjallë në atë botë të largët. U vasha dhe bashkë me plakun u nisëm për te sheshi i kishës. Rrugët e fshatit

qenë plot me ushtarë rusë, që na shihnin dhe i shihnim me armiqësi e frikë. Te sheshi, një major rus rreshtonte e veçonte në vete burrat me moshë nën 50 vjet, ku më futi edhe mua. Ishim gjithsej 8 veta. Të shoqëruar nga një skuadër ushtarësh me automatikë me karikatorë në formë kulaçi zbritëm në rrugën kryesore. Atje na futën në një godinë të braktisur, ku gjetëm civilë dhe ushtarakë të tjerë me uniforma të ndryshme. Ishin dezertorë. Si u bëmë rreth 40 veta, na hipën në një kamion të mbuluar, në fund të të cilit qëndronin katër ushtarë të armatosur. Mbrapa gjithashtu na ndiqte një xhips i hapur, me ushtarë të armatosur me mitraloza të lehtë dhe një qen gjurmues.

Në çdo gjysmë ore kamioni ndalej. Dëgjoheshin zëra në gjermanisht, rusisht, hungarisht, po ne s' shihnim asgjë, se makina që e mbuluar me mushama të trashë; megjithatë kuptohej që makina u çlona sa vinin e shtoheshin. Si dukej grumbullimin dhe nga fshatra të tjera.

Bas shumë orësh udhëtimi u ndalëm. Atëherë vura re se autokolona përbëhej prej rreth 30 kamionësh të mbyllur dhe shumë xhipse me ushtarë të armatosur. Na rreshtuan për dhjetë dhe na hipën në vagonë të mbyllur. Në çdo vagon 100 veta. Na mbyllën me lloz nga jashtë. Ashtu siç ishim, dëgjonim që jepeshin urdhra në rusisht.

Nga mesi i natës treni u nis. Ku venim? Askush s' dinte. Ai ecte pa u ndalur, vetëm ndalonte shpejtësinë në stacionet dhe përsëri vazhdonte me vrull drejt verilindjes. Ecëm kështu rreth 30 orë, pastaj u ndalëm; s' dëgjohej gjë, as zhurma e lokomotivës. Nga dritaret e vagonëve tanë futej një thëllim i ftohtë. Asnjë s' fliste. Sikur të njëqindtë ishim të vdekur e jo të gjallë.

Dyert e vagonëve u hapën me furi dhe disa nënoficerë, me të bërtitura, na urdhëruan të zbritnim shpejt, sa më shpejt, sikur po të vonoheshim një sekondë do të vdisnim. Na rreshtuan përsëri në kolonë nga 10 veta në çdo rresht. Era të priste turinjtë. Ishim të veshur keq dhe ndodheshim në një fushë të shkretë, mbuluar aty-këtu me njëjlla bore. Përkrah hekurudhës që një rrugë automobilistike ku shiheshin autokolona ushtarake që shkonin pa pushim nga lindja në perëndim. Pak më tutje shquhej një tabelë: «RADOM, 30 Km».

«Polonia, Polonia», — i foli një austriak shoku që kishte në krah.

«Tiho», — (pusho) i bërtiti një ushtar rus me sy mongoli, me kërcënim. Në krahun e djathtë dalloheshin një grumbull

kazermash të lyera me njolla maskimi. Territori që i rrethuar me tela me gjemba dhe çdo 50 metra kishte një trupprojë të lartë, me roja me helmata në kokë dhe mitraloza të lehtë.

Ashtu siç qemë, në rreshta për 10, u futëm në oborritin e kampit. Në krye të oborrit ishte një podium me dërrasa. Disa ushtarë sollën ca karrige dhe një tavolinë, ndërsa ne qëndronim në këmbë, para podiumit, me gjunjët që na dridheshin nga uria dhe lodhja.

Nga një kazermë e vogël dolën një grup oficerësh, të cilët u drejtuan nga podiumi. Njëri prej tyre, që kishte spalleta me dy viza dhe tri yje (kolonel), filloi të fliste rusisht, kurse një oficer i ri përktëm në gjermanisht. Unë, që s'dija as rusisht e as gjermanisht, s'kuptoja asgjë, po vetëm dëgjoja zërin kërcënues të kolonelit dhe shihja gishtin e tij tregues që lëvizte me nervozizem.

Në dritaret e kazermave shikoheshin njerëz me koka të qethura, gjë që më la të kuptoja se aty ishte një kamp përqëndrimi. Fjalimi i kolonelit nuk mbajti më shumë se 10 minuta. Atëherë oficerët u afruan te rreshtat tanë. Në çdo grup 100 vetash qëndruan një oficer dhe disa ushtarë të armatosur. U sollën kamionët të mbushur me rroba të vjetra ushtarake. Përpara çdo grupi robëresh u zhgarkuan 100 palë ndërresa, 100 palë gjimnastikorka, 100 palë kapota, po aq këpucë, gaveta me nga një lugë brenda. Oficerët na urdhëruan që të zhvisheshim lakuriq. Ndonjë fatkeq, që hezitonte, i bëheshin turinjte përshesh nga kondakët e automatikëve.

M'u zu fryma, gjithë ç'kisha hequr s'qe gjë hiç. Ç'të bëja me pasurinë time përrallore? Më dukej se kisha mbajtur me vete vdekjen e atyre fatkëqinjve të stacionit të trenit. Me duart që më dridheshin u zhvesha lakuriq, siç më kishte lindur nëna, atje larg, larg, në fund të botës, që i thonë Gjirokastër. Të gjitha teshat tona i morën ushtarët dhe i ngarkuan në kamionë, kurse ne, lakuriq dhe me duart e hapura anash, bëmë disa hapa përpara dhe aty na jepnin teshat e vjetra ushtarake. U veshëm shpejt e shpejt, se vdiqëm së ftohti. Ishim transformuar, sa s'njihnim njëri-tjetrin dhe as vetveien. Unë mbeta si i shokur: fluturuan byzylykët me gurë të çmuar, e vetmja shpresë që ma ngrohte zemrën. Flisja me vete: «Mbahu Muhamet! Mbahu! Ato mund të të kishin sjellë dhe vdekjen».

Na futën nëpër kazerma nga 500 veta në secilën. Në dysheme kishin hedhur kashtë; vinte një erë e keqe si në

stallat e derrave. Në kohën e drekës na nxorën jashtë. Disa robër, me përparëse të bardha, na sollën kazanët e gjellës. Supë patatesh. Ë hëngru me një frymë, s'priste luga lugën. Supa ishte e ngrohtë dhe lëshonte avull. Të dukej sikur haje mish qengji të pjekur mbas dy ditësh pa ngrënë dhe një udhëtimi prej disa qindra kilometrash në vagonë kuajsh. Ajo supë patatesh më shpëtoi jetën dhe s'do ta harroj sa të jem gjallë.

Mbas dy ditësh, një tren me vagonë të mbyllur u ndal para kampit. Nga kazermat e tjera nxorën rreth 2000 robër. I rreshtuan si gjithmonë, për dhjetë, dhe i hipën në tren. Në çdo vagon nga 100 veta; këto rregulla nuk i shkelnin asnjëherë rusët. Operacioni mbaroi për 30 minuta dhe treni u nis me përtaci drejt lindjes, nën vështrimin tonë të zgurdulluar nga dritaret e barakave. Në mbrëmje erdhën trena të mbushur me robër nga perëndimi dhe u ndoq i njëjti operacion si me ne. Kuptuam se ky qe një kamp tranzit, për në stepat e Siberisë.

Mbasdite u ndal përsëri një tren para kampit; këtë herë radhën e kishim ne. Para se të hipnim nëpër vagonë na dhanë nga një kilogram patate të ziera. I futa në gji e në xhepat e kapotës. Treni u nis drejt Lindjes, drejt së pan'ohurës, drejt ferrit. Nëse para disa javësh pasuria ime përallore ishte jeta dhe vdekja ime, tani në tren ata gurë xhevahiri u shndërruan në patate. Në çdo 10-12 orë udhëtimi, treni ndalej në stacione të vogla të rrethhuara me ushtarë të armatosur. Na zbritnin me radhë për të kryer nevojat personale dhe na jepnin nga një kilogram patate të ziera. Udhëtimi vazhdoi me ditë të tëra, mbasi trenat ecnin ngadalë e si me frikë dhe vonoheshin shumë në stacionet kryesore. Nuk e di tamam sa ditë udhëtuam kështu. Kishim humbur nocionin e kohës.

Më së fundi treni u ndal dhe lokomotiva u shua. Dëgjoheshin zëra që shqiptonin shpesh fjalën «Bereznova». Na zbritën nga vagonët.

Duhej të ishte fundi i muajit prill 1945. S'ishim më 100, sa kishim hipur, por 98: dy fatkëqinj kishin vdekur rrugës. I kapën nga këmbët dhe i hoqën zvarrë, i grumbulluan në një vend; ishin më shumë se 20 kufoma. Ç'do të bëhej me to? Një nënoficer i spërkati me benzinë dhe i vuri flakën. Ne na hipën në makina të hapëta dhe na nisën nëpër një rrugë automobilistike nëpër stepë. Rreth e qark stepë e mbuluar me një shtresë të hollë bore. Udhëtuam gati një orë. Së largu

dallonim kampin. Ishte në rrëzë të një kodre. Kishte dhjetë baraka dhe dy godina të vogla. Ishte rrethuar me tela me gjemba, në katër qoshet kishte kulla me mitraloza dhe projektore. Porta e kampit ishte me dy kanata me pllaka hekuri lyer me bojë të zezë. Sipër saj, në një tabelë, ishte shkruar diçka rusisht, pastaj nr. 307, Bereznova. Në portë qëndronin dy ushtarë të armatosur dhe një oficer me pistoletë e një shirit të kuq në dorë.

U futëm brenda oborrit, ku na ndanë nga 200 veta për çdo barakë. Në to kishte shtretër të përbashkët prej dërrase, të mbuluar me kashtë. Në mes kishte një fuçi të madhe, si sobë, me qymyr guri. Na dhanë nga dy batanije të vjetra. Mbas pak na rreshtuan para barakave dhe na sollën kazanët e gjellës. Supë patatesh dhe nga një rriskë bukë thekre. Në dridheshim nga të ftohtët. Dëgjoheshin vetëm bisedat e ushtarëve dhe gajasjet e oficerëve. Mbas pesë ditësh na pajisën me nga një lopatë dhe na nxorën në punë. Na rreshtuan për dy dhe, pasi na numëruan te porta e kampit, na nisën për punë. Mbas rreth 800 metra rruge, u gjetëm në një shesh të mbushur me qymyr guri, që sillej këtu me makina vetëshkarkuese. Siç dukej, aty afër ndodhej ndonjë minierë qymyrguri. Detyra jonë ishte ta ngarkonim këtë qymyr në vagonët e një dekovili, që vazhdonte nëpër stepë. Afër mbrëmjes ne ktheheshim në kamp. Përsëri numërim dhe kontroll te porta, përsëri supë patatesh dhe bukë thekre. Kur venim në mëngjes në punë, gjenim përgjet e larta të qymyrit, të cilin pa dyshim e nxirrnin fatkëqinjtë si ne, që punonin me turne.

Ushtarët e armatosur, së bashku me qentë, qëndronin disa dhjetëra metra larg nesh, kurse nënoficerët pa armë qëndronin midis nesh dhe na nxitnin me sharje dhe kamxhikë në duar, për t'i mbushur sa më shpejt vagonët. Ndonjërin, që i binte të fikët nga lodhja, nënoficerët urdhëronin që ta çonin prapa barakave, ku linim lopatat dhe, nëse nuk çohet gjer në momentin e kthimit në kamp, i hidhnin një kovë me benzinë dhe e digjin. Skeletet i groposnin në një gropë të përbashkët, që ishte hapur po aty. Ata që vdisnin në kamp, i varrosnin po me këtë ceremoni, jashtë rrethimit, në krahun e djathtë të kampit.

Iku vjeshta e shkurtër siberiane dhe shpejt erdhi dimri i tmerrshëm rus. Nuk dija në ç'ditë ndodhesha, bile as çfarë muaj ishte. Vetëm stinët dalloheshin, po të reduktuara në verë-dimër. Kisha frikë se do të humbisja të folurën, shqipen. Në kamp këndoja me zë të ulët këngë labe; në punë

flisja me vete po me zë të ulët. Nënoficerët rusë më shihnin me përçmim dhe me siguri mendonin se do të isha i çmëndur, por jo i rrezikshëm. Punoja me gjithë forcat. Një ditë, një oficer, duke më vërejtur gjatë punës, më tha me zë të qetë «harasho, harasho». (mirë, mirë) dhe u largua duke buzëqeshur. Sigurisht nënoficerët i kishin thënë për mua se isha i luajtur nga mendja.

Dimri ishte i papërshkruar. Temperatura jashtë ishte më e ulët se -40°C . Brenda në barakë s'ishte kurrë më e lartë se -5°C . megjithëse ndizej soba. Të vetmet tesha që na dhanë për dimër ishin një kokore e vjetër dhe një palë dorashka, megjithatë, fytyra, veshët dhe duart, na kishin zënë dregëza nga të ftohtët. S'kish ditë të mos vdisnin nga 2-3 veta. Në darkë na jepnin çaj të ngrohtë me shumë pak sheqer. Nga godinat e oficerëve dëgjoheshin këngë ruse dhe ne nuhatnim erën e mishit të zier. Ata pinin vodkë dhe luanin me letra. Kur kish tufan dhe mjegull nuk na nxirrnin në punë.

Erdhi vera tjetër, por robërit ishin përgjysmuar. Kishim një vit në kamp dhe askush nuk na kish pyetur as për emrin. Së paku gjermanët në kampet e tyre u vendosnin robërve numrin në gjoks dhe në shpinë. Këta rusë të egër, as për emër s'të pyesnin e as numër s'të vendosnin. Barinj të tanë në një kategori më të ulët se kafshët. Ne ishim përgjysmuar dhe galeritë nga galeritë ishin përgjysmuar. Siç dukej, të njëjtin fat do të kishin pësuar dhe robërit që punonin nën dhe.

Filloi bora e parë e dimrit të dytë 46-47. Fuqitë dhe shpresat, për të dalë gjallë nga ky kamp siberian, venitëshin çdo ditë. Për habinë tonë, dimri i dytë nuk na u duk aq i tmerrshëm sa i pari. Ndoshta ishte më i butë. Apo u mësua me të ftohtët rus? Përditë na vizitonë kosa e vdekjes. Me ardhjen e pranverës nuk kishim mbetur më shumë se 500 veta nga 2000 që ishim në fillim. Oh, toka ruse! Sa e etur paske qenë për kufoma njerëzish të pajtshëm!

Një ditë maji, megjithëse koha ishte e bukur dhe pa mjegull, nuk na nxorën në punë. Na vunë të pastronim oborrin dhe territorin e kampit. Oficerët dhe ushtarët ishin në lëvizje. Kuptohej se do të ndodhte diçka. Dhe ja... papritur, te porta e kampit u dukën dy xhipsa me oficerë madhorë. Komandanti i kampit dhe oficerët, të rreshtuar në krahët e tij, i pritën me qëndrim gatitu. Të gjithë së bashku u drejtuan nga zyrat e komandës. Pastaj ra çanga dhe ne u rreshtuam në një kolonë për katër në oborrin e kampit. Nga ko-

manda nxorëm dy tavolina të gjata dhe disa karrige. Një kolonel i shëndoshë qëndronte në mes oficerëve të tjerë. Pa dyshim ai qe kryetari i ekipit. Një oficer i ri hapi çantën dhe nxori andej një grumbull formularësh në dy gjuhë, rusisht dhe gjermanisht. Komandanti i kampit urdhëronte nënoficerët dhe këta i shoqëronin robërit para komisionit. Mbas dy vjetësh, për herë të parë na pyetën se ç'emër kishim dhe ç'kombësie i përkisnim. Kur më erdhi radha mua, u afrova me druajtje para komisionit. Nënoficeri që më shoqëronte diçka i tha komandantit për mua. Fjalën «durak» (budalla) ma zuri veshi, se e shqiptoi me një theks të veçantë. Koloneli më pyeti gjermanisht. Unë iu përgjigja: Nix fishtejn, albanez, i thashë, «Muhamet Hoxha». Të gjithë oficerët shfaqën njëfarë kureshtje: «Albanisht», më tha oficeri i ri, «Tiraña»? «Nix, — u përgjigja unë, Gjirokastra», — dhe në një copë letër shkrova ditëlindjen 1915.

«Enver Hoxha», — shtoi koloneli dhe vazhdoi të fliste gjermanisht. Kuptohej se ai më pyeste se mos kisha të bëja diçka me Enver Hoxhën dhe unë, duke shqiptuar fjalën «Ja, ja» (po, po) lidha dy gishtat tregues të duarve, për t'i dhënë të kuptonte se e kisha timin. Ata filluan të flisnin rusisht me njëri-tjetrin; formularin tim e vendosën veçan nga formularët e robërve të tjerë.

Mbas një javë më morën me një nënoficer dhe një ushtar të armatosur dhe më çuan në Bereznovna, në një repart ushtarak special, që merrej me robërit e luftës. Aty më futën në një qeli ku gjeta dhe dy kroatë. Për fatin tim, njëri prej tyre dinte dhe pak shqip, mbasi kishte qenë mësues në Kosoovë. Ai zotëronte shumë gjuhë të huaja dhe rusishten e dinte si rus. Mbas pesë ditë qëndrimi në Bereznovno, të shoqëruar me dy ushtarë dhe një nënoficer, na hipën në një vagon treni. Askush nuk na tha se ku do të shkonim. Në vagon, disa muzhikë dhe ushtarakë na shikonin me habi dhe keqardhje; një plakë ruse me shami në kokë bëri kryq dhe diçka tha nëpër dhëmbë. Sigurisht lutej për ne. Një muzhik me mjekër, na u afrua për të na dhuruar nga një cigare me duhan mahorka, po nënoficeri nuk e lejoi që të na i jepte. Kështu, të shoqëruar, udhëtuam për disa ditë, duke ndërruar mjaft trena. Në disa stacione, nënoficeri furnizohej me bukë dhe konserva për ne dhe ushtarët. Më së fundi mbërritëm në destinacion.

Kampi i robërve ishte afër qytetit Voronezh. Ndodhëj në mes të një sofkozi (ferme). ku disa stalla derrash i kishin adaptuar për kapanone robërisht. I njëjti rrethim si në kampin

e Bereznovës. Te porta e kampit shkruhej: Voronezh 162.

Në kamp kishte vetëm ballkanas, me përjashtim të rumunëve, gjithsej 1500 veta. Shumicën e përbënin kroatët, sllovenët dhe bullgarët, po kishte edhe grekë dhe disa kosovarë. Këtu trajtimi qe diçka më i mirë se në Bereznova. Përveç patateve na jepnin edhe njëfarë bollguri, ku shiheshin edhe disa pika yndyrë salioje. Në punë nuk na nxirrnin, se ky ishte një kamp tranzit. Morëm vesh se së shpejti, do të na nisnin për në Jugosllavi dhe prej andej do të riatdhesoheshim.

Fillova të shihja përsëri në gjumë deklaratën, e ëndërrroja çdo natë dhe ditën mendoja me tmerr ç'do të pësoja në Shqipëri. Ik nga shiu e bjer në breshër; po përsëri i jepja vetes kurajë, duke thënë me vete «le të shpëtoj një herë nga stepat e Rosisë, pa kijameti le të bëhet». Një muaj pasi kishim ardhur në kampin e Voronezhit na dhanë rroba e ndërrresa të reja. Na ndanë sapun dhe filluam të bënim banjë. Trupat tanë kishin zënë një shtresë të trashë pislleku dhe s'qe punë që të hiqej menjëherë; duheshin bërë disa banja radhazi. Kur u lava për herë të parë, mbas dy vjetësh, m'u duk vetja si një thes lëkure me një grusht kocka. U çudita se si kisha fuqi të qëndroja në këmbë. Edhe nëna të më shkonte atëherë, s'kish për të më njohtë.

Një ditë na rreshtuan në oborrin e kampit dhe, pasi na furnizuan me patate të ziera, ca galeta të mykura dhe nga një konservë mish kali për secilin, na nisën më këmbë, të rreshtuar, për te stacioni i trenit, që ishte nja dy kilometra larg kampit. Stacioni ishte i rrethuar me ushtarë të armatosur dhe ne na hipën nga 100 veta në çdo vagon. Këta ishin me ndenjësë dhe ne për herë të parë po udhëtonim me trenat rus si njerëz. Treni u nis drejt jugperëndimit. Nga dritaret e tij shihnim stepën, fshatrë e qytete në ndërtim e sipër. Në çdo 10 orë udhëtim na linin të zbritnim për te kryer nevojat personale. Në një zbritje të tillë unë u vonova. Treni u nis dhe mbeta i vetëm në mes të stepës. Po afrohej nata dhe asgjë s'pipëtinte rreth e qark. Fillova të ecja kuturu nëpër trase, në drejtim të lëvizjes së trenit. Nuk bëra as 300 metra rrugë, kur dallova një urë të madhe hekuri dhe poshtë saj një lumë i gjerë si det, që rridhte qetë-qetë. Pa u afruar mirë tek ura, një thirrje «stoj», (ndal) më bëri të ngrija në vend. Qëndrova ku isha, me duart të ngritura lart dhe pa bërë asnjë lëvizje. Roja, me automatik drejtuar nga unë, seç foli rusisht dhe nga një barakë aty afër dolën dy nënoficerë me

nga një elektrik dore dhe pistoleta në duar. M'u afruan dhe, mbasi njëri prej tyre kontrolloi për armë, më çuan në kazermën që shërbente si postëbllok në cep të urës. Ata flisnin dhe unë s'kuptoja asgjë ç'më thoshin. Me shenja e lëvizje duarsh mundohesha t'u shpjegëja se isha rob luftime dhe se më kish lënë ai treni që kish kaluar para disa çastesh. Nga gjetet e mia disa ushtarë filluan të qeshnin, po nënoficerët e kuptuan si ishte e vërteta dhe, mbasi folën në telefon kushe-di se me kë, më dhanë të kuptoja se të nesërmen do të më nisnin me një tren tjetër. Kështu, në orën 5 të mëngjesit të ditës tjetër, një nënoficer më shoqëroi te stacioni. S'vonoi shumë dhe u dëgjua sirena e një treni, që u ndal sakaq në stacion, nga ku filluan të zbrinin robër, për të kryer edhe ata, si unë një ditë më parë, nevojat personale. Nënoficeri që më shoqëronte bisedoi diçka me komandantin e trenit dhe ky i fundit më bëri me shenjë për të hipur. Sapo hipa në vagonin më të afërt, një nga robërit u rorrit në këmbë dhe m'u drejtua «sei tedesko?» «No, — iu përgjigja unë, — sono albaneze». «Albaneze?» — tha i habitur sikur të isha marsian, dhe me zë të çuditshëm bërtiti: «Dio mio, poveraçio», —

(O Zoti im, i mjeri) dhe menjëherë rreth meje u mbloodhën një grumbull robërish italian. Ata më mbytën me pyetje dhe u afruan me mua sikur të më kishin njohur prej kohësh. Komandanti i qindëshes kishte qenë toger dhe ishte kalabrez nga Kozenca. E kishin zënë rob afër Stalingradit dhe kishte katër vjet në një kamp në Siberi. Nga 5000 robër italianë në atë kamp, vetëm 1000 syresh kishin mundur ta shpëtonin lëkurën. Tani po riatdhesoheshin. Në çast më lindi ideja për të shkuar së bashku me ta në Itali; kështu shpëtoja dhe nga burgu ose pushkatimi që më priste në Shqipëri për punën e asaj deklaratë. Ia qava hallin togerit tim, i cili më dëgjoi me vëmendje. Kur mbarova, më tha: «Dëgjo, i dashur, çdo qindëshe robërish ka një kapo, një ish-oficer. Ata janë pajisur me listën e robërve që kanë në ngarkim. Në qindëshen time më mungojnë dy veta; ata kanë ngelur rrugëve, si puna jote, dhe nëse ata nuk më arrijnë gjer në destinacionin e fundit në tokën ruse, atëherë do të mbash emrin e njërit syresh dhe do të vemi së bashku në Italinë e dashur». Më këshilloi të mos mërzitesha, se Zoti është i madh dhe mendon edhe për ne. Qëndroja si gjeli mbi gjemba dhe mendja më punonte gjithnjë në do mund t'ia hidhja së keqes edhe kësaj radhe.

Mbas dy ditë udhëtimi mbërritëm në një kamp pranë

Odesës. Kampi që i pastër dhe kapanonat ishin të lyera me gëlqere. Aty qëndruam 3 ditë, na vizituan mjekët dhe na dhanë groshë në vend të patateve.

Në një prej këtyre ditëve na vizituan disa ish-udhëheqës komunistë italianë, që ishin strehuar në Rusi, që në kohën e fashizmit. Ata qenë veshur shik dhe fytyrat u ndritnin si pasqyra. Na thanë se rusët kishin hequr bukën e gojës për të na mbajtur ne, robërit e luftës, dhe, kur të ktheheshim në Itali, të mos bënim propagandë kundër Bashkimit Sovjetik. Nga ata morëm vesh se të nesërmen do të niseshim me tren për në Itali, duke ndjekur itinerarin Odesë-Jash-Debreçen-Grac-Udine. Ndonëse të rraskapitur, gjumi nuk na zuri nga gëzimi dhe mendimet. Togeri kalabrez më tha se unë do të mbaja emrin Xhiovani Farrelli.

Të nesërmen në mëngjes na shpunë në stacionin e trenit, na hipën në vagonë, gjithmonë me qindëshe, dhe u nisëm drejt kufirit rumun, ku na priste një delegacion i Kryqit të Kuq Botëror. Aty u bë apeli sipas listave. Kur dëgjova emrin Xhiovani Farrelli, m'u drodh lëkura e trupit dhe buza e mezi thashë: «prezente». Kur na morën në dorëzim thashë se linda për së dyti. Isha mysliman, me emrin Muhamed, dhe u bëra kaur, me emrin Xhiovani. Ndërruam tren dhe u nisëm drejt Jashit, ku na dhanë nga një pako me bukë të bardhë, djathë kaçkavall dhe marmelatë. Treni, duke shtuar shpejtësinë, na shpinte drejt Karpateve. Ajri i pastër i pishave na i zgjeroi mushkëritë e mbushura me pluhurin e qymyrit siberian. Në mbrëmje u futëm në tokën hungareze. Në stacionin e Debreçenit, disa të rinj iu afruan vagonëve dhe njëri prej tyre brohoriti «Viva Italia». Policët hungarezë që ndodheshin aty, u ranë bilbilave dhe ata u larguan qetë-qetë në terrin e natës. Udhëtuam gjithë natën; dremitnim dhe zgjoheshim të frikësuar nga sirenat e lokomotivave në stacionet ndërmjetëse. Në agim kaluam kufirin hungarez dhe u futëm në tokën austriake.

Në qytetin e Gracit na prisnin përfaqësues të Kryqit të Kuq Italian; mbas një ore ndalesë u nisëm për në Itali. Në Grac na dhanë sallam, bukë dhe nga një shishe me lëng portokalli. Barku ynë i uritur i thithte këto ushqime si një tokë e zhuritur që në mes të korrikut thith një vesë shiu. Në orën 14 të datës 26 gusht 1947 treni u fut në tokën italiane. Të gjithë robërit u ngritën në këmbë dhe iu vërsulën dritareve. Nga sytë e tyre kullonin lotë gëzimi. Qeshnin, qanin, bërtitnin si të çmendur «Viva Italia, Kara Italia», kurse

unë qëndroja i heshtur, si peshku, dhe i hutuar, si budalla. Mendime të ndryshme më vinin në njëri pas tjetrit: «Ku të shkoj? Kush më pret? Ç'bëjnë prindët e mi në Shqipëri? Ku janë shokët e mi? Kush është i gjallë e kush ka vdekur? Si do ta kem hallin tani e tutje? Dhe në fund i jep a kurajë vetes me emrin tim të vjetër e të shenjtë: «Mbahu, Muhamed, si është e shkruar, do të bëhet».

Treni po i afrohej Udinës. Robërit e vagonit të parë kishin sajuar dosido një parullë të madhe, ku shkrey Robër të kthyer nga ferri rus! Stacioni i Udinës ishte i rrethuar nga karabineria dhe policia. Me mijëra qytetarë, të ardhur nga të katër anët e Italisë, prisnin gjithë ankth ata që kishin shpëtuar gjallë nga shkretëtira e bardhë e Siberisë. Për katër vjet rresht familjet italiane, që kishin bijtë e tyre në armatën me në krye gjeneral Pressin në frontin rus, nuk kishin njoftim se kush qe gjallë e kush kish lënë kockat në stepat ruse. Në janar-shkurt të 1943 kjo armatë qe shpartalluar, të paktë qenë ata që shpëtuan gjallë, se shumica qenë vrarë ose kishin rënë robër. Vetë gjeneral Pessi, kishte bërë vetëvrasje, kurse Italia shpalli dy ditë zi kombëtare. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme të qeverisë italiane, Stalini refuzonte të jepte të dhëna të sakta për robërit italianë në Rusi. Mbas shumë ndërhyrjesh dhe presionesh, nga të katër anët e botës, më së fundi Stalini çedoi dhe urdhëroi riatdhësimin e robërve italianë, duke filluar nga muaji gusht 1947.

Në peronin e stacionit ishin vendosur me dhjetëra aparate telegrafike mbi tavolina, që robërit e riatdhesuar të lajmëronin familjet e tyre. Ishte ngritur një spital fushor, ku një ekip i madh mjekësh dhe infermierësh na vaksinuan dhe u jepnin ndihmë mjekësore robërve të sëmurë. Populli, i mbledhur pranë stacionit, me zor të madh ndalohej nga kordoni i policisë. Dëgjoheshin me qindra pyetje, me britma të forta. «A ka njëri nga Torino, nga Forlì, nga Rimini?, nga Bari, nga Katanzano. Leçe etj.? Përmendeshin emra divizionesh, regjimentesh, fshatrash, skuadrilësh, etj. etj. Aparatet telegrafike punonin pa pushim dhe me alfabetin mors lajmërimin në të katër anët e Italisë se u kthyen nga Rusia ata që kishin vjete që ishin qenë si të vdekur për familjet e tyre. Pak më larg aparateve mors, tavolina të mbushura me lloj-lloj ushqimesh: pula të pjekura, peshq të fërguar, sallam, torta, lëng frutash, cigare e deri te çokollatat. Altoparlantët bënin thirrje të vazhdueshme, për të

Odesës. Kampi që i pastër dhe kapanonat ishin të lyera me gëlqere. Aty qëndruam 3 ditë, na vizituan mjekët dhe na dhënë groshë në vend të patateve.

Në një prej këtyre ditëve na vizituan disa ish-udhëheqës komunistë italianë, që ishin strehuar në Rusi, që në kohën e fashizmit. Ata genë veshur shik dhe fytyrat u ndritnin si pasqyra. Na thanë se rusët kishin hequr bukën e gojës për të na mbajtur në robërit e luftës, dhe, kur të ktheheshim në Itali, të mos bënim propagandë kundër Bashkimit Sovjetik. Nga ata morëm vesh se të nesërmen do të niseshim me tren për në Itali, duke ndjekur itinerarin Odesë-Jash-Debreçen-Grac-Udine. Ndonëse të rraskapitur, gëjumi nuk na zuri nga gëzimi dhe mendimet. Togeri kalabrez më tha se unë do të mbaja emrin Xhiovani Farrelli.

Të nesërmen në mëngjes na shpënë në stacionin e trenit, na hipën në vagonë, gjithmonë me qindëshe, dhe u nisëm drejt kufirit rumun, ku na priste një delegacion i Kryqit të Kuq Botëror. Aty u bë apeli sipas listave. Kur dëgjova emrin Xhiovani Farrelli, m'u drodh lëkura e trupit dhe buza e mezi thashë: «prezente». Kur na morën në dorëzim thashë se linda për së dyti. Isha mysliman, me emrin Muhamed, dhe u bëra kaur, me emrin Xhiovani. Ndërruam tren dhe u nisëm drejt Jashit, ku na dhanë nga një pako me bukë të bardhë, djathë kaçkavall dhe marmelatë. Treni, duke shtuar shpejtësinë, na shpinte drejt Karpateve. Ajri i pastër i pishave na i zgjeroi mushkëritë e mbushura me pluhurin e qymyrit siberian. Në mbrëmje u futëm në tokën hungareze. Në stacionin e Debreçenit, disa të rinj iu afruan vagonëve dhe njëri prej tyre brohoriti «Viva Italia». Policët hungarezë që ndodheshin aty, u ranë bilbilave dhe ata u larguan qetë-qetë në terrin e natës. Udhëtuam gjithë natën; dremitnim dhe zgjoheshim të frikësuar nga sirenat e lokomotivave në stacionet ndërmjetëse. Në agim kaluam kufirin hungarez dhe u futëm në tokën austriake.

Në qytetin e Gracit na prisnin përfaqësues të Kryqit të Kuq Italian; mbas një ore ndalesë u nisëm për në Itali. Në Grac na dhanë sallam, bukë dhe nga një shishe me lëng portokalli. Barku ynë i uritur i thithte këto ushqime si një tokë e zhuritur që në mes të korrikut thith një vesë shiu. Në orën 14 të datës 26 gusht 1947 treni u fut në tokën italiane. Të gjithë robërit u ngritën në këmbë dhe iu vërsulën dritareve. Nga sytë e tyre kullonin lotë gëzimi. Qeshnin, qanin, bërtitnin si të çmendur «Viva Italia, Kara Italia», kurse

unë qëndroja i heshtur, si peshku, dhe i hutuar, si budalla. Mendime të ndryshme më vinin në mënyrë pas tjetrit: «Ku të shkoj? Kush më pret? Ç'bëjnë prindët e mi në Shqipëri? Ku janë shokët e mi? Kush është i gjallë e kush ka vdekur? Si do ta kem hallin tani e tutje? Dhe në fund i jepa kurajë vetes me emrin tim të vjetër e të shenjtë: «Mbahu, Muhamed, si është e shkruar, do të bëhet».

Treni po i afrohej Udinës. Robërit e vagonit të parë kishin sajuar dosido një parullë të madhe, ku shkrej Robër të kthyer nga ferri rus! Stacioni i Udinës ishte i rrethuar nga karabineria dhe policia. Me mijëra qytetarë, të ardhur nga të katër anët e Italisë, prisnin gjithë ankth ata që kishin shpëtuar gjallë nga shkretëtira e bardhë e Siberisë. Për katër vjet rresht familjet italiane, që kishin bijtë e tyre në armatën me në krye gjeneral Pressin në frontin rus, nuk kishin njoftim se kush që gjallë e kush kish lënë kockat në stepat ruse. Në janar-shkurt të 1943 kjo armatë që shpartalluar, të paktë qenë ata që shpëtuan gjallë, se shumica qenë vrarë ose kishin rënë robër. Vetë gjeneral Pessi, kishte bërë vetëvrasje, kurse Italia shpalli dy ditë zi kombëtare. Me gjithë kërkesat e vazhdueshme të qeverisë italiane, Stalini refuzonte të jepte të dhëna të sakta për robërit italianë në Rusi. Mbas shumë ndërhyrjesh dhe presionesh, nga të katër anët e botës, më së fundi Stalini çedoi dhe urdhëroi riatdhesimin e robërve italianë, duke filluar nga muaji gusht 1947.

Në peronin e stacionit ishin vendosur me dhjetëra aparate telegrafike mbi tavolina, që robërit e riatdhesuar të lajmëronin familjet e tyre. Ishte ngritur një spital fushor, ku një ekip i madh mjekësh dhe infermierësh na vaksinuan dhe u jepnin ndihmë mjekësore robërve të sëmurë. Populli, i mbledhur pranë stacionit, me zor të madh ndalohej nga kordonit i policisë. Dëgjoheshin me qindra pyetje, me britma të forta. «A ka njëri nga Torino, nga Forli, nga Rimini?, nga Bari, nga Katanzano. Leçe etj.? Përmendeshin emra divizionesh, regjimentesh, fshatrash, skuadrilesh, etj. etj. Aparatet telegrafike punonin pa pushim dhe me alfabetin mors lajmërimin në të katër anët e Italisë se u kthyen nga Rusia ata që kishin vjete që ishin qenë si të vdekur për familjet e tyre. Pak më larg aparateve mors, tavolina të mbushura me lloj-lloj ushqimesh: pula të pjekura, peshq të fërguad, sallam, torta, lëng frutash, cigare e deri të çokollatat. Altoparlantët bënin thirrje të vazhdueshme, për të

mbajtur rregullin, për të mos ngrënë me tepricë, për të bërë vaksinat dhe për paret që u shpërndaheshin robërve për shpenzime udhëtimi. Ishte një panair i vërtetë: me dhjetëra gazetarë, kineastë, fotoreporterë, priftërinj, murgësja, që venin e vinin midis robërve. Unë në jetën time s'kisha parë zallahi të tillë. Mbusha plëncin me ç'më deshi e bardha zemër dhe u ula në një stol duke thithur një cigare «Kamel». Pamja ime e trishtuar që ndryshonte nga pamja e gëzuar e robërve italianë, tërhoqi vëmendjen e një prifti të shkuar nga mosha. M'u afua me shumë mirësi dhe më pyeti me zë engjëllor: «Po ti, biri im, përse nuk telegrafon?»

«Padre, — i thashë, — unë s'kam familje, jam shqiptar».

«Shqiptar? Ah, sa gjynah, po mos u mërzit. Zoti është i madh». — Ai më mori me vete dhe më shupri në kuvendin e tij, në periferi të Udinës. Mbasi bëra banjë, më veshi me rroba të reja nga koka në këmbë. Atë natë fjeta në kuvend dhe biseduam gjatë me padren për ç'kisha vuajtur gjatë viteve të robërisë. Të nesërmen prifti më shoqëri në komandën e karabinierisë së Udinës. Një oficer më mbushi disa formularë identiteti, që kur shërbeja në armën e karabinierisë në Shqipëri, kapjen rob nga rusët, kampin ku kisha vuajtur dënimin e të tjera formalitete. Më dhanë një paradhënie dhe më premtuan se mbas disa ditësh, si të bëhej verifikimi i dokumenteve, do të merrja një shumë të mirë, për kohën e vuajtjes në kampet ruse. Qëndrova 20 ditë në Udinë, dhe, pasi më dhanë paratë, u nisa për në Barleta, ku genë të grumbulluar shumica e të arratisurve nga Shqipëria. Si fjeta një natë në Romë, të nesërmen mbërrita në Barleta. Këtu takova mjaft të njohur nga ata që kisha bashkë në xhandarmëri, nga ata që kisha bërë rrugën e kalvarit nëpër Jugosllavi, nga ballistët e Gjirokastrës etj. që kishin ikur nga frika e komunizmit. Më mbytën me pyetje dhe nuk besonin që unë të isha kthyer nga Rusia. Morali i tyre ishte përtokë. Pakënaqësia ndaj krerëve që banonin në Romë, në hotele luksoze, ua shtonte mërzitjen e jetës së kazermës e gjellës së kazanit. Humbja e shpresës për një kthim të shpejtë në Shqipëri, gjendja jo e mirë ekonomike dhe grindjet e vazhdueshme, genë bërë shkak që disa nga këta refugjatë të merrreshin me punëra jo të pastra. Duke dashur të ndihmoja disa nga shokët e mi, që ishin në gjendje të keqe ekonomike, me paret që mora si dëmshpërblim për robërinë në Rusi, sajova një punishte të vogël klandestine, ku prodhohim cigare me etiketë shqiptare: «Diamant», «Nuse», «Tarabosh»,

etj. Duhanin e blinim nëpër katundet e afërta dhe paqetat i shisnim kontrabandë, kështu që fitonim mjaft të holla. Po kjo punë nuk zgjati shumë se na kapën. Punishten ë konfiskuan dhe mua, së bashku me dy shokë, më arrestuan dhe na çuan në një kamp të rrethuar me tela me gjemba në afërsi të Romës. Në kamp ishin disa mijëra, shumica rusë, polakë, çekë, sllovakë, jugosllavë, kaukazas, armenë, si dhe disa shqiptarë. Një pjesë ishin zënë me «presh në duar», si puna ime, një pjesë tjetër dyshohej se ishin agjentë të dërguar nga vendet e Evropës Lindore dhe një pjesë kishin shpëtuar nga kampet naziste, por të pidentifikuar plotësisht. Me një fjalë, të dyshimtë.

Komandanti i kampit ishte një major anglez, sa i rreptet, aq edhe korrekt. Ushqimi ishte i mjaftueshëm dhe mjetet për të kaluar kohën nuk mungonin. Kampi ishte i pajisur me kinema, salla bilardoje, ping-pong, shah, bibliotekë etj. Ky quhej «kamp seleksionimi». Një pjesë riatdhesoeshin, një pjesë dënoheshin me burg dhe një pjesë tjetër i nisnin në destinacione të panjohura.

Një ditë në kamp na erdhën disa nga krerët e emigracionit dhe pikërisht Abaz Kupi, Vasil Andoni dhe Ernest Koliqi. Ata ishin të shoqëruar nga disa civilë amerikanë. Shkuan në komandën e kampit dhe, mbas një ore, qendra e zërit lajmëroi që gjithë shqiptarët të grumbullohen në komandë. Ishim rreth 30 veta. Vasil Andoni e mori fjalën, duke na treguar përçapjet e tyre pranë Komandës Aleate dhe autoriteteve italiane për lirin tonë nga ky kamp, që konsiderohej gjysmëburg. Disave si puna ime na premtoi lirim të shpejtë, kurse Ahmet Xhaferit me shokë u tha se autoritetet italiane dyshonin se ata, meqë kanë qënë me Sadik Prenten, mos janë dërguar për diversion nga komunistët e Tiranës. Megjithatë, na premtuan se do t'i vazhdonin përpjekjet deri në lirin e të gjithëve.

Abaz Kupi personalisht më përgëzoi që kisha shpëtuar gjallë nga Rusia dhe më uroi të shiheshim së shpejti, mbasi më njihte që kur kisha shërbyer në Krujë.

Nuk kaluan as dy javë dhe shumica e shqiptarëve u lijuan. Na çuan në Kazerta, pranë Napolit, mbasi kampi i Barletës ishte prishur. Vitin e Ri 1948 e kaluam duke pirë dhe duke luajtur bixhoz gjithë natën. Disa emigrantë nga ata të Barletës kishin mundur të shkonin në Amerikë, mbasi të afërmit e tyre atje u ishin bërë garant, kurse ne të tjerët vazhdonim të qëndronim si peshku në zallë.

Kohët e fundit kampin tonë e vizitonin shpesh delegacione nga vende arabe, që kërkonin të rekrutonin ushtarakë të karrierës. Siria na paguante një shumë të madhe si paradhënie dhe do na njihte një gradë më tepër, nga ajo që kishim pasur në kohën e luftës. Feja dhe sidomos: paraja, u bënë shkak që shkuan në Damask 80 oficerë dhe nënoficerë me në krye kolonel Neshet Kolonjen, të cilin menjëherë i dhanë gradën e gjeneralit. Disa të tjerë u nisën në Egjipt dhe Turqi. Delegacionet e huaja, të identifikuar ose jo, që vizitonin kampin, vinin duke u shtuar. Kjo ishte në raport të drejtë me luftën e ftohtë. Disa prej tyre, kur largoheshin, na hidhnin dhe nga një kockë për të lëpirë. Ishte evidente se me intensifikimin e luftës së ftohtë kundër vendeve komuniste ne, mbeturinat e Luftës së Dytë Botërore, bëheshim më joshës për shumë qarqe të Perëndimit.

U shtuan dhe ndihmat nga shoqatat bamirëse, po gjendja jonë ekonomike ishte për tu qarë. Krerët dukeshin më rrallë. Ata vizitonin kryeqytetet e Evropës dhe Amerikës, kurse ne, vegjëlja, pak dinim se ç'katranosnin ata, në ato bisedime. Edhe në kamp kishte filluar një aktivitet i ethshëm politik. Takime, biseda, mbledhje, grindje, polemikë, krijime dhe ndarje partish, deklarata, antideklarata. Kazani po ziente me intensitet të plotë. Lindnin shpresa dhe përpiloheshin plane. Neve, zerove, prapa njësheve, na kërkoheshin bindje, besim dhe gatishmëri.

Në fillim të vitit 1949 na erdhi një delegacion amerikan ushtarako-civil. Ata kërkonin 300 veta të moshës 20-40 vjeç. Oferta e tyre me pak fjalë ishte kjo:

Kontigjenti prej 300 vetash do të shërbente si repart ndihmës pranë armatës amerikane në Republikën Federale Gjermane.

Ushqimi, fjetja dhe veshmbathja ishin gratis.

Do të paguheshim nga 10 dollarë në ditë, 5 prej të cilëve do t'i merrnim në dorë dhe 5 të tjerët do të depozitoheshin në bankë. Kjo shumë do tërhiqej në mbarim të shërbimit, mbas pesë vjetësh dhe do na jepej e drejta për strehim në SHBA.

Nga fundi i marsit, me një tren special u nisëm për në Mynih. U vendosëm në periferi të qytetit, në disa kazerma të vogla. Na ndanë në tri kompani, nga 100 veta secila. Çdo kompani kish nga dy komandantë në krye, një amerikan dhe tjetri shqiptar. Detyra jonë ishte të bënim rojë në një pyll pranë Mynihut, ku ishin depot e armatimeve të ar-

matës amerikane. Një sipërfaqe me disa mijëra hektarë tokë ishte rrethuar me tela që përshkoheshin nga rryma elektrike. Në çdo 100 metra kish një kullë rojash, e pajisur edhe me projektor. Neve na t'u caktua sektori 14. Në sektorët e tjerë shërbenin reparte të formuara nga emigrantë të vendeve të tjera të Evropës Lindore, në të shumtët hungarezë. Kështu, pas dy javësh instruktimi, filluam shërbimin. Na paralajmëruan se mungesa më e vogël e vigjilencës mund të shkaktonte një katastrofë me përmasa biblike dhe për gabimin më të vogël dilnim në gjyq ushtarak. Shërbimi ishte 6-orësh, 3 orë ditën dhe 3 natën. Një ditë në javë kishim pushim dhe mund të shkonim ku të donim.

Me rastin e 28 Nëntorit, erdhën për të na vizituar Abaz Kupi, Nuçi Kota dhe Asim Jakova. Nga ana e komandës amerikane, na përshëndeti një gjeneral me origjinë nga Dardha e Korçës. Në fjalimin e tij gjenerali na tha se së shpejti do të shikonim Shqipërinë, se dita e çlirimit po afrohej, se duhej të përgatiteshim, por nuk u fut në detaje. Të nesërmen disa prej nesh i thirrën në komandë. Aty ishin disa oficerë amerikanë që ne s'i kishim parë ndonjëherë, si dhe Asim Jakova, që luante rolin e përkthyesit. Një major amerikan na tha se na kishin zgjedhur ne si më besnikët dhe më të aftët. Mbasi të kryenim një kurs gjashtmuor, do të na nisnin në Shqipëri, si pararojë, për të marrë disa të dhëna strategjike dhe për të përgatitur terrenin për një zbarkim të mundshëm. Disa prej nesh nuk pranuan të bënin pjesë në këtë kontigjent, duke parashtruar lloj-lloj pretekstesh. Unë u ndodha në një pozitë të vështirë, s'kisha si tregohesha bukëshkalë ndaj Abaz Kupit, që kishte ndërhyrë për lirimin tim nga kampi i Romës. Pranova me gjysmëzëri, duke menduar me mendjen time prej budallai se kushedi ç'mund të bëhet pas gjashtë muajsh. Po atë ditë na nisën me shpejtësi për të një bazë ushtarake afër Viz Badenit. Nuk na lanë të përshëndetnim as shokët: kjo na bëri përshtypje të keqe.

Në skajin e një aeroporti ushtarak, afër Viz Badenit, ishte një shkollë sekrete, që përgatiste diversantë për vendet e Evropës Lindore. Instruktorët ishin oficerë amerikanë dhe gjermanë. Një kosovar bënte punën e përkthyesit. Na stërvitën në orientim në çdo rrethanë meteorologjike, në harta topografike, në radio transmetim, në përpilim kodesh, në përdorimin e armës dhe thikës, në vendosjen e minave, mundje, hedhje me parashutë etj. punë të këtij profili.

Një natë korriku të vitit 1950 grupin tonë prej 16 vetash

e hipën në një avion ushtarak, pa shenja dalluese dhe së bashku me disa instruktorë dhe bagazhet, u nisën drejt jugut, duke mos na treguar destinacionin. Mbas tri orësh fluturim, avioni u ul në një aeroport, nën dritat e forta të projektorëve të fuqishëm. Kur zbritëm nga ai, dalluam një autobus, një kamion dhe dy xhipse ushtarake. Disa oficerë grekë na uruan mirëseardhjen greqisht, kurse një civil, i veshur me kostum të bardhë na foli shqip: «Mirë se ardhët, vëllezër!». Kuptohej që do të ishte ndonjë minoritar grek nga të Shqipërisë, në shërbim të zbulimit amerikanogrek.

Instruktorët dhe oficerët hipën në xhipset, kurse ne me minoritarin dhe një oficer grek në autobus. Bagazhet tona i ngarkuam në kampionin e mbuluar. Autokolona u nis në drejtim të Athinës. E lamë qytetin në krahun e djathtë dhe filluam të ngjiteshim në disa kodra të pyllëzuara. Xhipset që ishin para nesh u ndalën në një kthesë të fortë dhe ne pas tyre. Na thanë të zbritnim nga autobusi. Materialet i shkarquam nga kamioni. Mbi rrugë, në krahun e majtë, me veshitirësi dallohej një vilë dykatëshe midis pishave, e veshur me pllaka mermeri të zi. Ajo që e rrethuar me kangjella hekuri të larta dhe te porta qëndronin një civil me trup kolosi. Megjithëse kishte aguar dhe vila s'ishte as 40 metra larg nesh, ajo dallohej me veshitirësi, sepse dukej tamam si një pjesë e peisazhit të pyllit të errët dhe e plotësonte për bukuri misionin e saj të të qenit sekreie. Salloni i katit të parë ishte mjaft komod dhe i pajisur me një numër të madh kolltukësh. Mbas lamë bagazhet në një dhomë përbri sallonit, u ulëm. Një oficer grek na porositi që të ishim të kujdesshëm dhe të mos këmbenim asnjë fjalë me personelin e shërbimit të vilës. Çdo gjë, çdo nevojë do ta kryenim me ndërmjetësinë e përkthyesit minoritar, të veshur me kostum të bardhë. Ai do të qëndronte vazhdimisht me ne. Instruktorët, të ardhur me ne nga Gjermania, u larguan për në Athinë dhe na thanë se do të shiheshim së shpejti.

Na çuan në dushe. Ndërsa po laheshim, në një dhomë të katit të parë na shtruan një mëngjes të pasur, me gjalpë të freskët, lloje të ndryshme d'athërash, reçelëra, sallanra, pije dhe ibrik me kafe «Karamba». Na dhanë dhe nga tri paqeta «Papastratos». Si hëngrëm mëngjesin, na çuan në katin e dytë, ku ishin dhomat e fjetjes. Nga lodhja, gjumi na zuri menjëherë.

Në orën 15.00 na zgjuan nga gjumi dhe zbritëm në katin e parë, ku kishim ngrënë mëngjesin. Na priste një drekë të-

pikë ballkanase: mish me bamje, kos, revani dhe ver të kualitetit të parë. Kafja «Karamba» nuk mungonte. Rreth orës 18⁰⁰, në një sallë po në katin e parë, që shërbente si kinema, shfaqën për ne një dokumentar për Shqipërinë. Ai ndahej në tri pjesë: Shqipëria përpara 7 prillit 1939, Shqipëria nga 7 prilli deri në 29 Nëntor 1944, dhe Shqipëria mbas vendosjes së pushtetit komunist e deri në provokacionet në kufirin shqiptaro-grek, në gusht të 1949-s.

Qëllimi i filmit ishte që të na ambientonte me Atdheun të cilin do ta shihnim së shpejti. Pas këtij dokumentari, që vazhdoi rreth gjysmë ore, kaluam në sallën e lojërave, ku nuk mungonte as bilardoja. Kishte tavolina shahu, loja tavlle dhe domino.

Mbas darke na shfaqën një film amerikan me kauboj.

Të nesërmen, mbasi hëngrëm mëngjesin, na çuan në një dhomë të katit të dytë të mobiluar shumë mirë. Në çast u dëgjuan uturimat e xhipseve dhe ne pamë nga dritaret instruktorët tanë që hynë në vilë së bashku me oficerët grekë që na pritën në aeroport. Ata, mbasi na përshëndetën, na ndanë në katër grupe me nga katër veta. Në çdo grup kishte nga një komandant dhe nga një radist. Grupi i parë, ku bëja pjesë edhe unë, do të desantonte në zonën e Rezomës, disa kilometra në perëndim të Delvinës. I dyti në zonën e Gramshit; grupi i tretë në zonën e Burrelit dhe i katërti në Postribë të Shkodrës. Çdo grup u fut në një dhomë të katit të dytë dhe filloi nga instruktimi. Në një faqe muri ishte një hartë e madhe 3 x 2 metra e krahinës së Rezomës. Ishte mjaft e detajuar, Shtëpitë e nacionalistëve ishin shënuar me bojë të zezë, kurse ato të komunistëve me bojë të kuqe. Ne do të zbritnim në afërsi të fshatit Kopaçe, i lidhur me Ballin në kohën e luftës. Na u tha se në zonën e Kurveleshit vepron grupi i «Ariut», Ahmet Kuka, dhe do të lidheshin me të. Na dhanë detyrat, kodet, si dhe valët e ndërlydhjes me radio. Na dhanë gjithashtu parullat për grupet e tjera, që futeshin nga toka nëpërmjet kufirit greko-shqiptar si dhe të tjera instruksione për zonën ku do të vepronim.

Me rëndësi të dorës së parë ishin informatat për gjendjen e rrugëve, si dhe kapacitetin mbajtës të urave, për dislokimin e reparteve ushtarake dhe armatimet e tyre, sidomos të dhëna për këshilltarët rusë. U bënë pyetje e përgjigje dhe diskutime.

Unë, duke ndier rrezikun, kërkova që grupi ynë të futej nëpër mjet tokës, mbasi zona ku do të vepronim nuk ish-

te as 30 kilometra larg kufirit grek. Kërkesa ime u hodh poshtë. Urdhrat ishin kategorikë dhe kot të diskutoheshin. Kjo mbledhje vazhdoi katër orë dhe, mbasi hëngrëm drekë, na thanë të pushonim se, po atë natë, do niseshim për Shqipëri.

U shtriva në krevat me sytë e mbërthyer në tavan. Mendime nga më të ndryshme më shkonin nëpër mend. Të gjithëve na u prenë fjalët; një heshtje prej varri. Për Shqipërinë kishim dëgjuar gjëra të llahtarshme. Na kishin thënë se, po të binim në duart e Sigurimit, do na e hiqnin mishin me pinca, do na nxirrnin sytë dhe të tjera tortura mesjetare. Nga ana tjetër, agjentët e Sigurimit kishin shpërndarë fshehurazi broshurat për gjyqin e Hetem Çakos të zhvilluar në Tiranë.

Në orën 21 na lajmëruan të zbritnim poshtë, në dhomën e ngrënies. Tavolinat qenë mbushur plot e përplot me tërë të mirat, po neve, na qe prerë oreksi fare. Pimë nga një tas me kafe dhe mbushëm xhepat me çokollata dhe paketa cigaresh «Papastratos». Na dhanë gjithashtu nga një qese me ushqime të thata, që i futëm në bagazhët tona të sjella nga Gjermania.

Në orën 22, po me atë autobus, u nisëm nga vila misterioze për në aeroportin po misterioz. Në orën 23 hipëm në aeroplan së bashku me instruktorët dhe bagazhet. Përshëndeti me frazën «Mirupafshim. vëllezër!». Aeroplani, pa shenja dalluese, me një uturimë të madhe shurdhuese, mori drejtimin për nga veriu. Po shkonim drejt Shqipërisë. Ikëm para gjashhtë vjetësh në rrëmujë dhe po ktheheshim, natën, nën breshëri plumbash. S'kishim as kohë e as nerva të mender, një borxh. Aeroplani hyri në hapësirën ajrore të Shqipërisë. Drita e kuqe e alarmit u ndez në bordin e aeroplanit dhe instruktorët na bënë shenjë, neve të grupit të parë, që t'i afroheshim derës. Parashutat që kishim vendosur në shpinë që në aeroportin grek, ishin me hapje të shpejtë; ato kishin një skaj litari në hekurin e bordit dhe ska'in tjetër në kokën e parashutës. Litarët qenë 10 metra të gjatë. Dera e avionit u hap dhe një rrymë e ftohtë ajri hyri si lubi në bordin e avionit. Hodhëm në fillim bagazhin, pastaj instruktorët na shtynë ne, njërin pas tjetrit. M'u duk se po bija kokëposhtë në një pus pa fund. Sytë i mbaja të mbyllur që kur u hodha nga dera e avionit, dhe, kur i hap,

m'u duk vetja si fantazmë që fluturonte në një hapësirë të zezë pafund. Mbas disa minutash, rashë mbi degët e një fiku. Në oborrin e një shtëpie të vogël fshati. Një plakë doli në derë të kasolles dhe, kur më pa që po qëndroja midis degëve të fikut, vuri ulërimën, sikur të isha «qoftë largu». Nxora thikën, që e kisha të lidhur në krah dhe preva rripat e parashutës; e lashë atë mbi fik dhe i hoqa siguresën automatikut që kisha në gjoks. Kalova gardhin e oborrit, kur menjëherë dëgjova breshëri automatiku dhe të shtëna pushkësh nga të gjitha anët. Instinktivisht hoqa këmbëzën e automatikut dhe zbraza një karikator me 32 fishekë. S'kish asnjë dyshim se ndodhesha i rrethuar nga forcat e Sigurimit shqiptar. Jo që s'e dinim, por as na shkonte ndër mend që për ardhjen e grupeve tona Sigurimi shqiptar i merrte të dhënat nga zbulimi sovjetik dhe ky i fundit i merrte nga oficerët madhorë amerikanë dhe anglezë, në shërbim të KGB-së sovietike. Rusët për punë agjente e derdhin floririn si lumë. Kishim rënë larg njëri-tjetrit disa qindra metra. Me shokët e grupit nuk u takova më. Lufta vazhdonte në errësirë dhe qëllohej më tepër në tym, sesa në objektiv. I vura detyrë vetes që të shkoja drejt lindjes, drejt kufirit grek, po terrenin nuk e njihja mirë. Ecja si derr i plagosur, duke vrapuar me të katra e me automatik në dorë.

Sapo zbardhi drita, fillova të dalloja konturet e maleve të Stugarës. A do të mundja t'i kaloja dot ato male? Pushkët dhe automatikët dëgjoheshin gjithnjë më rrallë. Mbi një kodër pashë një grumbull ushtarësh e oficerësh që vëzhgonin me dylbi. Isha bërë ujë në djersë nga të vrapuarit dhe nga frika. Kur ra dielli, ndodhesha pranë fshatit Kakhidhiq, mbi Delvinë. Ecja gjithnjë drejt lindjes, por, ndërsa po kaloja një përrua, një thirrje e fuqishme u dëgjua nga mbrapa ca shkëmbinjve: «Dorëzohu, duart lart!» Thirra u shoqërua me një breshëri automatiku. Në krahun e majtë m'u duk sikur më pickoi një grerëz. Vrapova dhe u futa në një guvë që ndodhej aty pranë. Tani isha i mbrojtur nga mbrapa, nga krahët dhe përpara kisha një shkëmb të vogël, që nuk i lejonte rrethuesit të më diktonin. Një lëng i ngrohtë filloi të më kullonte nga krahu i majtë, ishte gjak. Hoqa xhaketën, ngrita mëngën e këmishës dhe i hodha plagës duhanin e një pakete cigareje, e shtrëngova me shami dhe m'u duk se gjaku pushoi.

Thirrjet për dorëzim dhe breshëritë e plumbave vazh-

donin të fërshëllenin mbi guvën ku isha futur. Truri im ishte topitur dhe veproja thjesht si kafshët. Jashtë gëmonin thirrjet: «Dorëzohu, je i rrethuar!» Unë sakaq heshtja, duke mbajtur automatikun në duart që më dridheshin. Mbas pak dëgjova disa zëra fëmijësh, ishin një grumbull, 7-10 vjeçarë, që një oficer mbas tyre i drejtonte drejt guvës. Ata qëndruan disa metra larg meje, me sytë e trembur dhe me zë të dridhur thoshin: «Ja, ja ku është!», duke më treguar me gishtat e tyre të vegjël. S'mund të qëlloja mbi fëmijët, ngrita duart lart dhe dola, si ariu nga shpella. M'u vërsulën mbi shpinë katër veta. Më çarmatosën, dhe më lidhën duart nga mbrapa. Dy nënoficerë më mbanin nga krahët, kurse shumë të tjerë rrinin anash, me armë në duar. Më zbritën poshtë, në një rrugë makine, dhe, pasi ecëm nja 30 minuta në këmbë, pashë që na priste një gaz plot me oficerë. Njëri prej tyre, i gjatë dhe zeshkan, më pyeti se ku isha plagosur dhe si qulesha. Më hipën në makinën e tij dhe u nisëm me shpejtësi në drejtim të Gjirokastrës. Gazet u ndalën në oborrin e spitalit. Atje më vendosën në një dhomë dhe oficeri i gjatë e zeshkan, gjithë autoritet, u fliste mjekëve duke më treguar mua me gisht. Mjekët më zhveshën xhakatën, më pastruan plagën, ma fashuan dhe u larguan së bashku me zeshkanin. Një oficer e pyeti zeshkanin: «Shoku Kadri, të nisemi?» «Nisuni, — tha zeshkani. — Unë do të vij me «mysafirin» tjetër». Oficerët më hipën në gaz dhe aty më lidhën këmbë e duar, kështu, i shoqëruar nga tre oficerë të armatosur deri në dhëmbë u nisëm drejt Tiranës, me shpejtësi të madhe.

Mbas pesë orësh, ndodhesha në qelinë nr. 3 të burgut të Tiranës, ku më zgjidhën vetëm këmbët. Në darkë vonë, u kujtuan të më jepnin një copë bukë dhe pak supë, ku mund të numëroje kokrrat e orizit.

Të nesërmen më vizituan shumë oficerë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më bënë qindra pyetje. Hetuesi që m'u caktua ishte Stavri Zharrë, një bishë me fytyrë njeriu, ndonëse me ne u soll pak më ndryshe se me të tjerët. Kishin hall që të krijohej imazhi se Sigurimi nuk i trajtonte diversantët e ardhur nga Perëndimi ashtu siç flitej. Këtë e bënë që diversantët të mos bënin rezistencë.

Gjyqi ynë u zhvillua në teatrin «Kosova». Na veshën me rroba të reja, nga ato të bagazheve tona. Ishim gjithsej 12 veta.

Në gjyq mora vesh se gjashtë veta nga ne, të nisur nga Viz Badeni, ishin vrarë në përpjekje, gjashtë ishin zënë të gjallë dhe katër veta, ata që kishin desantuar në Gramsh, kishin mundur të shpëtonin, mbasi nuk ishin hedhur në vendin e caktuar, dhe kjo për gabim të pilotëve. Ata mundën të çanin ferrën dhe të mbërrinin në Greqi shëndoshë e mirë.

Më dënuan 20 vjet burgim. Gjer tani kam vuajtur 12. Më ka lënë dëshira për të jetuar; disa herë kam qenë në buzë të varrit, por gjallë se gjallë. Mirë thonë: «I ra gurit dhe e theu, i ra hekurit e përkuli, i ra njeriut e duroi».

SHËNIM

Gjatë viteve 1949-1955, në Shqipëri desantuan disa grupe diversantësh, të dërguara nga zbulimet anglo-amerikane dhe italiane në kuadrin e luftës së ftohtë që zhvillohej midis dy kampeve. Këta diversantë u hodhën në territorin shqiptar nëpërmjet qiellit, detit dhe vendeve fqinje. Propaganda komuniste e atëhershme bënte një zhurmë shurdhuese, duke i paraqitur këta njerëz si vrasës dhe kriminelë me damkë, që dërgoheshin në Shqipëri për të mbjellë zi dhe terror. Gjyqet e tyre zhilloheshin me bujë të madhe, duke u kthyer në arena propagandistike kundër vendeve perëndimorë. Grupi i parë i diversantëve u hodh me parashuta në malet e Kurveleshit, në Korrik të 1949-s dhe përbëhej nga katër veta: Hetem Çako, Llukman Luftiu, Kasem Zhupa dhe Zyber Lika. Mbas këtij grupi u hodhën dhe grupe të tjera, në krahina të ndryshme të Shqipërisë, ku shumica e tyre u asgjësuan me të vënë këmbët në tokë dhe kjo, jo për meritat e forcave ndjekëse të Sigurimit, po nga të dhënat që jepnin instruktorët e këtyre diversantëve, agjentë të zbulimit sovjetik dhe ky i fundit njoftonte MP të Brendshme të Shqipërisë për datën dhe vendin ku do të desantohej grupi. Rasti e solli që në burgun e Burrelit të njihesha me njërin prej tyre, me Muhamet Hoxhën, bashkëqytetar imi, një babaxhan njeri, që kishte provuar në shpinën e tij vuajtjet e kampeve të Lindjes dhe të Perëndimif. i hedhur me parashutë në Rrëzomë të Delvinës, së bashku me tre shokë të tij, në verën e vitit 1950. Mbasi u njohëm me njëri-tjetrin, ai më besoi ditarin e tij, të cilin po e botoj, pa bërë asnjë ndryshim.

1) Në burgjet e diktaturës komuniste në Shqipëri, kanë vuajtur dy njerëz me emrin Muhamet Hoxha dhe të dy nga qyteti i Gjirokastrës. Muhamet Hoxha për të cilin bëhet fjalë te deklaratata, ka shërbyer si nënoficer xhandarmërie, kurse Muhamet Hoxha tjetër ka qenë profesor matematike.

PASTHËNIË

Të nderuar lexues:

Gjithçka që lexuat në këtë libër është autentike pa asnjë trillim ose produkt i fantazisë. Të përshkruash tragjedinë e madhe të burgjeve dhe të kampeve të diktaturës komuniste të Shqipërisë duhet një punë tejhomerike, se e tillë ka qenë kjo tragjedi, si nga koha dhe nga përmasat.

Për këtë nuk mjaftojnë, sikur gjithë Adriatiku të kthehej në bojë shkrimi dhe qielli i Shqipërisë në letër. Për çdo kamp dhe burg mund të shkruhen disa volume dhe kjo u bie për detyrë studiuesve për të bërë kërkime dhe për të mbledhur kujtime nga ata fatkëqinj që kanë mbetur ende gjallë. Personat për të cilët flitet në libër autori i ka njohur personalisht gjatë vuajtjes së dënimit dhe nuk pretendon aspak se ka kryer detyrën, duke dhënë disa pasazhe të këtyre bashkëvuajtësve.

U kërkoj të falur gjithë atyre ish-të burgosurve politikë, që meritojnë të zënë një vend nderi në historinë e dhimbshme të kombit tonë dhe s'përmenden në këtë libër, se do të punoj gjer në frymën e fundit të jetës sime për të nxjerrë në pah aq sa mundem, ngjarje dhe figura nga tragjedia gjysmë shekullore që iu imponua popullit shqiptar nga regjimi satanik komunist.

A U T O R I

The first part of the document is a list of names and titles, including the names of the authors and the titles of their respective works. The list is organized in a structured manner, with names and titles clearly separated.

The second part of the document contains a series of numbered entries, likely representing a list of references or a table of contents. Each entry includes a number, a name, and a title, providing a clear and organized overview of the document's content.

The final part of the document is a concluding section, which may include a summary or a list of additional references. This section provides a comprehensive overview of the document's findings and conclusions.

2 6 1 1 1 A

P E R M B A J T J A

— Parathënie	5
— Burgjet e shtetit-burg	7
— Rrathët e fërrit — Burgu i Gjirokastrës	9
— Burgu i vjetër i Tiranës	10
— Burgu i ri i Tiranës	10
— Burgu-ferr i Burrelit	11
— Kampi shfarosës i Maliqit	13
— Gratë shqiptare në burgjet dhe kampet e diktaturës komuniste	13
— Kampet e Borshit dhe i Përparimit (i Shën Vasilit)	15
— Kampi-skëtërrë i Spaçit	16
— Kampi i Qafëbarit	17
— Kampi i Valiasit	17
— Kampi i stadiumit në Tiranë	17
— Kampi i Jubës	18
— Kampi i Kozarës	18
— Kampi i Gosës së Kavajës	18
— Kampi i Bedenit	18
— Kampi i Urës së Bonës	18
— Kampi i Bishqemit	19
— Kampi për hapjen e kanalit Peqin-Kavajë	19
— Kampi i Vlashukut	19
— Kampi i Urës Vajgurore	19
— Kampi nr. 4, Tiranë	20
— Kampi i Rinasit	20
— Kampi i Varibobës	20
— Kampi i Tërbufit	20
— Kampi i Zadrimës	20
— Kampi i stadiumit «Dinamo» në Tiranë	21
— Kampi i Thumanës	21
— Kampi i Bllokut «Puna» në Tiranë	21
— Kampi i Sanatoriumit	21
— Kampi i Kombinatit Ushqimor, Tiranë	21
— Kampi i Laçit	21

— Kampi i Rubikut	21
— Kampi i Fushë Krujës	22
— Kampi i Elbasanit	22
— Kampi i Repsit (Mirditë)	22
— Kampi i Skrofotinë, (Vlorë)	22
— Kampi i Ballshit	22
— Kampi i Torovicës	23
— Kampi i kompleksit «Dinamo»	23

MANDELET E SHQIPËRISË

— E pamposhtura Musine Kokalari	27
— Mësues, shok dhe bashkëvuajtës	32
— Profesor Foto Bala	36
— Kryepeshkopi i Shqipërisë, Visarion Xhuvani	41
— Dr. Kalivopulli vdes në burg	41
— I nderuar dhe i respektuar nga të gjithë	41
— Rùmuni	51
— Bedri Spahiu	57
— «Kapiteni i asfalisë»	63
— Kosheret e bletëve	69
— Shkatërrimi i trurit (të sëmurët psikikë në burgjet dhe kampet me punë të detyruar)	72
— Gjenerali i zi, Nevzat Haznedari	76
— Deklarata (Shënimi)	81



Agim Musta ka lindur më 1929 në qytetin e Gjirokastrës dhe më 1943 është shpërngulur familjarisht në Tiranë. Ka mbaruar Institutin e Lartë Pedagogjik, Fakultetin Gjuhë-Histori dhe për shumë vjet ka shërbyer si mësues në rrethet Sarandë, Kuçovë dhe Tiranë. Më 1962 është dënuar me 13 vjet privim lirie për krijimin e grupit socialdemokrat. Mbas kryerjes së dënimit, ka punuar në punë të rënda në ndërtim, gjersa doli në pension. Ka qenë pjesëmarrës në grupin nisësor për formimin e Shoqatës së Ish të Dënuarve dhe të Persekutuarve Politike të Shqipërisë në Mars të vitit 1991. Ka publikuar dhe dhjetra artikuj në shtypin e kohës në mbrojtje të proceseve demokratike dhe të ish bashkëvuajtësve të tij.